



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 26 SHKURT 2009

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
26. FEBRUARA 2009. GODINE

SHKURT – FEBRUAR
2009

E enjte, më 26.02.2009, ora 10:00

Drejtoi seancën: Kryetari i Kuvendit, zoti **Jakup KRASNIQI**

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Kabinet qeveritar,

Hapim punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Konstatoj se në sallë janë 86 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për t'ia filluar punës.

Ju njoftoj se në pajtim me Rregullën 6, pika 2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendi ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Para se t'ia fillojmë rendit të ditës, për fjalë është lajmëruar deputeti Gani Geci. Ju e dini, dy minuta janë për rend dite.

GANI GECI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Mua po më vjen keq që ne si deputetë të Kuvendit të Kosovës nuk po shohim se punëtorët shëndetësorë janë në grevë që tri ditë. Dhe, a ka gjë më emergjente se të jesh i sëmurë sot dhe të shkosh në QKUK dhe atje të thonë se jemi në grevë.

Unë nuk di se si mund të heshtet kjo çështje, sepse nuk ka më emergjente se në Emergjencën e QKUK-së të shkojë një fëmijë i aksidentuar dhe punëtorët thonë se ne jemi në grevë. Unë nuk di se si nuk e keni pasur parasysh që këto 44 euro që ua keni premtuar punëtorëve shëndetësorë t'i parashihni në buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009? Ju marrëveshjen e keni bërë para vitit 2009, në vitin 2008 dhe tash me këto mashtrime i keni futur në grevë punëtorët. Thjesht, këto mashtrime nuk qojnë larg as Qeverinë e as Ministrinë e Shëndetësisë. Sikur të kishte pak moral politik, kjo nuk do të ndodhte dhe ata që e udhëheqin këtë dikaster do të jepnin dorëheqje. Dhe, unë kërkoj nga ky vend që të debatojmë për këtë çështje se nuk ka më emergjente dhe më urgjente se kjo. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka kërkuar deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Unë i bashkëngjitëm shqetësimit të kolegut Geci. Dëshiroj të shpreh edhe vetë shqetësimin e thellë për gjithë gjendjen në sistemin shëndetësor. Pra, tani punëtorët shëndetësor janë në grevë dhe kërkesat e tyre legjitime nuk po plotësohen. Këtë çështje po e ngrit duke kërkuar nga Qeveria, por edhe nga Kuvendi, që të angazhohet seriozisht për përmirësimin e gjendjes në sistemin shëndetësor. Dy shtyllat kryesore të këtij sistemi: sigurimet shëndetësore dhe Oda e Mjekëve mungojnë, prandaj edhe nuk mund të ketë funksionim të mirëfilltë të këtij sistemi.

Propozimi im ka të bëjë me zgjidhjen e qëndrueshme të problemeve në sistemin shëndetësor. E para, që të ketë angazhim ndërministror të Qeverisë dhe, e dyta, që Kuvendi ta marrë seriozisht, ta bëjë prioritet shëndetësinë dhe që të jetë në agjendën e Kuvendit deri në zgjidhjen e këtij problemi. Mos harroni se greva dhe pakënaqësitë e punëtorëve shëndetësorë godasin në radhë të parë të sëmurit dhe me këtë edhe familjet

në Kosovë dhe po ashtu buxhetin e tyre, do të thotë edhe vetë shëndetin e popullatës, zotërinj të nderuar, dikur edhe shëndetin tuaj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka kërkuar Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë,

Edhe unë iu bashkëngjitëm shqetësimeve të kolegëve sa i përket gjendjes në shëndetësi, besoj se këto janë shqetësime të të gjithëve. Prandaj, nuk e besoj që do të duhej të ishim kaq komod edhe ne, edhe Qeveria e Kosovës dhe Ministria do të duhej të japë raport, të raportojë para këtij organi për gjendjen më të re të krijuar në shëndetësi dhe për hapat që duhet t'i ndërmarre për tejkalimin e kësaj gjendjeje.

Dhe, çështja e dytë si shqetësim, që po ashtu konsideroj se ky organ do të duhej ta ketë parasysh, sepse po flas për një organ të Kuvendit, ka të bëjë me vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës së Kosovës, vendime të cilat nuk respektohen nga ana e ekzekutivit, qoftë në nivelin qendror, qoftë në nivelin lokal. Prandaj, duke qenë se ky organ është i Kuvendit të Republikës së Kosovës, konsideroj se Kuvendi do të duhej ta debattojë, në mënyrë që të krijojë mekanizma efikas nëpërmjet të cilëve do të mund të realizohen vendimet e këtij organi. Këto janë dy shqetësime të cilat desha t'i paraqes. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar, zoti Kryetar!

Konsideroj se nuk do të ishte krejtësisht korrekte që të përqendrohemi në pikat neuralgjike e delikate në shoqërinë kosovare, të cilat sot janë në shëndetësi, por mund të dalin edhe në sfera të tjera të jetës shoqërore.

Unë vlerësoj se duhet t'i qasemi këtij edhe problemeve makro në përgjithësi me një seriozitet tepër të madh. Unë, në këtë rast angazhohem për të dhënë një kontribut sado modest në favor të Qeverisë, të ekzekutivit, që ta bëjë këtë punë në të mirë të zgjidhjes edhe të çështjes problematike në shëndetësi, por edhe te sferave të tjera të jetës shoqërore.

Na duhet, ju lutem, shumë shpejt na duhet Ligji për sistemin e pagave, i cili do t'i përpunonte objektivisht kriteriumet për pagat edhe më pastaj mund të ndodhë që ndokush do të ishte i pakënaqur apo e pakënaqur, por do të ishte i justifikueshëm, si të them, arsyetimi se ashtu është dhe ashtu duhet të jetë. Ndryshe, ka shumë disproporcione në paga që janë të paarsyeshme. Po e zëmë vetëm edhe këtë pasus, e marrim vetëm Bordin e Pensioneve, ku i merr po e zëmë, 10.000, 12.000 euro nga paraja e fukarasë, ndërsa mjeku specialist apo le të jetë profesor universitar merr një pagë nëpërkëmbëse. Prandaj, angazhohem që ky ligj, unë sa e di ky është i dizajnuar, të jepet sa më parë në Kuvend dhe ta diskutojmë dhe ta miratojmë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Unë e kam një kërkesë. Ju e dini që këta minuta janë për rend dite. Urdhëro, deputet Shkumbin Demaliaj.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Mendoj se sot, në qoftë se është paraparë të diskutohet për gjendjen në shëndetësi dhe për grevën e organizuar nga thirrjet e sindikalistëve brenda resorit të shëndetësisë, në radhë të parë, në qoftë se është i përgatitur dikush nga Komisioni për Shëndetësi apo Komisioni Parlamentar, do të thotë i Kuvendit, është më i thirrur për këtë gjendje, kisha pasur dëshirë ta di që Komisioni a ka bërë diçka të ngjashme dhe a i ka vizituar edhe ta dimë drejtpërsëdrejti se cilat janë kërkesat e punëtorëve shëndetësorë, si mekanizëm në kuadër të legjislativit? Pra, çdo formë tjetër individuale që sot ne mund të flasim dhe të thërrasim këtu, besoj që nuk mund t'i kryejmë punët adekuate lidhur me kërkesat e punëtorëve shëndetësorë, kështu që kisha bërë kërkesë që dikush nga Komisioni të na tregojë se a e ka kryer punën e vet e të vazhdojmë më tutje. Pra, ne e dimë se në të gjithë resorët sa mund të ndryshojmë diçka ne në sistemin e Ligjit për buxhet në këtë rast, sepse është vetëm starti i fillimit të vitit buxhetor, është muaji i dytë që kemi filluar dhe të parashihen këto pengesa. Kaq kisha pasur dëshirë të them , pra, Komisioni të merret me këtë çështje dhe sa më shpejt në qoftë se e shohin të udhës për ta futur sot në rendin e ditës për ta debatuar, sepse kjo seancë mund të zgjasë më tepër e të diskutojmë dikur dhe ta fusim në rend dite.

Ju faleminderit, zoti Kryetar!

KRYETARI: Veç po iu njoftoj që as nuk jemi në pikën e rendit të ditës, me Rregullën 23, pika 2 dhe as nuk përputhet me Rregullën 29 për çështje urgjente, kështu që, vërtet unë kisha kërkuar që deputetët që e kanë kërkuar fjalën, le ta tërheqin. Unë mund t'ua jap fjalën, por ta dimë që nuk kemi të bëjmë me këto dy rregulla për të cilat ne duhet të bisedojmë, pra, jemi për rend dite. Ju e dini që, nëse do ta ndryshosh një rend dite, duhet bërë kërkesë me shkrim, por edhe me marrëveshje. Nuk është bërë as me shkrim, as me marrëveshje. Por, megjithatë fjalën po ua jap, pasi e kam filluar. Fjalën e ka deputetja Teuta Hadri, pastaj Naser Rugova.

TEUTA HADRI: Ju faleminderit!

Desha të tërhiqem, por pasi na e dhe fjalën, unë kisha për t'ua kthyer te çështja e grevave si një përgjegjësi e madhe që luhet me dinjitetin e mjekut është nga vetë Ministria e Shëndetësisë. Unë, dy herë e kam bërë në këtë Parlament pyetje ministrit që ato para të ligjshme që duhen t'i marrin, t'ua jepen me kohë e mos të lajthitet me dinjitetin e mjekut, si në këtë rast, ministri ka lejuar dhe pastaj ka tradhtuar, një ditë përpara u ka thënë gjëja se i kemi lëshuar nëpër banka.

Edhe në marrëveshjen dje me Presidentin, nuk është bërë një qartësim i marrëveshjes dhe ende nuk dihet a janë lëshuar në banka dhe askush nuk i ka marrë ato para, kështu që do të ishte mirë këtu më tepër të diskutohet edhe për Ministrinë e Shëndetësisë, për përgjegjësitë e tyre që nuk i kryejnë me kohë.

KRYETARI: Ju njoftova që, realisht, nuk jeni në rend dite. Megjithatë, fjalën po ua jap, por është mirë që ju ta respektoni Rregulloren, se ju vetë e keni votuar. Fjalën e ka deputeti Naser Rugova, le të përgatitet Sadik Idriz.

NASER RUGOVA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Keni të drejtë sa i takon Rregullores së Punës së Kuvendit, mirëpo këto janë çështje urgjente dhe konsideroj si deputetë të këtij Parlamenti, si njerëz të zgjedhur, si përfaqësues të qytetarëve, ne duhet t'i diskutojmë, sepse është dita e tretë e grevës e të

gjithë punëtorëve të sistemit shëndetësor dhe një gjë e tillë dihet se sa e dëmshme është për qytetarin, për pacientët, por edhe për sigurinë e vendit.

Nuk po respektohen marrëveshjet. Ministri, Kryeministri, Presidenti involvohen, merren vesh dhe nuk u qëndrojnë prapa fjalëve të tyre. Çka po ndodhë, a kemi institucione? Në këtë moment është dashur që ministri i Shëndetësisë, sepse Qeveria është ekzekutiv i vendit, për këtë gjendje të nderë në sistemin shëndetësor, të na japë një informatë 3-4 minuta se çka po ndodhë me punëtorët shëndetësorë dhe me sistemin shëndetësor të vendit? Realisht, kjo është një papërgjegjësi e madhe. Ju faleminderit!

KRYETARI: Nëse është që tri ditë, nuk është bash krejt çështje urgjente, ka mund të bëhet me shkrim. Fjalën e ka deputeti Sadik Idriz, dhe nuk ka më.

SADIK IDRIZ: Hvala, predsedniče!

Ja ću govoriti u svojstvu predsednika Komisije za zdravstvo. Mi smo na sastanku Komisije u utorak diskutovali o ovome. Medjutim, vi znate kakav je sastav Komisije. Komisija odražava sastav parlamenta i komisija ne može tek tako da donosi odluke, jer to nije njen mandat. Medjutim, bilo je predloga da se poseti Štrajkački odbor i mislim da ćemo u narednih dan-dva to uraditi. Megjutim, pitanje plata u zdravstvo i štrajka je više pitanje koje pripada Vladi. U ovom trenutku znamo da je Vlada u kontaktu i da se čine naponi da se ovo prevazidje. Komisija će dati svoj doprinos. Ja sam bio u kontaktu juče sa predsednikom sindikata, koji je tražio od nas da vidi gde je sa zakonskom procedurom, odnosno gde je sa Zakonom o radu i kakva je situacija sa Zakonom o zdravstvenom osiguranju.

Ja vas ubedjujem da će Komisija svaki zakon koji bude stigao do Komisije, da će ažurno raditi i da će dati svoj doprinos. Medjutim, vi znate sastav komisije i ne može Komisija koje održava parlament da donosi nešto ili da se svrstava na stranu jednih ili drugih da donosi...

Ja kao predsednik Komisije takvo pravo nemam, jer moram da dobijem saglasnost od Komisije, najverovatnije ćemo posetiti ove, iz svih grupa paralementarnih psoetičemo štrajkače, da se upoznamo sa njihovim zahtevima. Medjutim, mislim da i dalje ostaje problem da Vlada učini ono što treba da učini maksimalno da bi moglo da se prevazidje ovo stanje. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit! Për rendin e ditës fjalën e ka kërkuar ministri për Ekonomi dhe Financa.

AHMET SHALA: Ju faleminderit!

I nderuar Kryesues,

I nderuar Kryetar i Parlamentit,

I nderuar Kabinet,

Të nderuar deputetë,

Kam nderin dhe kënaqësinë që të paraqes para jush një kërkesë në bazë të Rregullores 35/3 të Kuvendit të Kosovës. Sponsoruesi i Ligjit ka të drejtë që për shkaqe teknike apo të tjera të tërheqë nga procedura Projektligjin për Raportimin e financave të organizatave biznesore. Konsiderojmë që na nevojitet ende kohë për t'i harmonizuar të gjitha elementet e nevojshme, në mënyrë që ky ligj të jetë konform nevojave të vendit në kohën në të cilën po ecim. Prandaj, kërkoj që me mirëkuptim ky ligj të hiqet nga procedura për sot dhe pastaj konform marrëveshjeve që kemi, të diskutojmë. Sigurisht,

kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa do t'i japë në detaje arsyet, andaj kërkoj mirëkuptim që të tërhiqet nga procedura.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka Kryetari i Komisionit, deputeti Gani Koci.

GANI KOCI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Dua ta falënderoj ministrin e Ekonomisë dhe të Financave për propozimin që e bëri. Ne si Komision e kemi shqyrtuar paraprakisht, para se të futet në rend dite këtë projektligj dhe kemi ardhur në përfundim se i njëjti duhet të tërhiqet për këto arsye. Së pari, ligji nuk e plotëson qëllimin për të cilin është menduar, nuk është në pajtueshmëri me ligjet tjera dhe nuk mbulon fushën për të cilën është përcaktuar. Pra, fjalën e mora që ta them edhe një fakt tjetër dhe një sugjerim, rekomandim që duhet të jetë edhe i Kuvendit për Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave, që sa më shpejt ta hartojë Ligjin për standardet e kontabilitetit në Kosovë, duke pasur parasysh që ato të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit. Çështja për të cilin është ofruar ky ligj që përfshin Komisionin, si të them, të kontrollit të kontabilitetit financiar në Kosovë, të futet dhe të inkorporohet në atë ligj. Kjo ka qenë ajo arsyeja dhe është edhe kërkesë e Komisionit për Buxhet dhe Financa që ligji si i tillë të vijë si ligj i kontabilitetit, që do të jetë në përputhje me standardet e kontabilitetit ku përfshihen të gjithë mekanizmat e mbikëqyrjes financiare brenda atij ligji.

Prandaj, ne si Komision e përshëndesim tërheqjen e këtij projektligji, me mundësinë që sa më shpejtë të na vijë ligji i kompletuar.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Pra, e kemi kërkesën e propozuesit të ligjit, që me Rregullore ka të drejtë. Kush është për tërheqjen e kësaj pike të rendi të ditës? Ju faleminderit!

Kush është "kundër? Nuk ka. Abstenim, një. Numëroni, por megjithatë me shumicën e votave tërhiqet nga rendi i ditës.

Vazhdojmë me rendin e ditës:

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 12 dhe 13 shkurt 2009

Të nderuar deputetë, ju njoftoj se Procesverbali dhe Transkripti i seancës plenare të mbajtur më 12 dhe 13 shkurt 2009, u është shpërndarë deputetëve.

Pyes deputetët, nëse kanë vërejtje në procesverbal? Nuk ka. Konstatoj se Kuvendi miratoi Procesverbalin e seancës plenare të mbajtur më 12 dhe 13 shkurt 2009.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

Koha për pyetje parlamentare

Ju njoftoj se në bazë të Rregullës 26, pika 1 e Rregullores së Punës së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare e deputetëve për Qeverinë është kufizuar në 50 minuta.

Procedimi i pyetjeve do të bëhet sipas kohës së parashtruar dhe numrit rendor të pyetjeve.

Deputetja Donika Kadaj- Bujupi, pyetje për Ministrin e Ministrisë së Arsimit, zotin Enver Hoxhaj. Deputete, mund ta parashtroni pyetjen.

DONIKA KADAJ- BUJUPI: Ju faleminderit, Kryetar!

Në kuadër të burgut të Dubravës në Istog funksionon paralelja e shkollës së mesme teknike “Mithat Frashëri” ku ligjërojnë nëntë profesorë. Prej vitit 2007 kompetente për institucionin në fjalë është Ministria e Arsimit, mirëpo profesorët nuk kanë kontrata dhe nuk i gëzojnë të drejtat e parapara me ligj.

Prandaj, ju pyes, kur do të definoni statusin e këtyre kuadrove dhe pse deri tani nuk keni përmbushur obligimet ndaj tyre?

KRYETARI: Zoti Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI ENVER HOXHAI: Ju faleminderit !

I nderuar zoti Kryetar,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

E nderuara zonja deputete,

Të faleminderit shumë për një pyetje të tillë. Do të mundohem që vërtet ta jap përgjigjen sa më precize. Është fjala për nëntë arsimtarë të cilët punojnë në Burgun e Dubravës, në paralelen e cila është brendapërbrenda burgut. Dua, po ashtu, t’ju informoj se këta arsimtarë deri me tash kanë marrë paga nga Ministria e Arsimit. Situata e tyre është pakëz më specifike, meqë janë arsimtarë të cilët punojnë brendapërbrenda burgut, nuk kanë mund të integrohen në sistemin e pagave nëpërmjet komunave. Pra, dua t’ju informoj që ne edhe në komunën gjegjëse kemi bërë kërkesë që të integrohen në sistemin e pagave, meqë kontratat e punës arsimtarët zakonisht i krijojnë me komuna e jo me Ministrinë e Arsimit.

Dua, po ashtu, t’ju informoj që me vendim të Ministrisë këta arsimtarë janë të kyçur në procesin e licencimit, ndërsa pozita e tyre juridike do të zgjidhet me ligjin, i cili do të jetë Ligji për shërbyes civilë në Republikën e Kosovës, që do ta rregullojë çështjen e të gjithë shërbyesve civilë, në kuadër të cilit arsimtarët ose mësimdhënësit që punojnë në nivelin fillor, në nivelin e mesëm dhe në nivelin e lartë do të definohen si shërbim profesional. E njëjta gjë vlen edhe për këta arsimtarë të cilët aktualisht punojnë në Burgun e Dubravës dhe për të tillët që punojnë në Qendrën Korrektuese në Lipjan. Do të thotë, do të jetë ligji ai i cili do ta zgjidhë përfundimisht çështjen e pozitës së tyre legale, ndërsa pagat i kanë marrë me kohë dhe janë pjesë e procesit të licencimit të arsimtarëve. Me fjalë të tjera, nëse kanë kualifikime më të larta, marrin pagë më të lartë, nëse kanë përvojë pune, po ashtu marrin edhe një pagë shumë më të lartë.

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër! Deputete, a ke pyetje shtesë? Urdhëro!

DONIKA KADAJ- BUJUPI: I nderuar ministër,

Derisa ju thoni se janë specifikat, e dimë që specifikat janë rrezikshmëria dhe puna më e vështirë që këta njerëz bëjnë në kuadër të shkollës brendapërbrenda burgut dhe është shumë e palogjikshme që këta nuk i kanë marrë shtesat, të cilat i kanë marrë arsimtarët dhe mësimdhënësit tjerë. Nuk mund të arsyetohet që specifikat janë më të vështira dhe

këta njerëz marrin paga më të vogla. Ndërkohë, diplomat që lëshohen, unë i kam këtu dy kopje të diplomave, do të thotë, janë të njëjta, nuk dallojnë fare. Do të thotë, kualiteti i mësimi, diploma, gjithçka është e njëjtë, përveç që këta njerëz nuk kanë kontrata, do të thotë Qeveria i mbanë në punë në të zezën dhe kjo është shkelje e ligjit. I mbani në të zezën në punë dhe pagat e tyre janë më të ulëta se pagat e arsimtarëve të tjerë.

KRYETARI: Ministër, a ke përgjigje?

MINISTRI ENVER HOXHAI: Do të thotë, situata është e kësaj natyre. Çdo arsimtar në Republikën e Kosovës ka kontratë pune me komunën në të cilën punon dhe janë komunat ato të cilat i punësojnë arsimtarët. Kjo është e para. E dyta, për paralelet të cilat punojnë në qendrat korrektuese, në burgjet e Republikës së Kosovës, ne, me qëllim që ta zgjidhim problemin që këta arsimtarë të mos mbesin pa paga, kemi bërë një zgjidhje e cila në mënyrë të përkohshme e rregullon problemin e tyre. Përndryshe, kemi kërkuar nga komunat gjegjëse që të kërkojnë nga Ministria e Shërbimeve Publike që të hyjnë në listën e pagave, ndërsa sa i përket procesit të licencimit të arsimtarëve, këta arsimtarë do t'i marrin mjetet të cilat u takojnë në përputhje me licencimin e arsimtarëve. Kjo është situata në të cilën jemi. Është fjala për nëntë arsimtarë të cilët janë në Burgun e Dubravës dhe të cilët realisht pagat i kanë marrë me kohë.

Zonja deputete, nëse doni unë mund t'iu jap edhe në formë pllakative listën e pagave që e kanë marrë me kohë, do të thotë shtesat i marrin.

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër! Vazhdojmë. Pyetja e radhës. Deputeti Naim Rrustemi, pyetje për ministren e Energjisë dhe të Minierave, zonjën Justina Pula-Shiroka.

Zoti deputet, mund ta parashtroni pyetjen.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit!

I nderuar Kryetar,

Të nderuar deputetë,

Çështja: Feronikeli i është shitur kompanisë "Alferon". Kontrata për furnizim me energji elektrike të kompanisë "Alferon" i ka shkaktuar dëme të mëdha KEK-ut. Ndikimi i dallimit shumë të madh ndërmjet çmimit të blerjes së energjisë elektrike dhe çmimit që i afrohet kompanisë "Alferon" vetëm për dy vjetët e fundit 2007 dhe 2008 parashikohet se ka shkaktuar dëme që kalojnë shumë prej dhjetëra milionë euro.

Pyetja: A mund të tregohet saktë sa humbje i është shkaktuar KEK-ut për vitin 2007 dhe për vitin 2008 dhe a keni iniciuar ndonjë procedurë hetimore për kallëzim penal ndaj veprimeve që kanë shkaktuar dëme ndaj KEK-ut?

KRYETARI: Zonja ministre, e keni fjalën.

MINISTRJA JUSTINA PULA-SHIROKA: Faleminderit, Kryetar i Parlamentit!

I nderuar zëvendëskryeministër, Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Është e vërtetë se Feronikeli është një prej konsumatorëve më të mëdhenj të cilët e konsumojnë energjinë elektrike. Çmimet e kontratës për Feronikelin i ka bërë Zyra e Rregullatorit, e cila është një komision i pavarur. Kontratën e ka Korporata Energjetike, të cilën ne deri më tani e kemi kërkuar zyrtarisht prej Korporatës dhe nuk e kemi marrë ende zyrtarisht kontratën e vërtetë. Në ndërkohë e kemi kërkuar edhe një marrëveshje apo

e kemi kërkuar edhe një informatë nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë, të cilën ende zyrtarisht nuk e kemi marrë. Ne si Ministri jemi duke bërë politikat rreth sektorit të energjisë dhe në kuadër të këtyre politikave jemi duke shikuar që t'u mundësojmë të gjithë konsumatorëve të cilët janë të pavarur, apo konsumatorëve që shpenzojnë energji elektrike, të furnizohen me linja të veçanta dhe në kuadër të këtyre politikave kërkojmë nga Korporata që atyre t'u jepet mundësi që të importojnë prej vendeve që ata dëshirojnë apo që e gjejnë ndonjë çmim më të arsyeshëm. Deri më tani kemi filluar një proces, mirëpo ende nuk kemi ardhur deri te ndonjë zgjidhje.

KRYETARI: Faleminderit, ministre! Deputet, a keni pyetje shtesë? Urdhëro! E ka fjalën deputeti Naim Rrustemi.

NAIM RRUSTEMI: E nderuar ministre,
Në njërën prej mbledhjeve të Kuvendit, para disa mbledhjeve, me fjalë të tjera, para mbledhjes së katërt të kësaj mbledhjeje, ju keni deklaruar se jeni duke i bërë analizat për vitet 2006, 2007 dhe 2008 dhe nuk kemi dashur të dalim kuturu me të dhëna pse po fshehët kontrata e KEK-ut? Ministria e Energjisë dhe e Minierave është përgjegjëse për atë punë. Me fjalë të tjera, pse nuk deklarohet publikisht që ne kemi humbje mbi 30 milionë euro – 300 shkolla në Kosovë. Pse nuk dilet publikisht të thuhet se po, në kontratë energjia elektrike që i shitet KEK-ut është 3.2 cent për kilovat orë, kurse importi është 116 cent për kilovat orë. Pse? Pra, ta dimë që kemi humbje dhe dikush duhet ta paguajë atë dënim për atë humbje që është...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Pa koment. Ministre, a keni përgjigje?

MINISTRJA JUSTINA PULA-SHIROKA: Çmimi mesatar i energjisë elektrike në vitin 2008 ka qenë 112 euro për 1 megavat orë. Është e vërtetë se vetëm në këtë vit kemi pasur diku mbi 5.9 milionë euro humbje sa i përket furnizimit me energji elektrike të Ferronikelit. Unë thashë, nuk është që nuk dëshiroj t'i qesim këto të dhëna, mirëpo ne dëshirojmë të shohim kontratën e vërtetë, të cilën ende nuk e kemi marrë. Ndoshta vetëm Ministria e Energjisë dhe e Minierave është ministri e cila bën politika dhe strategji, është ministria tjetër e cila është pronare e korporatave energjetike dhe jemi duke biseduar dhe duke shikuar që të sigurojmë kontratën e vërtetë. Në kuadër të kësaj kontrate, unë vetëm si Ministri e Energjisë dhe e Minierave mund t'i afrojmë Korporatës Energjetike politikën të cilën e kemi ne, që të sigurojmë energji elektrike nga KOST-i apo nga ndonjë lidhje e veçantë, jo vetëm prej prodhimeve të termocentralit A dhe B po edhe nga importi që mund ta zgjedhë cilindo vend si mundësi të sigurimit të energjisë elektrike.

KRYETARI: Faleminderit! Pyetja e radhës, deputeti Driton Tali, pyetje për Kryeministrin, zëvendëskryeministrin apo ministrin e Arsimit, zotin Enver Hoxhaj, por pasi e kemi ministrin, mendoj se më mirë është për ministrin. Urdhëro, deputet!

DRITON TALI: Zoti Kryetar, më falni, por vetëm një përmirësim të vogël, për zonjën ministre. KEK-u prej Damir Fazliqit, vetëm sa për opinion, KEK-u prej kompanisë së Damir Fazliqit dhe të Vojin Llazareviqit ka nënshkruar kontratë për 132 centë, euro më falni – megavatin, më 8 dhjetor me kompaninë "Rudnap".

Sidoqoftë, pyetja për ministrin e Arsimit është: Kur do ta krijoni Fondin nacional për arsim, ashtu siç keni premtuar?

KRYETARI: Urdhëroni, ministre! Ju lutem, deputetë, shfrytëzoni vetëm për pyetje. Në rend dite janë pyetjet parlamentare.

MINISTRJA JUSTINA PULA-SHIROKA: Ju lutem, deputetë, Ministria e Energjisë dhe e Minierave i bën politikat dhe strategjinë. Nuk merret me tregtinë e importit të energjisë elektrike. Nuk merret me import të energjisë elektrike dhe nuk merret me asnjë tender që ka të bëjë me KEK-un. Ju lutem! Unë, thashë shumë mirë, çmimi mesatar është 112 euro për një megavat orë, ju lutem. Për importin e energjisë munde të bisedoni direkt me Korporatën .

KRYETARI: Driton, Në rend të parë, ti e di, e ke bërë pyetjen dhe pyetjen e ke për ministrin e Arsimit, prandaj të lutem ia drejton pyetjen ministrit të Arsimit.

E ka fjalën deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Zoti ministër, kur do ta krijoni Fondin nacional për arsim, ashtu siç keni premtuar? Faleminderit!

MINISTRI ENVER HOXHAI: Ju faleminderit! I nderuar zoti Kryetar, Të nderuar deputetë,

Konceptet e fondeve nacionale për arsim, zakonisht synojnë t'i arrijnë dy objektiva. Objektiva e parë është që ta shndërrojnë arsimin në një prioritet kombëtar. Mendoj që gjatë vitit 2008 ne me punën tonë kemi bërë përpjekje maksimale që të arrijmë ta shndërrojmë arsimin në një prioritet kombëtar për të gjithë Qeverinë e Kosovës dhe që arsimi të mos kuptohet si punë e vetëm Ministrisë së Arsimit, por të kemi një qasje ndërqeveritare dhe ndër sektoriale në arsim. Kjo dëshmohet me atë që gjatë vitit të kaluar kemi mbështetur shumë politikën e një arsimi shumë më gjithëpërfshirës me rritjen e hapësirës shkollore, me modernizimin e hapësirës shkollore, me sigurimin e teksteve falas, me rritjen e pagave të arsimtarëve, me shndërrimin e objektivës tonë që në strategjinë e arsimit parauniversitar ka qenë që mësimi të zhvillohet me dy ndërrime në vitin 2017 që ne do ta kemi në vitin 2009. Dhe, së dyti, nëpërmjet dyfishimit të buxhetit, më lejoni vetëm t'ju përmendi që në vitin 2006 ka pasur 27 milionë dhe në vitin 2008 kemi pasur 56 milionë, ndërsa në vitin 2009 së bashku me Universitetin e Prishtinës kemi 55 milionë. Do të thotë, ky është koncepti i fondeve nacionale dhe si të tilla ne nuk kemi ndonjë qeveri e cila funksionon në bazë të konfederatës që secili duhet ta ketë fondin, por rritja e buxhetit dhe shndërrimi i prioritetit nënkupton edhe jetësimin e një qëllimi i cili ka qenë i deklaruar që të kenë fonde sa më të mëdha për arsim.

KRYETARI: Faleminderit! A ke pyetje shtesë deputet?

DRITON TALI: Kjo është edhe një pyetje e radhës që ministri nuk po më përgjigjet konkretisht. Unë pyetjen e kam bërë në bazë të ekspozesë të cilën Kryeministri e ka bërë më 9 janar të vitit të kaluar, e keni në faqen 31, ku thotë, po e lexoj: “Do ta fillojmë këtë projekt të madh duke krijuar Fondin nacional për arsim”. Domethënë, ka qenë atëherë kur kjo qeveri është inauguruar. Ky premtim ka qenë i Kryeministrit. Unë po them edhe një herë është nga ato pyetjet e mia që zoti ministër asnjëherë s’po mi përgjigj, mbase është i zënë me punë atje duke ndërtuar shkolla e s’po merret me kesi... Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Mendoj që, nëse citohet ekspozita e Kryeministrit, do të ishte mirë të përmenden edhe ato punë të cilat janë përmendur në ekspozitë të cilat gjatë vitit 2008 janë realizuar të gjitha. Dhe, së dyti, koncepti i fondeve është ide për ta shndërruar diçka në një prioritet më të madh, nuk do me thënë që teknikisht duhet të ketë një buxhet të veçantë për Ministri të Arsimit, si fond të veçantë, meqë thjesht ne jemi Qeveri dhe nuk jemi një konfederatë e cila ka vija të veçanta programore dhe fonde të veçanta. Realisht, nuk di se çfarë koncepti keni për fonde, përveç kësaj që ekziston edhe në vendet tjera.

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Radha është për deputeten Sala- Berisha-Shala, pyetje për ministren e Energjisë dhe të Minierave zonjën Justina Pula- Shiroka. Deputete, mund ta parashtroni pyetjen.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përsëritet për të gjithë!

Çështja është se furnizimi me energji elektrike dihet që është përmirësuar dukshëm në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Kapacitetet gjeneruese të termocentraleve në Kosovë nuk i plotësojnë të gjitha kërkesat dhe nevojat e qytetarëve tanë. Gjithnjë duke krahasuar të njëjtën periudhë me vitin e kaluar është me rëndësi të dihet përgjigja në këtë pyetje- Sa po plotësohen këto kërkesa nga importi i energjisë elektrike dhe sa nga prodhimi në vend?

KRYETARI: Ministre, e ke fjalën!

MINISTRJA JUSTINA PULA- SHIROKA: Situata energjetike në Kosovë relativisht është shumë më e mirë se sa ka qenë në vitet e kaluara. Prodhimi i termocentralit Kosova A, B dhe një sasi shumë e vogël e Ujmanit e ka realizuar deri diku kërkesën e konsumatorëve me energji elektrike në Kosovë. Prodhimi i tërësishëm i energjisë elektrike ka qenë 4.506 gigavatë orë. Në kuadër të këtij kapaciteti, diku 86.4% janë realizuar me prodhimet vendore dhe vetëm 12.6% është importi nga vendet e huaja. Në kuadër të këtij importi duhet të cekim se kemi importin bruto dhe importin neto. Importi bruto ka qenë diku 468 gigavatë orë dhe nëse e shikojmë si bruto është diçka pak më i madh se vitin e kaluar. Po nëse e shikojmë importin në gigavatë orë sivjet, ai është relativisht diku rreth 15% më i vogël se importi neto i vitit të kaluar. Një gjë duhet të cekim se në kuadër të importit neto 70% ka qenë importi vendor dhe vetëm 30% ka qenë shkëmbimi i energjisë elektrike dhe në kuadër të këtij raporti, 70% import dhe 30% shkëmbim me energjinë vendore, që do të thotë se në kuadër të Korporatës Energjetike të KEK-ut kemi një menaxhim më të mirë sa i përket prodhimit dhe shkëmbimit të energjisë elektrike.

KRYETARI: Faleminderit, ministre! Deputete, ke pyetje shtesë? Faleminderit! Vazhdojmë. Deputetja Zylfije Hundozi, pyetje për ministrin e Bujqësisë, zotin Idriz Vehapi. Deputete e keni fjalën!

ZYLFIJE HUNDOZI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Në raportin e progresit të Komisionit Evropian të vitit 2008 Ministrisë së Bujqësisë i është dhënë vërejtje se nuk ka bërë veprime konkrete për të rregulluar sektorin e verërave dhe zbatimin e Ligjit për verërat në përputhshmëri me *acquis communautaire*. E pyes

ministrin e Bujqësisë, a keni ndërmarrë diçka konkretisht për këta muaj që të rregulloni sektorin e verërave? Faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Zonja deputete,

Dihet se rregullimi i Sektorit të verërave është një sfidë e veçantë edhe për vetë vendet e BE-së për faktin se legjislacioni ndryshon në vazhdimësi. Sa i përket aktivitetit legjislativ Ministria e Bujqësisë për këtë vit ka planifikuar të vazhdojë me kompletimin e legjislacionit, përkatësisht nxjerrjen e legjislacionit sekondar nga Ligji i verërave dhe të njëjtat janë përcaktuar edhe si aktivitete në planin e veprimit të partneritetit evropian i cili është në rishikim dhe pritet të marrë formën përfundimtare. Aktivitetet që janë përcaktuar për të rregulluar sektorin e verërave kanë rrjedhur sipas dinamikës së planit të veprimit të partneritetit evropian në të cilin është paraparë të nxirren këto udhëzime administrative. Udhëzimi administrativ për regjistrat e brendshëm dhe të jashtëm të ndërmarrjeve prodhuese, të rrushit, verës dhe prodhimeve tjera është duke u zbatuar. Udhëzimi administrativ numër 03/2009 për ndarjen e territorit në rajonin vreshtor të Kosovës, edhe ky udhëzim administrativ është i përfunduar dhe i nënshkruar. Në përfundim e sipër është udhëzimi administrativ për caktimin e rregullave për eksportin dhe i importin e verës i cili është në përfundim e sipër dhe shumë shpejt do të nënshkruhet. Ndërkaq, në fazën e draftimit për këtë vit janë paraparë edhe këto udhëzime administrative. Udhëzimi për caktimin e rregullave për kompensim në shërbimet që ofron Enti i Vreshtarisë dhe i Verëtarisë. Pastaj udhëzimi administrativ për caktimin e kufijve të epërm dhe të poshtëm për parametrat nga analizat fiziko-kimike të verës, si dhe udhëzimi administrativ për caktimin e kriterëve të shënimeve në etiketë të verës. Po ashtu do të përmirësohet udhëzimi administrativ numër 11/2006 për përcaktimin e kriterëve për marrjen e mostrave dhe vlerësimin e verërave. Dua të theksoj këtu para jush se për të harmonizuar dhe për të afruar legjislacionin nacional në përputhshmëri me atë të BE-së për sektorin e verërave, së bashku me ministrat e vendeve të rajonit në dhjetor të vitit të kaluar, në Konferencën rajonale për reformat në sektorin e verës me vendet e BE-së...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! A ke pyetje shtesë deputete?

ZYLFIJE HUNDOZI: Zoti Kryetar, desha edhe një herë ta pyes ministrin se sa kohë iu nevojitet që t'i përfundoni këto dokumente se raporti i ri i progresit për Kosovën po hartohet dhe do të kryhet deri në fillim të tetorit. Nuk është në interes të Kosovës që edhe një herë kjo vërejtje të dalë në raport për arsye se sivjet e kemi një synim që raporti i fizibilitetit për Kosovën të jetë pozitiv. Dhe, para se të përgjigjeni, desha t'ju lus, nëse bën ato për t'i deponuar me shkrim te Kryetari se po na vyen për punën e Komisionit.

KRYETARI: Urdhëroni ministër, e keni fjalën.

MINISTRI VEHAP IDRIZI: Unë këtu i kam të shënuara të gjitha afatet që janë përcaktuar për t'i realizuar këto udhëzime administrative dhe afati i fundit është në 3 mujorin e tretë të vitit 2009.

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Vazhdojmë. Deputetja Zylfije Hundozi, pyetje për ministrin e Arsimit, zotin Enver Hoxhaj. Deputete e ke fjalën.

ZYLFIJE HUNDOZI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Në raportin e progresit të Komisionit Evropian për Kosovën konstatohet se integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në shkolla nuk është i mjaftueshëm, por edhe statistikat e bëra prej Handikosit të përkrahura nga UNICEF-i janë skandaloze. Japin vlera 49% të fëmijëve me aftësi të kufizuara fizike janë të paarsimuar, 71% të fëmijëve me aftësi të kufizuara mendore janë paarsimuar, 33% të fëmijëve të verbër janë të paarsimuar dhe 15% të fëmijëve të shkurtër janë të paarsimuar. E pyes ministrin e Arsimit, cilat veprime të realizueshme i keni ndërmarrë që ta përmirësoni integrimin e këtyre fëmijëve me nevoja të veçanta në shkolla? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti ministër, e ke fjalën.

ENVER HOXHAI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar deputetë,

E nderuara zonja deputete,

Ne, si Ministri e Arsimit, nuk jemi shumë të kënaqur me procesin e integritetit të nxënësve me nevoja të veçanta në shkolla speciale dhe në shkolla të tjera por është një proces i cili nuk varet shumë direkt edhe nga krejt Ministria e Arsimit, shpeshherë varet edhe nga vetëdijesimi i prindërve se sa prindër janë vërtetë të interesuar që t'i sjellin këta nxënës në objektet shkollore. Dua vetëm të ju informoj që në Republikën e Kosovës ekzistojnë shtatë shkolla speciale, në Prishtinë, Pejë, Prizren, Shtime dhe në Mitrovicë. Përderisa në Prishtinë së bashku me komunën e Prishtinës, në kryeqytetin tonë gjatë këtij viti do të fillojë ndërtimi i një qendre të madhe burimore e cila mbi të gjitha do të mundësojë që të integrohen sa më shumë nxënës që një pjesë e madhe janë nga komuna e Prishtinës, rrethi ose regjioni i Prishtinës. Po ashtu e kemi në zhvillim e sipër një koncept të ri që të mos kemi vetëm shkolla speciale ku këta nxënës janë të izoluar nga bota por të kemi qendra burimore të cilat iu mundësojnë që të integrohen gradualisht në klasë të bashkëngjitura në shkolla të rregullat ose edhe në klasë të veçanta brenda për brenda shkollave të rregullta. Sot në Republikën e Kosovës ekzistojnë 70 klasë të tilla. Gjatë vitit të kaluar kemi hapur 5 klasë të reja, gjatë këtij viti planifikohen të hapen edhe 3 të tjera. Statistikat thonë që ne kemi 909 nxënës të cilët janë në të tri nivelet. Dua të përmendi që edhe në Universitet të Prishtinës kemi siguruar kuotë shtesë për nxënësit me aftësi të veçanta ndërsa aktualisht kemi 257 mësimdhënës të cilët janë të integruar në proceset mësimore edhe në shkolla speciale edhe në qendrat burimore edhe në klasë të bashkëngjitura. Po ashtu gjatë këtij viti planifikohet përveç ndërtimit të një qendre burimore, një shkolle speciale në Prishtinë e cila do të jetë shumë e madhe që të trajnohen edhe 450 mësimdhënës në fushën e arsimit special, ndërsa deri më tash kemi 1800 të cilët janë të trajnuara me metodat më moderne sa i përket arsimit për nxënës me nevoja të veçanta.

E nderuara deputete, zonja profesoreshë,

Dua të ju informoj që ne si Ministri kemi formuar një grup punues i cili merret me vërejtjet e raportit të progresit të Komisionit Evropian dhe ky Grup punues në formë konkrete përcjell punën e Ministrisë me qëllim që sivjet, meqë kemi studimin e fizibilitetit, ne si Ministri ta kryejmë punën tonë dhe këto kërkesa që i ka Komisioni Evropian deri në fund të vitit 2009 të jenë të plotësuara.

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputete, a ke pyetje shtesë?

ZYLFIJE HUNDOZI: Faleminderit! S'jam e kënaqur veç nëse bën të deponohet me shkrim ajo përgjigje.

KRYETARI: Mirë, faleminderit! Deputetja Zylfije Hundozi, pyetje për ministrin e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, zotin Mahir Yagcilar. Deputete, mund ta parashtroni pyetjen.

ZYLFIJE HUNDOZI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Nga 52 projekte të planit të veprimit për mjedis për periudhën 2007-2010 ju keni realizuar vetëm 4. Pyes ministrin e Mjedisit, nëse për dy vjet keni realizuar vetëm 4 projekte, për sa kohë do të jeni në gjendje t'i realizoni edhe 48 projekte tjera?

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, i nderuar Kryetar!

Të nderuar ministra dhe deputetë,

Zonja deputete Hundozi,

Plani i Kosovës për veprim në mjedis 2006-2010 është hartuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në prill të vitit 2006 dhe ishte dorëzuar në Qeveri për aprovim. I njëjti është aprovuar më 30 qershor 2007 dhe këtu është një humbje prej 1 vit e gjysmë, por është një dokument vërtet kualitativ, i rëndësishëm dhe mjaft i dobishëm për çështjet mjedisore. Ky plani vërtet përmban 52 projekte që duhet të realizohen deri në vitin 2010. Vlera e të gjitha projekteve është përafërsisht 17 milionë euro, pa llogaritjen e kostos të dy projekteve të cilat llogari mund të bëhen vetëm pas realizimit të projekteve paraprake. Mund të themi se kjo vlerë me rastin e fillimit të realizimit të projekteve ndryshon, sepse implikohen edhe shpenzime tjera të paparapara me rastin e llogaritjes së kostos të paraqitura të projekteve.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është bartëse për 33 projekte. Në 12 projekte iniciues janë institucionet tjera, kurse Ministria e Mjedisit dhe planifikimit Hapësinor është zbatues dhe për 7 projekte bartës janë institucionet tjera të Qeverisë.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor bazuar në planin e Kosovës për veprim në mjedis dhe në planin e punës ka realizuar një sërë veprimesh, por para vetes ka edhe sigurisht shumë sfida që duhet të realizohen me qëllim të përmirësimit të gjendjes së mjedisit dhe shëndetit të popullatës.

Nga plani i veprimit në mjedis 21 veprime janë iniciuar, tash prej tyre janë disa të kryera dhe të tjerat janë në realizim e sipër. Me këtë rast dot ë japim edhe një pasqyrë të veprimeve të realizuara dhe atyre të iniciuara. Projektet e realizuara janë: Projekti për rehabilitimin e depove të vjetra në komunat: Prizren, Gjakovë dhe Kaçanik; rishqyrtimi i rregulloreve mbi standardet për cilësinë e ujit të pijshëm; miratimi i Ligjit për kemikate; Miratimi i Ligjit për organizmat e modifikuar gjenetikisht; Vlerësimi i gjendjes...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputete, ke pyetje shtesë? Urdhëroni, deputete!

ZYLFIJE HUNDOZI: Zotni ministër, unë ju pyeta për afatet kohore, konkrete, kur mundeni t'i kryeni projektet e parapara dhe sa, sepse edhe 8 muaj kanë mbetur deri te shpallja e raportit të ri të progresit, e pyetja ime njëkohësisht është edhe vërejtje në Raportin e progresit për Kosovën në vitin 2008.

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Po, unë kam shpjeguar se ekzistojnë projekte dhe janë prej pesë viteve, prej vitit 2006-2010, tash jemi në vitin 2009. E kemi realizuar saktë ose janë katër projekte plotësisht të kryera, por janë në vazhdim e sipër edhe këto projekte dhe projektet tjera, si futja në lëndë për mjedis dhe zhvillimin e qëndrueshëm në Fakultetin Xehetar-metalurgjik, në Fakultetin e Teknologjisë është hapur Dega për Mbrojtjen e Mjedisit, shtytja dhe mbështetja e bujqësisë organike në Kosovë, vlerësimi i gjendjes mjedisore të minierave të Artanës dhe Stan-Tërgut, miratimi i Ligjit për bujqësinë organike, planet lokale të veprimit në mjedis: Gjilan, Ferizaj, Pejë, Gjakovë, Klinë; botimi i revistës mjedisore, njoftimi me mënyrat e edukimit mjedisor, raporti për gjendjen e mjedisit kështu që krahas atyre katër projekteve të realizuara më sipër kemi edhe 11 projekte dhe janë në vazhdim ose projekte të iniciuara tjera plus 11, por duhet të jemi të vetëdijshëm se për realizimin e të gjitha projekteve nevojitet një kosto përafërsisht 17 milionë euro.

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputeti Berat Luzha, pyetje për ministren e Drejtësisë, zonjën Nekibe Kelmendi. Deputet, mund ta parashtroni pyetjen.

BERAT LUZHA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Shtetasi dhe qytetari i Kosovës, Remzi Hoxha, nga Kaçaniku, ishte rrëmbyer dhe pastaj ishte zhdukur në vitin 1995 në Tiranë. Ai ishte një veprimtar i dalluar politik, njëkohësisht edhe një biznesmen i suksesshëm. Deri tash nuk është zbuluar shkaku i zhdukjes së tij, as autorët e krimit dhe as vendi ku ndodhet trupi i viktimës.

Ndërkohë, në Tiranë po zhvillohet një gjykim maratonik lidhur me zhdukjen apo vrasjen e supozuar të shtetasit të Kosovës, Remzi Hoxha. A është e njoftuar zyrtarisht Ministria e Drejtësisë për procedurat dhe për gjykimin në Tiranë që po zhvillohet lidhur me zhdukjen e shtetasit të Kosovës dhe çka ka ndërmarrë për një gjykim të drejtë dhe korrekt. Kjo është pyetje për ministren.

KRYETARI: Ministre, e keni fjalën.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: I nderuar Kryetar i Parlamentit,

I nderuar zëvendëskryeministër, kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti deputet Luzha,

Ministrisë së Drejtësisë nuk i ka arritur asnjë informatë nga Republika e Shqipërisë, përkatësisht institucionet, qoftë diplomatike apo gjyqësore lidhur me zhdukjen enigmatike të shtetasit dhe të veprimtarit të shquar, zotit, tash të ndjerë, Remzi Hoxha. Ekziston mundësia që të jetë informuar, ndoshta, UNMIK-u, sepse për komunikim ndërkombëtar UNMIK-u nuk i ka transferuar kompetencat deri me themelimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme. Informatat do të duhej të vinin nëpërmjet kanaleve diplomatike, që do të thotë, nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme, por deri më tash nuk kemi kurrfarë informate.

KRYETARI: Ke pyetje shitesë?
Deputeti Berat Luzha e ka fjalën.

BERAT LUZHA: Ministria e Drejtësisë a ka kërkuar ndonjë informatë nga Ministria e Drejtësisë së Tiranës apo nga Qeveria e Tiranës?

KRYETARI: ... vërtet, ndërhyrja e shtetit në shtet tjetër mendoj që nuk është për këtë lëndë, po nëse do ministria, mund të përgjigjet.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Meqë nuk kemi të bëjmë me çështje të bashkëpunimit penal ndërkombëtar, sepse atje kemi viktimën e jo shtetasin kosovar, i cili i është nënshtruar një procedure penale, Ministria e Drejtësisë nuk ka ndërmarrë asnjë veprim.

KRYETARI: Faleminderit, vazhdojmë!
Deputetja Myrvete Pantina, pyetje për ministrin e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, zotin Mahir Yagcilar. Deputete, e keni fjalën.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti Kryetar!
Në bazë të të dhënave, lumi Sitnicë i takon kategorisë së lumenjve me shkallë më të lartë të ndotjes, konsiderohet lum i vdekur. Ky lum kalon nëpër komuna të mëdha, të cilat nuk kanë impiante për trajtimin e ujërave të zeza, si edhe pranë gjigantit industrial KEK, i cili bën ndotjen e madhe të këtij lumi sa që nuk mund të përdoret as për ujtitje.

Vendbanimet që kanë shtirrje në të dy anët e lumit Sitnicë, e që shfrytëzojnë ujin e puseve, janë në shkallë të lartë të rrezikshmërisë të shëndetit të njerëzve dhe të botës bimore dhe shtazore.

Zoti ministër, Ministria e juaj a planifikon të ndërmarrë diçka për të mbrojtur lumin Sitnicë nga ndotësitë?

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, i nderuar Kryetar!

Të nderuar deputetë, ministra,

E nderuara deputete Pantina,

Është e saktë se në Kosovë ende nuk ekziston asnjë impiant për trajtimin e ujërave të zeza, përveç si një pilot projekt në komunën e Skenderajt. Por, para se t'ju përgjigjem në pyetjen e juaj, së pari dëshiroj t'ju jap disa informata të cilat i kemi realizuar apo jemi në realizim e sipër për lumenj si dhe për vlerat e projektit, si për shembull, rregullimi i lumit Mirusha në Gjilan gjatë vitit 2008, projekti vazhdon deri në vitin 2011. Vlera është 1.700.000 por, gjithashtu, edhe për vitin 2009 kemi investimin prej 1.000.000€. Pastrimi i lumit Sushica, në Istog, gjithashtu afër 300 mijë euro, rregullimi i lumit Tërstena në komunën e Vushtrrisë, prapë vlera 1.500.000 euro, rregullimi i lumit Klina në Skenderaj, përafërsisht 500 mijë euro.

Deri tani ne të gjithë jemi në rrjedha lidhur me zhvillimet e deritanishme në Republikën e Kosovës në aspektin e përgjithshëm, por duke mos mohuar edhe njohuritë mbi gjendjen në fushën e ujërave dhe të mjedisit në përgjithësi, dihet se mjedisi është një fushë e cila atakohet nga të gjitha anët, sepse vetë jeta e njeriut është e pandashme nga mjedisi.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor gjithashtu është duke punuar në hartimin e ligjeve për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit.

Sa i përket lumit Sitnica, është një lum i cili përshkron pjesën më të madhe të rrafshit të Kosovës. Nuk mund të themi se kemi një gjendje të kënaqshme të cilësisë së ujit që ky lum ka. Por, lirisht mund të themi se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor përmes Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës, i cili monitoron ujërat në shkallë vendi, herë pas herë përgatit raporte lidhur me gjendjen ose mbi gjendjen.

Gjithashtu, Departamenti i ujërave ka të dhëna për infrastrukturën e ujërave në lumin Sitnica. Janë propozuar projekte për renovimin e bankinave dhe të infrastrukturës ujore në përgjithësi, por problemi më i madh është te buxheti i vogël për implementime të këtij lloji ...

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Deputete, ke pyetje shtesë.
Fjalën e ka deputetja Myrvete Pantina.

MYRVETE PANTINA: A do të thotë kjo që duhet ende të pres ky lum në mënyrë që të mbrohet nga ndotësitë, sipas fjalëve që thatë deri më tani.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, edhe një herë!
Për fat të keq, gjendja me ujëra ose me trajtimin e ujërave të zeza është siç është në Kosovë, jemi duke u munduar të intervenojmë në çdo regjion dhe shpresojmë dhe besojmë se në bazë në bazë mundësive buxhetore do të bëjmë projektin edhe për lumin Sitnica.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Deputeti Driton Tali, pyetje për Kryeministrin apo ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zoti Ahmet Shala.
Deputet, e lexoni pyetjen.

DRITON TALI: Faleminderit!
Zoti ministër, më 22 janar të këtij viti drejtori i PTK-së e konfirmoi se është nënshkruar kontrata mes Dardafonit dhe PTK-së, ndonëse nuk u bënë publike konditat, por sipas burimeve, profiti do të ndahet në proporcion 73% për Dardafonin dhe 27% për PTK-në. Kjo kontratë, e cila është bazuar në ofertën e Dardafonit, të 8. tetorit 2008, ku parashihej që profiti të ndahej në proporcion 22% për PTK-në dhe 78% për Dardafonin, Bordi i PTK-së e aprovoi më 20 tetor të vitit 2008, edhe pse grupi i menaxherëve dhe grupi i ekspertëve të PTK-së ishin deklaruar kategorikisht kundër kësaj kontrate të cilën ata e patën vlerësuar si shumë të dëmshme komercialisht dhe strategjikisht për PTK-në.

Sa për hir të opinionit e ceka se Dardafoni me këtë kontratë nuk do të bëjë asgjë tjetër, veçse të shes mbushje, kartela grithëse të valës, do me thanë, Dardafoni do të përdorë tërë infrastrukturën e Valës dhe marrë për vete 73% të afarizmit. Gjithkund në botë proporcioni është 20% për ...

KRYETARI: Faleminderit! Ministër, keni përgjigje?.

(Reagim i deputetit Tali)

KRYETARI: Regjia ka vendos, unë e respektoj regjinë, ministri mund të përgjigjet. Unë nuk e mati kohë, kohën e matë regjia, dhe u krye pyetja. Bëje pyetjen, po tjera herë të jesh më i shkurtër, 2 minuta i ke. Po, urdhëro!

DRITON TALI: Nejse. Sa për hir të opinionit, po e përsëris edhe një herë se Dardafoni me këtë kontratë nuk do të bëjë asgjë tjetër veçse të shes mbushje, kartela grithëse të valës. Do me thënë, Dardafoni do të përdor tërë infrastrukturën e Valës dhe të marrë për veti 73% të afarizmit. Gjithkund në botë është 20% për operatorin virtual, do me thënë, Dardafoni në këtë rast 80% ndërmarrja, ... pra PTK-ja. Gjithmonë duke pasur parasysh se vlera e tregut kosovar të kësaj industrie është rreth 170.000.000 euro. Dyshimet janë pos përfitimeve të menjëhershme, u mor vesh, edhe se kjo kontratë është nënshkruar qëllimisht në prag të privatizimit të PTK-së për t'ia ulur vlerën asaj. Sipas ekspertëve, kjo kontratë PTK-së do t'ia ulë vlerën deri në 70%, që thënë në shifra, vjet në kesi vakti PTK-ja vlerësohej 1 miliardë euro, tash me këtë kontratë ajo nuk do të ketë vlerën më shumë se 300 milionë euro, e mbase më pak. Pyetja: Sipas Kodit penal të Kosovës, neni 237, kontratat e dëmshme të cilat e dëmtojnë organizatën më shumë se 100 mijë euro, janë kundërligjore dhe të dënueshme deri në 10 vite me burgim. Çfarë keni ndërmarrë ju, zoti ministër, si përgjegjës për organizatat publike për ...

KRYETARI: Urdhëro ministër! Ke bërë pyetjen e gjatë, deputet.

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar, zoti Kryetar i Parlamentit,

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

I nderuari zoti deputet,

Projekti i operatorit virtual, si ide ka filluar në vitin 2007. I tërë procesi i përzgjedhjes së operatorit virtual të rrjetit mobil është lansuar, përkatësisht shpallur nga PTK-ja përmes thirrjes së shprehjes të interesit në WEB faqen e PTK-së, shtypin lokal dhe atë ndërkombëtar, siç është Fajnechaill Tajms e të tjera gjatë kuartalit të dytë të vitit 2007.

Bordi i drejtorëve, i atëhershëm, i ka aprovuar dhe publikuar kriteret finale të shprehjes së interesit për të lidhur marrëveshje partneriteti me një lansim ekonomik të mundshëm për operatorin virtual mobil. Shpallja është publikuar nga PTK, më 3 tetor të vitit 2007, me afat përfundimtar më 15 nëntor 2007, ora 15,00. Në përgjigje të kësaj ftese, tri kompani kishin aplikuar tek ART-ja, sipas informatave që kam, për licencë për operatorin virtual të rrjetit mobil, ndërsa nga këto rezulton se operatori ekonomik Dardafon ka plotësuar dokumentacionin dhe kushtet më së miri, mirëpo si pasojë e mungesës së infrastrukturës ligjore të asaj kohe, procesi i negocimit të marrëveshjes është zhagitur për... Dhe, në shkurt të vitit 2008, ART-ja, pra Rregullatori i Telekomunikacionit ka aprovuar kornizën rregullatore për operatorët virtual të rrjetit mobil. Në qershor të vitit 2008, ART-ja licencon operatorin ekonomik Dardafon konform Ligjit mbi telekomunikacionin dhe Rregulloren e UNMIK-ut të vitit 2003/16 dhe merr rekomandimin nga ART-ja. Pas të gjitha këtyre, menaxhmenti dhe bordi i drejtorëve të PTK-së kanë konstatuar plotësimin e kushteve të kërkuara nga operatori ekonomik dhe kanë vendosur që të fillojë të negociojë marrëveshjen komerciale me Dardafonin. Projektin e operatorit virtual të rrjetit mobil, numrin e klientëve nuk mund të kalojë më shumë se 200 mijë klientë, ndërsa ndarja e profitit është 27% për postën dhe 73% për Dardafonin, pa pasur ndonjë investim nga ana e postës.

Posta krijon grupin punues për negocimin e marrëveshjes. Pas paraqitjes së raportit, Posta i paraqet bordit të drejtorëve dhe bordi i drejtorëve vendos. Ishte shtruar pyetja, çka keni ndërmarrë? Qeveria e Kosovës, Ministria e Ekonomisë dhe Financave...

KRYETARI: Edhe një minutë.

MINISTRI AHMET SHALA: ...Jo, duhet sqaruar edhe publikut se po flitet thua se u bë nami, a çdo gjë është konform ligjit. Ligji për ndërmarrjen publike, neni 18, i jep të gjithë përgjegjësinë Bordit të drejtorëve të ndërmarrjes publike të Qeverisë dhe menaxhmentit me ndërmarrjet publike. Nuk është Qeveria ajo e cila qeverisë më, jo më. E kam fjalën, për socializëm, ndoshta, jo në socializmin jugosllav, në atë rumunë dhe rus, po, por që kanë dështuar, që të qeverisë drejtpërdrejt me ndërmarrjet publike. Por, çka desha të them? Kushdo, duke ju kërkuar edhe juve, në qoftë se keni argumente të ndryshme dhe të tjera, ju kisha lutur shumë, ekziston ligji, përgjegjës janë kompletë kompania, unë jam në favor të çfarëdo procesi i cili sqaron dhe zbërthen çdo gjë. Ndërsa, ne si Qeveri nuk do të përzihemi në vendimmarrjet biznesore, nuk është Qeveria që vendos për biznesin në ndërmarrje, është bordi dhe menaxhmenti, konform ligjit. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Para se të vazhdojmë me pyetjen shtesë, E njoftoj Driton Talin, le ta lexojë Rregullën 26 pikat 5, 6, 7 dhe 8 dhe ta ketë më të qartë se sa ka kohë për ta bërë pyetjen. Vazhdoje pyetjen shtesë!

DRITON TALIN: Unë e mata veten, zoti Kryetar, po sido qoftë, zoti ministër, me këtë përgjigje ju vetëm sa m'i shtoni edhe më shumë dyshimet. Unë e kam këtu raportin e menaxherëve të PTK-së, të mbajtur më 20 dhjetor 2008. Sidoqoftë, oferta origjinale ka qenë 80% për PTK-në, kurse operatorit virtual i është dhënë 20%, sa për informim të opinionit. Tjetër, unë e thërras EULEX-in këtu, se është zotuar se do ta luftojë krimin dhe korrupsionin, të paktën ashtu është deklaruar, se do të jetë ndryshe nga UNMIK-u, Shtylla IV, që ishte burim i korrupsionit, le të bëjë hulumtime me konzorciumin Dardafon, le të shohë se kush janë aty aksionarë dhe akterët kryesorë, lidhjet që i kanë ndërmjet veti me bartësit e institucioneve shtetërore. Këtu mbase mund ta shikojnë edhe Unitelin dhe, po them, akterët tjerë dhe kontratën në përgjithësi dhe do të shohin se sa vrazhdë është shkelur ligji. Faleminderit.

KRYETARI: Faleminderit! Ministër, ke përgjigje shtesë?

MINISTRI AHMET SHALA: Ndoshta nuk pati nevojë të komentoj më tepër. Konsiderojmë që të gjithë aktorët që dëshirojnë zbatimin e ligjit, mbikëqyrjen e ndërmarrjeve publike, janë absolutisht të mirëseardhur dhe ne do të japim gjithë fuqinë përkrahëse institucionale dhe kadrovike që kemi në institucionin tonë, po flas për Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave. Spekulime të ndryshme le të jenë çështje spekulimesh, ne jemi në bashkëpunim me të gjitha institucionet për të vënë në rend dhe ligj në Kosovë dhe kudo. Faleminderit!

KRYETARI: Për këtë pikë të rendit të ditës koha ka kaluar. Vazhdojmë me pikën e radhës:

- **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për raportin financiar të organizatave të biznesit**

Edhe kjo çështje është tërhequr me kërkesën e sponsoruesit. Vazhdojmë me pikën tjetër të radhës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e Projektligjit me amendimin e propozuar nga komisioni funksional.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e komisionit funksional, zotin Lulzim Zeneli, apo raportuesin e komisionit, nëse e sheh të nevojshme që para deputetëve të arsyetojë raportin me rekomandime. Nuk ka. Atëherë, vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Po vazhdojmë, pra, me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1.

Regjia gati, votojmë amendamentin 1. Tani, a ka kuorum? Nuk ka, si duket, janë 59 deputetë, nuk ka kuorum për të votuar. T'i thërrasim deputetët në qoftë se janë në korridor. Si duket, u bë kuorumi. Tani fillojmë votimin, për së dyti, të amendamentit 1 të Ligjit.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 55 vota “për”, 2 abstenime dhe asnjë kundër, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Votojmë tani. Merrni kartelat dhe lajmërohuni me kohë kush nuk ka kartelë. Unë nuk e di a po voton “kundër” a “për”. Me shkrim bëni një shpresë që filan deputeti s’ka kartelë, ta dimë.

Amendamenti 2.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 47 vota me kartelë, 1 pa kartelë, pra me 48 vota “për”, 2 abstenime dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 48 vota “për” 1 me dorë, pra me 49 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 3.

Sipas informacionit të regjisë, prezentë në sallë janë 63 deputetë. Realisht, po votojnë 51 deputetë, s’po e kuptoj pse nuk po votojnë deputetët.

Ju kisha lutur, që në qoftë se dikush nuk ka kartelë, le të paraqitet me kohë, ta dimë, ose pse nuk po votohet.

Amendamenti 4.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 56 vota “për” me kartelë, 1 pa kartelë, pra me 57 vota “për”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 6.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 47 vota, plus 1 pa kartelë, pra me 48 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 6.

Atëherë, kemi kaluar amendamentin 5, kërkoj falje!

Votojmë amendamentin 5.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 50 vota me elektronikë “për”, 1 pa kartelë, pra me 51 vota “për” dhe 4 abstenime, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 7.

Votojmë tash:

Deputeti Smaka ka vërejtje për amendamentin 7. Urdhëro!

RIZA SMAKA: Ky formulim 5, paragrafi 5, nuk mund të qëndrojë juridikisht, sepse thuhet se pala e pakënaqur kundër vendimit të Qeverisë do të mund të ankohej. Nuk lejohet ankesa kundër vendimit të Qeverisë, po kërkesë - padia në konfliktin administrativ, se s’ka kujt t’i ankohet. Kjo është çështje ligjore me Ligjin për konfliktet administrative. Prandaj, propozoj që të modifikohet jo ankesa, po kërkesë - padia edhe përfundon çështja. Faleminderit!

KRYESUESI: Komisioni, a dëshiron ta komentojë? Tani, si amendament realisht është votuar, do të ju kisha preferuar që para kohe të paraqiteni, para se të votojmë nenin.

Amendamenti 8.

Regjia, votojmë tani:

Konstatohet se me 53 vota me kartelë, 1 pa kartelë, pra me 54 vota “për”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 54 vota me kartelë, 1 pa kartelë, pra me 55 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 9.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 48 vota me kartelë, 1 pa kartelë, pra me 49 vota “për”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 48 vota me kartelë, 1 pa kartelë, pra me 49 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 55 vota me kartelë, 1 pa kartelë, pra me 55 vota “për”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 59 vota me kartelë, 1 pa kartelë, pra me 60 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 57 vota me kartelë, 1 pa kartelë, pra me 58 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 55 vota me kartelë, 1 pa kartelë, pra me 56 vota “për”, 3 abstenime miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 58 vota me kartelë, 1 pa kartelë, pra me 59 vota “për”, 3 vota abstenim, miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 16.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 55 vota me kartelë, 1 pa kartelë, pra me 56 vota “për”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 16.

Janë miratuar të gjitha amendamentet për ligjin. Tani do të votojmë për tekstin e Ligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Nuk është si amendament, shkon si pjesë në tërësi.

Votojmë në tërësi Ligji me të gjitha amendamentet e miratuara.

Regjia, votojmë tani:

Konstatohet se me 56 vota me kartelë, 1 pa kartelë, pra me 57 vota “për”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për vlerësimin dhe ndikimin në mjedis. Faleminderit!

Po vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e mjedisit

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për mbrojtjen e mjedisit dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e Projektligjit me amendamentet e propozuara

nga komisioni funksional.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e komisionit funksional, zotin Lulzim Zeneli, apo raportuesin e komisionit, nëse e sheh të nevojshme që para deputetëve të arsyetojë Raportin me rekomandime. Ka dikush të raportojë? Nuk ka.

Atëherë, të nderuar deputetë, vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara nga komisioni funksional sipas radhës së paraqitur në raport.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani:

Amendamenti 1.

Konstatohet se me 53 vota “për” plus 2 pa kartelë, pra me 55 vota “për”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 1.

Ju lutem, konstatoni kuorumin!

Amendamenti 2.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 52 vota me kartelë, 2 pa kartelë, pra me 54 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 2.

Kuorumi është 63 deputetë, vazhdon të jetë i njëjtë. Kartelat janë të lajmëruara në ekran, 87 kartela. Ju kisha lutur që kartelat e kolegëve të juaj, ose regji t’i tërheq të gjitha kartelat e atyre që nuk janë në sallë. Vetëm t’i shkyçni, që kur të vinë, mund t’i shtypin prapë.

Amendamenti 3.

Regjia, votojmë tani:

Është qesharak votim, 37 vota po dalin, a s’po doni të votoni, nuk po di. Okej, sipas kësaj, nuk po doni të votni.

Konstatohet se me 37 vota, plus 2 pa kartelë, pra me 39 vota “për”, 2 abstenime, kalon amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 52 vota, 2 pa kartelë, pra me 54 vota “për”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 51 vota me kartelë, 2 pa kartelë, pra me 53 vota “për”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 56 vota me kartelë, 2 pa kartelë, pra me 58 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 57 vota me kartelë, 2 pa kartelë, pra me 59 vota “për”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 57 vota me kartelë, 2 pa kartelë, pra me 59 vota “për”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 55 vota me kartelë, 2 pa kartelë, pra me 57 vota “për”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 55 vota me kartelë, 2 pa kartelë, pra me 57 vota “për”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 57 vota me kartelë, 2 pa kartelë, pra me 59 vota “për”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 59 vota me kartelë, 2 pa kartelë, pra me 61 vota “për”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 60 vota me kartelë, 2 pa kartelë, pra me 62 vota “për”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 57 vota me kartelë, 2 pa kartelë, pra me 59 vota “për”, 3 abstenime, 1 “kundër”, miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 62 vota me kartelë, 2 pa kartelë, pra me 64 vota “për”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 62 vota me kartelë, 2 pa kartelë, pra me 64 vota “për”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 58 vota me kartelë, 2 pa kartelë, pra me 60 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 60 vota me kartelë, 2 pa kartelë, pra me 62 vota “për”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 61 vota me kartelë, 2 pa kartelë, pra me 63 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 61 vota me kartelë, 2 pa kartelë, pra me 63 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 20.

Amendamenti 21.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 63 vota me kartelë, 2 pa kartelë, pra me 65 vota “për”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 21.

Amendamenti 22.

Votojmë tani:

Në amendamentin 22 ka vërejtje, zoti Veliu, deputeti Agim Veliu e ka fjalën, ju lutem!

AGIM VELIU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Amendamenti 22 në fakt është një nen i ri që është futur nga komisioni funksional, në të cilën thuhet: “Ministria për Arsimit dhe Shkencë dhe Ministria për Kulturë, Rini e Sport, me akt nënligjor miratojnë plan-programin për shkollat fillore dhe të mesme, ku mbrojtja e mjedisit do të përfshihet si lëndë detyruese ose lëndë zgjedhore” dhe vazhdon me pikën e dytë, që nuk po dua t’ju marrë kohë.

Unë mendoj se ky nen është i tepërt për arsye se këtë materie e rregullon shumë mirë Ligji mbi arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë. Një prej qëllimeve që janë përcaktuar në nenin 4 të Ligjit është edhe obligimi që të nxënësit të zhvillohet ndjenja e respektit për mjedisin, që është e përcaktuar me nenin 4 pikë 1(e), pastaj neni 12 - përmbajtja e arsimit, ku Ministria e Arsimit është përgjegjëse për hartimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të përmbajtjes së arsimit publik. Pastaj, neni 12 pikë 2, Ministria e Arsimit nxjerrë udhëzimet lidhur me programet mësimore të cilat mësohen në të gjitha nivelet e arsimit fillor dhe të mesëm. Për këtë çështje unë e kam konsultuar edhe grupin parlamentar që është i mendimit se ky nen është i tepërt, pastaj i kam konsultuar të gjithë anëtarët e Komisionit të Arsimit, edhe ata janë të mendimit se ky nen duhet të hiqet, gjegjësisht të mos votohet. Po ashtu, një bisedë sot e kam pasur edhe me ministrin e Arsimit, i cili është dakord që ky nen të mos votohet. Prandaj, i ftoj deputetët që ky nen të mos votohet, gjegjësisht ky amendament të hiqet nga Ligji. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Veliu!

Është paraqitur në emër të komisionit, për të dhënë komentimin e vet, deputeti Maloku.

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni Parlamentar për Mjedis, Planifikim Hapësinor, pra komisioni funksional që i ka ofruar Kuvendit këto amendamente, ka pasur në shikim edhe ligjet të cilat i përmendi deputeti Veliu, dhe të shqetësuar se nuk është ndërmarrë asgjë në edukimin e brezave të ri në mbrojtjen e mjedisit, komisioni parlamentar funksional i ka propozuar Kuvendit që me ligj të obligohet Ministria e Arsimit që në programet për shkollat fillore dhe të mesme të përfshihet si lëndë detyruese ose lëndë zgjedhore mbrojtja e mjedisit, nga shqetësimi që

për këto 10 vite kjo ministri nuk ka bërë asgjë që në programin e edukimit për shkollat fillore dhe të mesme të jetë obligativisht lënda për mbrojtjen e mjedisit dhe të shqetësuar për qasjen që e kanë qytetarët e Kosovës ndaj mjedisit. Ne i kemi ofruar Kuvendit këtë nen që të obligohet, pra, Ministria për të futur lëndë obligative në shkollë fillore dhe të mesme, e Kuvendit është dhe e deputetëve se a e votojnë a jo. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Atëherë, sipas procedurave ne e kemi për obligim që ta hedhim amendamentin 22 në votim dhe në qoftë se miratohet propozimi i zotit Veliu, pastaj si votim në radhë, nëse nuk miratohet propozimi i komisionit, e hedhim në votim propozimin e zotit Veliu. Atëherë, propozimin e komisionit për amendamentin 22 e hedh në votim tani.

Kanë votuar, 31 vota “kundër”, 26 me kartelë “për”, 2 pa kartelë “kundër”. Atëherë, konstatohet që me 32 vota “kundër”, 27 “për” dhe 3 abstenime, propozimi i komisionit nuk miratohet.

E hedh në votim propozimin e deputetit Veliu, ose nuk ka nevojë. Okej, nuk ka nevojë me qenë se ka shumicën e votave.

Konstatohet se propozimi i deputetit Veliu miratohet.

Vazhdojmë me amendamentin 23

Votojmë, tani:

Me 58 vota “për”, 2 pa kartelë -60, 4 abstenime, miratohet amendamenti 23.

Amendamenti 24

Votojmë, tani:

Me 62 vota “për” me kartelë, 2 pa kartelë - 64, 4 abstenime, miratohet amendamenti 24.

Amendamenti 25

Votojmë, tani:

Me 55 vota “për” me kartelë, 2 pa kartelë -57, 3 abstenime, miratohet amendamenti 25.

Amendamenti 26

Votojmë, tani:

Me 62 vota “për” me kartelë, 2 pa kartelë - 64, 3 abstenime, miratohet amendamenti 26.

Amendamenti 27

Votojmë, tani:

Ka vërejtje për amendamentin 27.

Mirë është në kohë të paraqiteni.

Zotëri Hyseni ka vërejtje.

HYDAJET HYSENI: Ju faleminderit, zotëri kryesues!

Vërejtja ime ka të bëjë me kërkesën që fjala “imision” zëvendësohet me “cilësi e mjedisit”. Në tekst është gjithkund “emision” dhe “imision”. Unë nuk jam ekspert i kësaj fushe, por nuk do shumë mend për të konstatuar se ka një defekt. Më së pari shprehja “imision” në asnjë formë nuk mund të mbulohet me “cilësi e mjedisit” dhe, nëse eventualisht përdoret “cilësi e mjedisit”, ajo duhet të përfshijë edhe “emisionin”

edhe “imisionin”. Do të ishte mirë që ndonjë nga ekspertët të Komisionit ta sqaroj, por të mos miratojmë një amendament që në të vërtetë krijon tollovi në tekst.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Maloku!

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Ju faleminderit, zoti deputet për vërejtjen! Ne e kemi konsultuar dhe shqyrtuar krejt Ligjin. Zakonisht, për kimistët është “imision” kur një materie rrezaton ose emiton rreze. E kemi parë si më të përshtatshme “cilësia e mjedisit”, pra të zëvendësohet kjo fjalë, pra “cilësia e mjedisit” të jetë zëvendësim për “imision”, ashtu na u ka dukur se është më afër krejt kësaj fjale që përdoret në tërë tekstin e Ligjit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, sipas rregullës, vazhdojmë me votimin e amendamenti 27. Propozimin e Komisionit e qes në votim së pari, pastaj shohim se a po miratohet a jo.

Votojmë, tani:

Konstatohet që me 51 vota “për” me elektronikë, plus 1 pa kartelë, pra 52 vota “për”, “kundër” janë 8 vota me elektronikë, plus 1 pa elektronikë, pra 9 vota “kundër” dhe 8 abstenime. Sipas votimit në radhë, konstatohet që amendamenti i propozuar nga Komisioni, amendamenti 27 miratohet.

Amendamenti 28

Votojmë, tani:

Me 62 vota “për” me kartelë, 2 pa kartelë - 64, 3 abstenime, miratohet amendamenti 28.

Amendamenti 29

Votojmë, tani:

Me 62 vota “për” me kartelë, 2 pa kartelë, do të thotë 64 vota “për”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 29.

Amendamenti 30

Votojmë, tani:

Me 56 vota “për” me kartelë, 2 pa kartelë -58, 3 abstenime, miratohet amendamenti 30.

Amendamenti 31

Votojmë, tani:

Me 66 vota “për” me kartelë, 2 pa kartelë - 68, 4 abstenime miratohet amendamenti 31.

Amendamenti 32

Votojmë, tani:

Me 65 vota “për” me kartelë, 2 pa kartelë -67, 3 abstenime, miratohet amendamenti 32.

Amendamenti 33

Votojmë, tani:

Me 55 vota “për” me kartelë, 2 me kartelë -57 vota, 4 abstenime, miratohet amendamenti 33.

Amendamenti 34

Votojmë, tani:

Me 63 vota “për” me kartelë, 2 pa kartelë - 65, 3 abstenime, miratohet amendamenti 34.

Amendamenti 35

Votojmë, tani:

Për amendamentin 35 ka vërejtje zoti Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

E kam pak të pa qartë apo ndoshta duhet ta sqarojë ndryshuesi i këtij neni. Mbikëqyrjen administrative për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra nga ky ligj e bën ministri. Ministri është hartues i politikave dhe implementues i politikave, ndërsa mbikëqyrjen administrative e bën Ministria. Duhet të mbetet ashti si ka qenë, unë mendoj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Atëherë, vazhdojmë sipas procedurave. Së pari votojmë propozimin e amendamentit që e ka bërë Komisioni. Pra, vazhdojmë votimin e amendamentit 35. Kuptohet, nëse nuk shkon, e ndryshojmë. Ju faleminderit!

Votojmë tani. Më falni Lul, nuk ke kësajde, tash e pash. E kemi qitur në votim Lul!

Do të thotë, miratohet amendamenti i Komisionit me 31 vota “për”, 18 “kundër”, 6 abstenime. 2 pa kartelë janë kundër, do të thotë janë 19 vota “kundër”, pa kartelë... Buçinca je “për” apo “kundër”?

Pra, konstatoj se me 32 vota “për”, 18 “kundër”, 6 abstenime, miratohet propozimi i Komisionit.

Amendamenti 36

Votojmë, tani:

Me 67 vota me kartelë “për”, 2 pa kartelë - 69, 2 abstenime, miratohet amendamenti 36

Amendamenti 37

Votojmë, tani:

Me 57 vota “për”, pa kartelë, 2 me kartelë – 59, 3 abstenime, miratohet amendamenti 37.

Tani të nderuar deputetë, votojmë për tekstin e Ligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.

Votojmë, tani:

Konstatoj se me 70 vota “për”, 2 abstenime, Parlamenti miratoi Ligjin për mbrojtjen e mjedisit. Ju faleminderit”!

Vazhdojmë me pikën e 6 - të të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tokën ndërtimore, privatizimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore

Miratimi në parim i Projektligjit për tokën ndërtimore, privatizimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore është bërë me 3 mars 2008.

Komisioni funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor e ka shqyrtuar dhe Kuvendit i ka paraqitur Raportin me rekomandim që ky projektligj t'i kthehet Qeverisë në ripunim.

Rekomandimi i Komisionit iu është shpërndarë deputetëve.

Ftoj Kryetarin e Komisionit funksional, zotin Lulzim Zeneli apo raportuesin e komisionit, që para deputetëve ta arsyetojë Raportin me rekomandime. Zoti Zeneli!

LULZIM ZENELI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni Parlamentar për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor ka shqyrtuar Projektligjin në fjalë dhe pas konsultimeve që ka pasur edhe me ekspertë vendorë, ndërkombëtarë, me përfaqësuesit e Ministrisë, me organizatat të cilat e kanë sponsorizuar dhe e kanë ndihmuar punën e Kuvendit të Kosovës, gjegjësisht komisionin parlamentar, ka ardhur në konstatim se ky Projektligj nuk mund të adresojë të gjithë atë problematikë të cilën në vete ngërthen vetë titulli i këtij Projektligji, prandaj arsyetimet të cilat i ka dhënë komisioni parlamentar i kanë marrë deputetët. Këto arsyeime mbështeten edhe në një mënyrë prej ministrisë përkatëse. Prandaj, kërkojmë nga Kuvendi i Kosovës, gjegjësisht deputetët që t'i përkrahin rekomandimet e komisionit parlamentar.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Ministri e ka fjalën, zoti Yagcilar!

MAHIR YAGCILAR: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Zoti Zeneli i ka shpjeguar rekomandimet. Vërtet, edhe Ministria, edhe përfaqësuesit e Ministrisë gjithë kohën kemi qenë në koordinim dhe në ndërkohë kanë ndodhur edhe disa ndryshime edhe në legjislacionin, edhe me aprovimin e Kushtetutës, kështu që edhe na mendojmë dhe është mirë të bëhet kthimi i ligjit në Qeveri dhe ndoshta do të bëhet një ndarje në dy ose tri ligje të veçanta, sepse tematika është komplekse, kështu që me Kushtetutë edhe legjislacion të në fuqi të Republikës së Kosovës do të krijojnë probleme në qoftë se aprohet qysh ka qenë para dy viteve. Kështu që e përkrahim rekomandimin e Komisionit.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Nuk ka të paraqitur për diskutim lidhur me Projektligjin. Atëherë, shkojmë në votim. Votojmë në tërësi. Lus deputetët dhe regjinë që të përgatiten për votim.

Votojmë, tani:

Askush nuk është paraqitur për diskutim dhe tani nuk di pse po i çoni duart!

Konstatoj që rekomandimi i Komisionit është votuar me 53 vota “për” me elektronikë, 2 janë pa kartelë, janë “për” besoj 55 vota, 3 “kundër”, 2 abstenime.

Konstatoj se Kuvendi vendosi që Projektligji për tokën ndërtimore, privatizimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore, t'i kthehet Qeverisë në ripunim, respektivisht nuk miratohet.

A jeni për pak pauzë, apo të vazhdojmë?

Atëherë, pauzë 10 minuta për kafe.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI: Ju lutem, konstatoji kuorumin. Konstatohet që për të filluar seancën dhe për të filluar debatin lidhur me pikat e rendit të ditës në fjalë, kemi kuorum. Në qoftë se nuk ka kuorum për votim, atëherë shtyjme pas drekës votimin. Faleminderit!

Atëherë, vazhdojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i Projektrezolutës për prioritetet dhe strategjinë e Kosovës për integrimin në Unionin Evropian dhe plani i veprimit për sfidat e raportit të Komisionit Evropian për progresin në Kosovë**

Komisioni Parlamentar për Integritet Evropian ka hartuar dhe Kuvendi ia ka proceduar për shqyrtim dhe miratim Projektrezolutën dhe prioritetet dhe strategjinë e Kosovës për integrim në Unionin Evropian me planin e veprimit për sfidat e raportit të Komisionit Evropian për progresin në Kosovë. Projektrezoluta u është shpërndarë deputetëve. Ftoj kryetarin e Komisionit për Integritet Evropian, zonjën Zylfije Hundozi, që në emër të Komisionit para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë Projektrezolutën.

ZYLFIJE HUNDOZI: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe pse kjo Rezolutë edhe ky plan i veprimit është punë e Kuvendit edhe e Komisionit për Integritet Evropian po i adresohet edhe Qeverisë edhe do të ishte dashur Qeveria të jetë këtu. Kjo është një çështje serioze, pas pavarësisë integritet evropian janë në pikë të parë.

Megjithatë, po filloj. Në pajtim me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të rregullave 35 pikë 4 dhe 46 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Komisioni për Integritet Evropian i Parlamentit ka shqyrtuar Raportin e progresit të Komisionit Evropian për Republikën e Kosovës gjatë 3 takimeve dhe 2 punëtorive dhe punëtorisë dyditore. Veç kësaj, komisionet tjera të Kuvendit të Kosovës e kanë shqyrtuar raportin duke u bazuar në fushëveprimtarinë e tyre. Më 11 dhjetor seanca plenare e këtij Kuvendi ka nxjerrë përfundimet e saja në lidhje me veprimet konkrete të Kuvendit rreth raportit.

Duke e vlerësuar se Kuvendi duhet të shprehë qëndrimin e vet përkrah konstatimeve, komenteve, rekomandimeve në Raportin e progresit, Komisioni për Integritet Evropian i këtij Parlamenti e hartoi Projektrezolutën për prioritetet dhe strategjitë e Kosovës për integritet evropian dhe Planin e veprimit për sfidat e Raportit të progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008.

Me anë të Rezolutës dhe të Planit të veprimit, Kuvendi do të konfirmojë orientimin strategjik dhe konsensual të të gjitha grupeve parlamentare për anëtarësim të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian dhe mirëpret intensifikimin e raporteve me institucionet e Bashkimit Evropian.

Unë do ta paraqes Projektrezolutën më së pari.

Projektrezoluta për prioritetet dhe strategjitë e Kosovës për integrim në Bashkimin Evropian

Duke marrë parasysh qëllimin strategjik dhe pajtimin e plotë të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe të qytetarëve të saj për integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian, me synim ndërtimin e shtetit të bazuar në sundimin e ligjit, me ekonomi të

qëndrueshme dhe demokraci funksionale të mundësive të barabarta për të gjithë, në pajtim me vlerat dhe parimet e familjes evropiane.

Duke shprehur gatishmërinë e institucioneve të Republikës së Kosovës për të përmbushur standardet evropiane si kushte për anëtarësim në Bashkimin Evropian,

Duke vlerësuar bashkëpunimin e deritanishëm të institucioneve të Republikës së Kosovës me Bashkimin Evropian, me praninë ndërkombëtare në Kosovës dhe duke u zotuar për bashkëpunim më të ngushtë në të ardhmen,

Duke vlerësuar bashkëpunimin ndërparlamentar mes Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Parlamentit Evropian dhe duke u zotuar për bashkëpunim edhe më të ngushtë.

Duke marrë parasysh arritjet e deritashme në procesin e mekanizmit përcjellës të stabilizim - asocimit të iniciuara në vitin 2004 dhe të vetëdijshëm mbi sfidat që na presin për arritjet e marrëveshjes së stabilizim asocimit drejt anëtarësimit të plotë në Bashkimin Evropian,

Duke qenë të vetëdijshëm se kriteret e përcaktuara nga ana e Këshillit të Evropës në Kopenhagë më 1993 dhe në Madrid më 1995, janë esenciale për anëtarësim në Bashkimin Evropian, duke marrë parasysh se vlerësimet e dala nga Raporti i progresit të Kosovës për vitin 2008 i përgatitur nga Komisioni Evropian, marrë në përgjithësi, janë reale si dhe nevojën për të trajtuar sfidat e përcaktuara në këtë raport.

Duke vlerësuar se qëllim parësorë i Republikës së Kosovës për vitin 2009 është avancimi i proceseve të integrimeve evropiane me theks të veçantë arritjen e vlerësimeve pozitive të raportit të fizibilitetit nga ana e Komisionit Evropian,

Duke u thirrur në planin e veprimit për partneritet evropian të Kosovës, përfundimet e seancës plenare të 11 dhjetorit 2008 dhe orientimit afatgjatë të institucioneve të Kosovës për anëtarësimin në Bashkimin Evropian, Kuvendi i Republikës së Kosovës:

Nën një, rikonfirmon zotimin e institucioneve të Republikës së Kosovës për përmbushjen e standardeve të kërkuara për integrim në Bashkimin Evropian. Zotohet se to të intensifikojë përpjekjet në përmbushjen e kërkesave të procesit të stabilizim - asocimit të cilat shpien në nënshkrimin e marrëveshjes së stabilizim - asocimit.

Vazhdon zotimet për garantimin e zbatimit të plotë të parimeve të sundimit të ligjit. Ekzistimin e institucioneve demokratike, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të pakicave, të ekonomisë konkurruese të tregut, të kapacitetit për t'u përballë me presionet konkurruese dhe forcave të tregut brenda bashkimit Evropian, zbatimit të parimeve kryesore të *acquis communautaire* si dhe bashkëpunimit me shtete tjera të rajonit, siç është përcaktuar nga kriteret e Kopenhagës më 1993 dhe të Madridit më 1995.

Rikonfirmon gatishmërinë e institucioneve të Republikës së Kosovës për themelimin e bashkëpunimit me Bashkimin Evropian dhe praninë ndërkombëtare në Kosovë, me synim të fuqizimit të pozitës së Kosovës në proceset e integrimit Evropian.

Kërkon nga të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës që të koordinojnë përpjekjet e tyre drejtë përmbushjes së rekomandimeve të përcaktuara në Raportin e progresit për Kosovën për vitin 2008, shoqëruar me komunikatën e Komisionit Evropian drejtuar

Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Evropës mbi strategjinë e zgjerimit dhe sfidat kryesore 2008 – 2009 si dokument kryesor për Integrimin Evropian të Kosovës.

Konsideron se ndër prioritetet kryesore për vitin 2009 i të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës është fuqizimi i dimensionit Evropian në Kosovë, që do të ndikojë në arritjen e vlerësimit pozitiv nga Komisioni Evropian në Raportin e fizibilitetit.

Shpreh gatishmërinë për bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Parlamentit Evropian në të gjitha nivelet.

Mbetet i përcaktuar në arritjen e sundimit të ligjit përmes reformave të sistemit të gjyqësisë, plotësimit të kornizës institucionale dhe zbatimit të të gjitha ligjeve bazuar në parimin -askush nuk është mbi ligjin.

Konstaton rëndësinë e jashtëzakonshme të stabilitetit në Kosovë dhe kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të shtrijë autoritetin e saj në tërë territorin me synim të integritetit të gjitha komuniteteve në shoqërinë e Kosovës.

Thekson se zhvillimi ekonomik është prioritet kyç dhe shpreh përkrahjen e plotë për të gjitha aktorët ekonomikë, publikë dhe privatë, tërheqjen e investimeve të drejtpërdrejta të huaja që do të rezultojnë me krijimin e mundësive të punësimit dhe përmbylljen transparente të procesit të privatizimit.

Kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës që t'i intensifikojë përpjekjet e saj në reformimin e administratës publike në parimin e një administrate publike bashkëkohore dhe efektive pa ndërhyrje politike.

Kërkon nga institucionet e Republikës së Kosovës që të ndërmarrin veprime vendimtare për luftimin e fenomeneve negative në mënyrë që të përmbushen kërkesat e kapitullit të drejtësisë, të lirisë dhe të sigurisë të Raportit të progresit për vitin 2008 për Kosovën, duke përfshirë korrupsionin, krimin e organizuar dhe evazionin fiskal.

Angazhohet për strategji të përbashkëta me Qeverinë e Republikës së Kosovës për realizimin e standardeve evropiane të tregut të brendshëm, siç përcaktohet në Raportin e progresit për vitin 2008 për Kosovën, duke përfshirë konkurrencën, edukimin dhe hulumtimin, prokurimin publik, doganat dhe tatimet.

Angazhohet për strategji të përbashkëta me Qeverinë e Republikës së Kosovës për realizimin e standardeve evropiane, të politikave sektoriale, siç përcaktohet në Raportin e progresit të vitit 2008 për Kosovën, siç janë politikat për energji, mjedis ...

KRYESUESI: Vazhdojani deri sa ta kryej, regjia ia vazhdoni fjalën!

ZYLFIJE HUNDOZI: ...industri dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, transport, informim dhe media, statistika, kontroll financiar, bujqësi dhe kultivimin e peshkut.

Kërkon nga Komisioni Parlamentar për Integritet Evropian përmbylljen e detyrave dhe të obligimeve të dala nga përfundimet e seancës plenare të 11 dhjetorit 2008 për analizimin, planifikimin, raportimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të planit të veprimit të Kuvendit për sfidat e Raportit të progresit. Po ashtu fton të gjithë komisionet parlamentare që të angazhohen tërësisht në realizimin e Planit të veprimit.

Angazhohet për një strategji koherente dhe harmonizim të agjendës legislative përmes bashkërendimit ndërmjet institucioneve të Republikës së Kosovës, në veçanti, duke marrë parasysh sfidat e dala nga Raporti i progresit 2008.

Fton Qeverinë e Republikës së Kosovës që rregullisht dhe në mënyrë përmbytëse të njoftojë Kuvendin e Republikës së Kosovës për progresin e arritur dhe komunikimin me institucionet e Bashkimit Evropian.

Përkushtohet për mbikëqyrjen e procesit të zbatimit të obligimeve të sipërpërmendura nga institucionet e Republikës së Kosovës.

Vetëm edhe shkurtimisht një sqarim për planin e veprimit, edhe e kreu.

Plani i veprimit i ngërthen në vete një qasje më aktive të Kuvendit përballë procesit të integritit evropian, duke përdorë në mënyrë efektive mjetet parlamentare të mbikëqyrjes ndaj Qeverisë, në mënyrë që të realizohen aktivitetet konkrete për mënjanimin e sfidave.

Në këtë dokument identifikohen qartë sfidat, institucionet brenda Kuvendit, lista e qartë e aktiviteteve që duhet ndërmarrë për ndryshimin e situatës dhe afatet kohore se kur do të realizohen aktivitetet e planifikuara.

Në këtë plan, pos punës së Komisionit për Integritet Evropian, edhe komisionet tjera parlamentare do të përfshijnë në agjendën e tyre të takimeve të rregullta sfidat e integritit evropian, në mënyrë që të sigurojnë që Plani i veprimit të Kuvendit për sfidat e Raportit të progresit për vitin 2008 të realizohet plotësisht.

Pasi që Komisioni për Integritet Evropian i Parlamentit të Kosovës e ka marrë mandatin nga seanca plenare për koordinim të veprimeve, komisionet tjera parlamentare i dërgojnë informacione rregullisht për hapat e marrë dhe progresin e arritur. Komisioni për Integritet Evropian çdo 3 muaj do t'i raportojë seancës plenare për zbatimin e Planit të veprimit të Kuvendit për sfidat e Raportit të progresit për vitin 2008. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja kryetare e Komisionit!

Tani, sipas renditjes dhe fuqisë politike, do të deklarohen kryetarët e grupeve parlamentare ose të ngarkuarit. Sipas radhës, fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, zoti Ramë Buja.

RAMË BUJA: I nderuari zoti Kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të respektuar pak ministra që keni mbetur në sallë,

Ne e dëgjuam edhe Propozim-Rezolutën që e ka bërë Komisioni për Integritet Evropian, që e përgëzojmë për punën serioze që e ka bërë. Ne si Grup Parlamentar e kemi analizuar këtë dhe, natyrisht, për pozicionin në të cilën gjendemi, si Kosovë, si shtet i ri, për sfidat që kemi e që jemi ndërgjegjshëm për te, gjithsesi jemi në mbështetje të kësaj rezolute dhe gjithmonë ndihmëtarë kudo që kërkohet ndonjë obligim, detyrim dhe ngarkesë që të përmbushet në raport me këto sfida që i kemi përpara. Ne jemi për Rezolutën.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Buja!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, fjalën e ka zoti Fatmir Rexhepi. Nuk është paraqitur dikush tjetër.

FATMIR REXHEPI: Jo, në emër të Grupit Parlamentar jo, në emër tim po.

KRYESUESI: Jo, pastaj.

FATMIR REXHEPI: Anë, nuk ka problem.

KRYESUESI: Nëse je i autorizuar nga Grupi, në rregull, jo pastaj kur të fillojnë diskutimet e rregullta, e merr fjalën.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti Kryesues!

Unë do të flas në emër tim, të japë një kontribut lidhur me temën që është shtrua në qoftë se ...

KRYESUESI: Atëherë, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, fjalën e ka zoti Bukoshi.

BUJAR BUKOSHI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah, në parim, këtë Rezolutë. Mendojmë se është një tekst i mirë, debatet do të tregojnë si do të vejë tani, unë vetëm desha që edhe në kuadër të asaj që kemi punuar bashkë në këtë Komision për Integritet Evropian, t'i përkujtoj kolegët dhe koleget e nderuara dhe dua të besoj se gjithë jemi të vetëdijshëm për dimensionin dhe rëndësinë e proceseve integruese edhe të rrugës tonë për të arritur qëllimet tona. Po, për të mos e zgjatur shumë, unë mendoj se barra kryesore do të duhej t'i binte Qeverisë për ta kryer këtë punë, punën kryesore e ka Qeveria me 2 anëtarë të Qeverisë që i kemi sot këtu, por edhe ata të tjerët do të angazhohen. Edhe një herë, ne e përkrahim këtë dhe presim koordinim më të mirë. Kjo Rezolutë natyrisht është më shumë deklarate e vullnetit politikë edhe tingëllon mjaft solemne, por ka shumë punë, do të jetë një rrugë e gjatë edhe e mundimshme. Ne kemi pasur rastin edhe në takimet tona në shkëmbimin e përvojave, konkretisht, me rastin e Kroacisë. Kroacia deri tani ka të angazhuara afër 2000 veta që punojnë në anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Bukoshi!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputetja Emini.

NJOMZA EMINI: Faleminderit, kryesues!

Me qenë se sot po e diskutojmë një temë, do të thotë Projektrezolutën që është me rëndësi për Kosovën, unë po e shoh edhe seriozitetin e Qeverisë, që janë prezentë vetëm 2 ministra, që nuk do të ishte mirë që nuk janë prezentë, po megjithatë unë po e shpreh qëndrimin e Grupit Parlamentar të Aleancës Kosova e Re.

Fillimisht, më lejoni edhe njëherë që në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së rreth punës së Komisionit për Integritet Evropian, iniciativë të cilin e vlerëson lartë. Ky Komision, do të thotë, e kthen rolin e tij në monitorimin e punës së Qeverisë rreth angazhimeve të cilat i ka ekzekutivi karshi agjendës evropiane, përkatësisht obligimeve që dalin nga plani i veprimit për partneritet evropian.

Të nderuar kolegë,

Propozim-planin e veprimit për të cilën ne sot po diskutojmë, Komisioni e ka hartuar mbi bazën e vërejtjeve që Komisioni Evropian i ka identifikuar në Raportin e progresit për vitin 2008. Duke synuar që të gjitha ato vërejtje që iu janë bërë institucioneve të

Republikës së Kosovës në Raportin e progresit të vitit 2008 të mos i gjejmë edhe në raportin e vitit 2009. Komisioni ka paraparë një numër të madh të veprimeve që duhet të ndërmerren për përmirësimin e kësaj gjendjeje. Këtu duhet theksuar se shumë nga këto veprime që janë paraparë këtu, janë edhe pjesë e Planit të veprimit për partneritet evropian, që gjithsesi duhet implementuar dhe monitoruar realizimi i tij.

Meqë hartimi i këtij dokumenti nga Komisioni është bërë kohë më parë dhe ka kaluar një periudhë kohore që nga atëherë, sot në këtë plan veprimi duhet të ndryshohen afatet kohore të realizimit të veprimeve të tij. Kjo, sigurisht, me që sot është fundi i muajit të dytë të këtij viti dhe veprimet që janë paraparë të realizohen në tremujorin e parë të këtij viti, nuk mund të bëhen.

Të nderuar deputetë,

Puna e këtij Komisioni sikur edhe po thuaj se të gjitha komisioneve të tjera të Kuvendit, varet shumë nga nevoja e ekspertëve që duhet të jenë në mbështet të tyre. Këtë herë, më shumë se asnjëherë më parë, është vërtetuar nevoja që ka sidomos ky Komision për mbështetje nga ekspertë të kësaj fushe.

Krejt në fund, duke u bazuar në të gjitha këto që i thashë më lartë, më lejoni të shpreh edhe qëndrimin e Grupit Parlamentar të AKR-së për Propozim-Rezolutën për prioritetet dhe strategjitë e Kosovës për integrimin në Bashkimin Evropian dhe Planin e veprimit për sfidat e Raportit të progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008.

Duke i trajtuar si shumë të rëndësishme të gjitha dokumentet dhe veprimet konkrete të cilat kontribuojnë në plotësimin e kushteve për integrim sa më të shpejtë të Republikës së Kosovës, në Bashkimin Evropian, AKR-ja i jep mbështetje të plotë kësaj Propozim - Rezolute dhe këtij Plani të veprimit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, fjalën e ka Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e mbështet këtë Projektrezolutë, në të njëjtën kohë kërkon nga Komisioni për Integritet Evropian që ta përcjellë implementimin e të gjitha pikave në Planin e veprimit i cili është paraqitur para nesh. Mendojmë se është një plan shumë ambicioz dhe e ka vetëm një rrezik që të jetë tepër i mirë, duke u shprehur në gjuhë tjetër dhe në këtë formë të rrezikojë që të mos implementohet. Edhe njëherë e mbështesim dhe kërkojmë nga Komisioni që ta përcjellë implementimin e Planit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Gjini!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, fjalën e ka zoti Rugova!

NASER RUGOVA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Grupi parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e ka shqyrtuar me vëmendje Projekt-Rezolutën për prioritetet strategjike të Kosovës për integrim në Bashkimin Evropian si dhe Planin e veprimit të Komisionit për Integritet Evropian.

Tashmë të gjithë e dimë që është interes nacional i shtetit dhe të popullit të Kosovës, që Kosova të jetë pjesë e familjes së madhe evropiane dhe pjesë e mekanizmave të

Bashkimit Evropian. Duke i parë sfidat e këtij procesi dhe përvojat që i kanë kaluar edhe shtetet e tjera të rajonit, ne konsiderojmë që objektivat politike, ekonomike, standardet evropiane dhe dokumentet e tjera obligative që dalin nga kriteret e Kopenhagës dhe mekanizmat e Bashkimit Evropian, janë tejet sfiduese dhe institucionet e Republikës së Kosovës, në radhë të parë legjislativi i vendit, duhet të angazhohet dhe të koordinohet me të gjithë mekanizmat tjerë institucional, sepse vërtet na pret një punë e gjatë dhe shumë sfiduese që kërkon kohë, mund dhe mjete financiare, sigurisht.

Kjo Rezolutë shpreh vullnetin politik dhe është mirë që po shqyrtohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, është një mesazh i fuqishëm për Bashkësinë Evropiane, për mekanizmat e Bashkimit Evropian, po edhe një deklaram të emër të qytetarëve të Kosovës për seriozitetin që e kanë institucionet e Republikës së Kosovës për integrimin në Bashkimin Evropian.

Në Planin e veprimit që e ka hartuar Komisioni për Integritime Evropiane i Parlamentit të Republikës së Kosovës, jemi thirrur dhe bazuar kryekëput në sfidat dhe vërejtjet serioze që janë dhënë në Raportin e fundit të progresit të Komisionit Evropian. Andaj, ne si Grup parlamentar dhe si parti politike insistojmë në ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe të mekanizmave qeveritar, pse jo të formohen edhe mekanizma të tjerë të nivelit nacional, që ky proces sfidues thjeshtë të funksionalizohet dhe t'i implementojmë ato obligime që dalin nga dokumentet zyrtare të mekanizmave të Bashkimit Evropian. Në këtë kuptim, ne angazhohemi që të fillojë urgjentisht përkthimi i Legjislacionit të BE-së, të quajtur me terminologjinë moderne *acquis-communtaire*, pastaj të bëhet intensifikim i komisioneve ndërministrorë, i Qeverisë, Gjyqësorit, Legjislativit në intensifikimin në fusha të veçanta të politikave sektoriale, ku kemi ngecje serioze, pastaj të përgatitemi seriozisht përmes komisioneve funksionale që janë caktuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës që vërejtjet të cilat janë dhënë nga Raporti i fundit i progresit të Komisionit Evropian, të fillojnë të tejkalohen dhe të përmirësohen, në mënyrë që të jemi të përgatitur për Raportin e fizibilitetit që e pret Kosovën dhe institucionet e saj dhe këtu nuk duhet të ndahemi pozitë - opozitë, por vërtet ekzekutivi i vendit e ka përgjegjësinë më të madhe sepse ky Raport i fizibilitetit do të thotë shumë për dimensionet e ardhshme të integritimit të Kosovës në Bashkimin Evropian.

Dhe, krejt në fund, insistojmë si Grup Parlamentar, në përkrahje në kontinuitet të Komisionit për Integritime Evropiane dhe mbështetje të sinqertë dhe institucionale, diplomacisë parlamentare, sepse kjo do të intensifikonte marrëdhëniet bilaterale të Parlamentit të Republikës së Kosovës, të shtetit të Kosovës, me institucionet e tjera relevante të Bashkimit Evropian dhe njëkohësisht do të ndikonte edhe në avancimin e raporteve dhe njohjen e shtetit të Kosovës edhe nga 5 vende anëtare të BE-së, sepse siç e dimë, në këto institucione relevante ende është në fuqi Rezoluta 1244.

Andaj, dua të besoj që kjo Projektrezolutë, si dhe Plani i veprimit, të hartuara nga Komisioni për Integritime Evropiane, do të jenë të dobishme për ekzekutivin e vendit dhe dua të besoj që me një angazhim efikas të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Raporti i fizibilitetit që pritet të publikohet në fund të këtij viti, të jetë i favorshëm për Kosovën dhe për qytetarët e saj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, është paraqitur deputeti Idriz Sadik.

SADIK IDRIZ: Hvala, predsedavajući!

Parlamentarna grupa „7+“ će podržati Rezoluciju o prioritetima i strategijama Kosova za integraciju u Evropsku Uniju, kao i Akcioni plan koju je uradila Komisija za Evropske integracije. Ja mislim da je i Dekleracija i Akcioni plan su u smeru želje stanovnika Kosova da budu članica evropskih integracija. Medjutim, velike su obaveze svih institucija, prije svega Vlade, Parlamentra, svih ostalih institucija Kosova. Vidimo iz prakse kakva je u okruženju i probleme sa kojima su suočene zemlje iz okruženja koliko je taj proces dug i koliko zahteva. Ovaj, nije dovoljna želja, nego je potrebno da se ispune odredjene prepreke i zahtevi.

Od prilike, za Kosovo ja to, posmatram kao kada bi u atletici trebalo da se dostigne negde oko 9 metara u skoku, dakle toliko je problem, ali mislim da ćemo mi dati svoj doprinos kao Parlamentarna grupa „7+“ da radimo i u komisijama, tamo gde smo zastupljeni, da damo svoj doprinos u realizaciju odredjenih zadataka. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, Bojan Stojanović

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala vam, gospodine predsedavajući!

Uvažene kelege poslanici,

Mi ćemo podržati ovu Rezoluciju, naravno ne samo vezano sa integracijama, nego smatramo da će ovo značiti neki boljitak u poboljšanju kvaliteta života stanovništva na ovim prostorima. I kada smo razmišljali o tome, bazirali smo se na Izveštaju o progresu od 2008. i videli smo da je sve ono što nije dobro, jednostavno evidentirano, znači ništa ne može da se sakrije, sve će i 2009-te biti isto ako ne ispunimo ovo što smo zacrtali. Normalno, vezano za prava čoveka i zaštitu zajednica ovde u ovoj poglavlju, neke stvari se stavljaju za trće tromesečje, četvrto tromesečje, što je moralo možda po meni da bude mnogo ranije, mada nije trebalo ni da se desi uopšte. To je trebalo još pre donošenja ove Rezolucije ili Zakona da se usvoji i ta komunikacija između institucija, Skupština, Vlada, nadgledanje zakona, učešće u sprovođenju i donošenju zakona, u saradnji sa civilnim društvom nas je koštalo jednog izveštaja, koji nije baš tako svetao vezano za Izveštajem progressa za 2008. godinu.

Ja se nadam zbog svih, jer svi mi zajedno želimo da živimo bolje, znači nema veze kojoj zajednici pripadamo. Imamo pravo da živimo kao sav normalan svet. Medjutim, neće biti dovoljno više da šaljemo dobru poruku, moraćemo da pokažemo dobra dela. Hvala!

KRYESUESI: Hvala!

Grupi Parlamentar “Zajedno”, zoti Grbiq

BRANISLAV GRBIĆ: Zahvaljujem, predsedavajući,

Poštovani ministri,

Uvažene dame i gospodo poslanici,

Poslanička grupa „Zajedno“, je znači jedna nova grupa koja je videla smisao i interes opstanka Srba na Kosovu, i kao takav jedan prioritet smatramo da ovaj proces integracija sigurno je jedan pozitivan način razmišljanja građana Kosova u smislu, znači kako samo dostignuća evropskih integracija, tako i dostignuća integracija unutar samog Kosova. Znači, integracioni procesi koji će, da kažemo, prvo doneti jedan mir i stbilnost građanima Kosova, a u interesu, znači taj jedan napredak koji se zove ekonomski napredak.

Smatram da integracioni procesi kao takvi trebaju biti prihvaćeni, ali ono što smatram da i sama Evropa i ceo svet vidi u nama, a to je znači taj dijalog izmedju svih zajednica na Kosovu, koji je jako bitan, jer imamo jednu političku situaciju koja je, da kažem, još uvek na neki način nerazjašnjena u smislu opstanka zajednica na Kosovu. I u tom kontekstu, sigurno da moramo i sama Vlada, znači, i svi mi kao predstavnici u Skupštini, i kao građani Kosova da moramo dati jedan značajan doprinos i da što više ljudi pokušamo da integrišemo, što više predstavnika zajednica kako Srba, tako i ostalih u ovo kosovsko društvo. To možemo da ostvarimo u jedan način, jedan transparentan način koji će omogućiti i Vladi i svima nama da ne gubimo previše vremena na jednu grupu ljudi ili jednu interesnu grupu, bez obzira kojoj zajednici pripadaju.

Trebamo stvoriti uslove da što više građana Kosova, sve više predstavnika zajednica vidi svoj interes u institucijama Kosova. I nadam se da ćemo, da će 2009. godina, znači i nastupajuće godine u tom pogledu imati neki svoj prioritet, znači prepoznati što više interesa u građanima Kosova. Hvala!

KRYESUESI: Hvala!

Tani, sipas renditjes, janë paraqitur disa deputetë për të diskutuar. Fjalën e ka deputetja Tahiri!

EDITA TAHIRI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Deputetë të nderuar,

Qeveri e nderuar,

Synimet e Kosovës për integrimet Evropiane dhe Evroatlantike janë synime strategjike, prandaj edhe në kuadër të këtyre synimeve, angazhimi i institucioneve të Kosovës duhet të jetë në nivelin e kërkuar. Mendoj se për të fuqizuar proceset e integritimeve evropiane, në radhë të parë kërkohet një konsensus kombëtar dhe në këto diskutime që i patëm, mendoj se është një moment i mirë që edhe pozita edhe opozita, pra ka një mendim të qëndrueshëm dhe koherent që t'i japim fuqi këtij procesi.

Raporti i progresit ka nxjerrë sfida të shumta për Kosovën dhe mendoj se ato nuk janë veç sfida të Qeverisë, siç po interpretohet, mendoj se janë sfidat e të gjitha institucioneve të Kosovës. Këtu kam parasysh Parlamentin, Gjyqësinë dhe të gjithë mekanizmat pra që janë në kuadër të institucioneve të Kosovës, në mënyrë që me një bashkëpunim sistematik të dalim shumë më mirë në vlerësimet që do t'i bëjë Bashkimi Evropian në fund të këtij viti, por veçmas ne kemi një sfidë të rëndësishme që ta kalojmë mirë studimin e fizibilitetit, i cili hapë rrugën që Kosova pra të ketë një qasje më të shpejtë ndaj marrëveshjes për stabilizim - asocim.

Në kuadër, sigurisht, të punëve që kemi, këto nuk janë vetëm punë për plotësimin e standardeve, janë edhe punë me të cilat përmirësohet jeta e Kosovës dhe unë mendoj se një theks i veçantë, po edhe Komisioni pjesë e të cilit jam unë po ashtu, Komisioni për Integritime Evropiane, i ka dhënë përparësi sundimit të ligjit dhe në vlerësojmë se reforma në gjyqësi është një prej sfidave të mëdha që na pret dhe duhet të intensifikohen punët.

E dyta, mendoj që, me qenë se janë ende 5 shtete të Bashkimit Evropian të cilat nuk e kanë njohur Kosovën, është e rëndësishme që lobizimi të bëhet edhe në nivelin qeveritar, por edhe në nivelin e diplomacisë parlamentare dhe me këtë rast dua të kërkoj nga Kuvendi i Kosovës që të sigurojë pjesëmarrjen e Parlamentit në seancat e rregullta

plenare të Parlamentit Evropian dhe të Asamblesë së Përgjithshme të Këshillit të Evropës. Këtu mendoj, këto dy komisione, Komisioni për Politikë të jashtme dhe Komisioni për Integritet të jenë aktiv në mënyrë që në kuadër të pjesëmarrjes në ato seanca, jo vetëm që lobizojmë për njohje të reja, por ne marrim përvoja se si vendet tjera të tranzicionit i kanë kryer punët më shpejt në raport me Integritet Evropiane.

Po ashtu, dua të them që Plani i veprimit të cilin e kemi bërë si Komision, që është Plani i veprimit të Kuvendit të Kosovës, janë disa data dhe kërkoj një harmonizim të strategjive dhe të koherencës për legjislacionin. Në këtë aspekt kërkohej një interaksion më i madh midis Kuvendit dhe Qeverisë dhe Komisioni do të jetë në dispozicion për t'i përshpejtuar proceset. Dhe, së fundi, dua të them që sigurisht që një administratë publike efikase dhe zvogëlimi i korrupsionit, do të jenë forma që e bëjnë Kosovën që të kalojë fazën e studimit të fizibilitetit më shpejtë, në mënyrë që sa më shpejt të ofrohem te faza, që është kritike për Kosovën, e marrëveshjes për stabilizim - asocim.

Unë ju falënderoj dhe, natyrisht, mendoj se është momenti i rëndësishëm për Kosovën që po bën një deklaram politik për vullnetin e integriteteve evropiane.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Tahiri! Fjalën e ka deputeti Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për ministrat prezentë,

Kolegë deputetë,

Edhe unë në parim e përkrah këtë deklaram të parlamentit dhe e shoh me shumë interes, do të thotë, për angazhimet e mëtutjeshme politike, Rezolutën dhe Planin e veprimit i cili bazohet në vlerësimet e përgjithshme, analizën me informacione relevante të adresuara nga Raporti i progresit për të gjitha institucionet e shtetit tonë të ri, bazuar në gjendjen faktike në terren, si dhe sfidat politike, ekonomike dhe kushtetuese për Parlamentin dhe Qeverinë dhe shoqërinë tonë në rrugën drejt integriteteve evropiane, por edhe drejt forcimit të shtetit, të sovranitetit dhe të funksionimit të Qeverisë të vendit tonë, që janë të domosdoshme që t'i ngrehim dhe të ecim përpara.

Në Kuadër të këtij debati, unë me pak fjalë dua të vazhdoj se Plani i veprimit të Parlamentit duhet të fokusohet në fushat më të rëndësishme e që kanë të bëjnë me çështjet politike, shtetin ligjor, zhvillimin ekonomik, forcimin e demokracisë, ngritjen e kapaciteteve administrative në zbatimin dhe përmbushjen e standardeve evropiane që kërkohej nga Parlamenti dhe Qeveria e këtij shteti të ri.

Ky Program dhe Plan veprimi në mënyrë të veçantë unë kërkoj që të shoh rolin e Parlamentit, që kujtoj nuk e kemi pasur deri tash, për debatin politik në Parlament, kontrollin si dhe rolin e Komisionit të Integritetit në zbatimin e detyrimeve të tij pasi dalin para institucioneve tona që të kemi kohë pas kohe raporte, vlerësimet, ashtu qysh bëjnë edhe në vendet tjera, në praktikën që e kanë kaluar këtë tranzicion.

Ata që e kanë lexuar Raportin e progresit, kanë vërejtur se kriteri ekonomik është një ndër sfidat kryesore që do të ballafaqohet edhe Qeveria, edhe Parlamenti i vendit, sepse vet konstatimet, nga konstatimet rezulton se gjendja është tejte e rëndë ekonomike dhe sociale, vazhdon të jetë e tillë dhe vazhdon të jetë pra sfida kryesore për institucionet dhe shoqërinë kosovare.

Ecuria e tranzicionit dhe progresi shumë i ngadalshëm dhjetëvjeçar do të mbetet edhe një test shumë i vështirë dhe i rëndë për Qeverinë, reformat që na presin për procesin e mëtutjeshëm, sidomos në planin e politikave makro ekonomike. Bie fjala, jemi gati një dekadë nga kalimi në ekonomi të tregut të lirë, por vazhdojmë të mbetemi pra vendi më i varfër në regjion. Ne e kemi aprovuar strategjinë për energjinë para disa vitesh, por nuk kemi furnizim me energji elektrike. Edhe donacionet, edhe investimet, edhe plani strategjik për investime, kemi vonesa, kemi dështime dhe nuk po arrijmë asesi të stabilizohemi, e dihet se çka do të thotë kjo që nesër në cilën shkallë dhe në çfarë përmase do ta përmbushim këtë kriter. Jemi larg, përkundër resurseve të mëdha dhe kapaciteteve që i kemi.

Nuk kemi iniciativën apo strategjinë nacionale për zhvillim, është thënë disa herë, por asnjëherë nuk ka filluar dhe, po ashtu, strategji nacionale për integrim dhe vazhdojmë kohë pas kohe me intervenime që këto t'i saldojmë me disa korniza të shkurta të cilat nuk paraqesin ndonjë stabilitet të përgjithshëm dhe ndonjë strategji që i duhet vendit.

Po ashtu, vazhdojmë të jemi pa strategji për punësimin dhe trajnimin profesional për tregun e punës brenda dhe jashtë vendit, që është një nevojë shumë e madhe dhe duhet ta ndryshojmë këtë qasje, t'i kushtojmë një rëndësi shumë më të madhe.

Në Planin e veprimit, ne duhet të fokusohemi edhe në disa pika në planin makro ekonomik, debateve në Parlament dhe strategjie që Qeveria duhet t'i ofrojë, jo të kemi një rend dite sa për të pasur, për t'i kryer do punë që janë të domosdoshme të kryhen, por unë kujtoj që ky Parlament duhet ta ndërrojë metodën e punës në planin e veprimit dhe t'iu kushtojë rëndësi, do të thotë, pjesëve që kanë të bëjnë me politikat ekonomike, me politikat buxhetore, pra debatet me politikat lidhur me krijimin e mjedisit për biznes, për investime të huaja, për raporte, për informata, për hapat ku jemi dhe si po ecim, në mënyrë që kur të na matin të tjerët, të mos bëhet tepër vonë dhe të mos kemi progres.

Në Planin e veprimit, mendoj të veçohen edhe objektivat, sidomos për të treguar institucionet tona jo vetëm vullnetin politik, por vendosshmërinë dhe, thjeshtë, aftësinë për të zgjidhur çështjet ekonomike, si në vijim. Ne me deklarata po mundohemi ta mbulojmë terrenin, por kujtoj që duhet një vendosshmëri, një veprim shumë më i madh dhe konkret për një transparencë të plotë në sistemin e prokurimit, që unë kujtoj është tepër i dështuar gjatë gjithë viteve prej që ka filluar ky sistem në Kosovë. E dinë të gjithë, por kështu është e vërteta.

Luftimin e korrupsionit që me fjalë nuk e lëmë keq, por me veprime konkrete mendoj se jemi bars me zero, e mos të flasim për krimin e organizuar, kur dera është qelë në të gjitha anët, sepse nuk kemi arritur të bëjmë asgjë. Këta janë tregues që do të na masë dikush, por është mirë edhe na në Parlament, po them, të bëjmë debatin dhe t'i qesim ato variantet, mundësitë për të parë realisht se si e vlerësojmë dhe çfarë masa po marrim si Parlament dhe si Qeveri.

Unë mendoj që Parlamenti duhet me veprimet e veta të ketë edhe kontrollin parlamentar lidhur me mbikëqyrjen dhe transparencën e menaxhimit e financave publike, në nivelin qendror dhe lokal. Mbikëqyrjen dhe menaxhimit e Fondit të privatizimit dhe të Fondit pensional, e jo të shkojmë me këtë këngë të vjetër si deri me tani e të mos arrijmë as ta vejme në rend dite, e pastaj të kemi zhvillime të padëshirueshme. Një vendosje e debatit parlamentar dhe një transparencë në privatizimin e ndërmarrjeve strategjike, i dimë të gjithë, por asnjëherë nuk po mund ta vendosim këtë në Parlament. Apo një vendosje e

debatit parlamentar dhe mbikëqyrje e dhënies në shfrytëzimin afatgjatë në koncesion të pasurive, qoftë nga Qeveria në nivelin qendror, apo nëpër komuna për t'i parë ato sikur që i kemi pasur në atë ligjin e parë lidhur me ato interesa nacionale dhe pasuri për të cilat duhet të informohet publiku, qytetari dhe parlamenti ta thotë përmes debatit të vet. Sikur që kemi edhe vendosjen e debatit parlamentar në këtë plan veprimi, pra lidhur me politikën dhe strategjitë e investimeve në infrastrukturë, në telekomunikacion, pastaj në lëvizjen e lirë të mallrave dhe të kapitalit që asnjëherë nuk i kemi çelë temat në këtë parlament dhe kur të na vijnë këto raporte të progresit, do të shohim se kemi ngelë mbrapa, ne nuk i kemi shqyrtuar, pra s'kemi arritur ta vendosim asnjëherë, qoftë me funksionimin e sistemit doganor, kontrollimin e pikave doganore apo të sistemit bankar, gjegjësisht ndalimin apo masat kundër shpëlarjes së parave. Krejt kjo, pra, është në funksion të asaj që plani i veprimit dhe konsideroj se Parlamenti duhet t'i ngreh këto aktivitete, t'i ketë në kuadër të agjendës së këtij plani të veprimit, në mënyrë që nesër pra ky progres të jetë shumë më i mirë dhe realisht të kalojmë sa më shpejt me këto sfida në përmbushjen e atyre standardeve në këtë proces që është me interes nacional për vendin dhe për ardhmërinë e vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Sylja.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

E nderuara ministre,

I nderuar ministër,

Deputetë të nderuar,

Çështja e integriteteve evropiane është synim tanimë i dëshmuar nga institucionet e Kosovës dhe vetë populli i Kosovës, prandaj Raportin e sotëm të Komisionit për Rezolutën për prioritetet dhe strategjitë e Kosovës për integrim në Bashkimin Evropian dhe Planin e integritetit për sfidat e Raportit të progresit të Komisionit Evropian në vitin 2008 e mirëpres dhe e përgëzoj Komisionin. Njëkohësisht, shpreh keqardhjen për mosseriozitetin e Qeverisë dhe të vetë zëvendëskryeministrit Hajredin Kuçi, i cili është i përcaktuar nga Qeveria për integrimet evropiane. Procesi i integriteteve është i gjatë, i mundimshëm, kërkon përkushtim dhe vetë mospresenca e zëvendëskryeministrit tregon për mosinteresimin.

Sa i përket Rezolutës, kjo është një konfirmim i sërishëm i vullnetit politik për të qenë pjesë e familjes evropiane dhe po ashtu për të intensifikuar dhe thelluar marrëdhëniet në mes të Bashkimit Evropian dhe të Kosovës. Gjithashtu, me Rezolutë është shprehur gatishmëria dhe synimi për përmbushjen e standardeve evropiane, duke vënë prioritet dimensionin evropian dhe perspektivën evropiane. Njëkohësisht, Komisioni ka propozuar edhe Projektplanin e veprimit për sfidat e Raportit të progresit të Komisionit evropian për vitin 2008. Projektplanin i veprimit u përgjigjet 110 sfidave për institucionet e Kosovës dhe sidomos për Kuvendin e Kosovës, që dalin nga Raporti i progresit për Kosovën. Në këtë plan, në mënyrë konkrete janë përcaktuar mbi 230 veprime, të cilat përfshijnë kryesisht veprimet e komisioneve të Kuvendit, të Kryesisë së Kuvendit, por edhe të administratës, realizimi i të cilave kërkon gjithashtu përmbushjen e këtyre veprimeve.

Unë kam disa vërejtje të vogla, që kanë të bëjnë lidhur me afatin kohor, meqenëse në disa pjesë të planit janë të përfshirë periudha për vitin 2008, mendoj që kjo duhet të korrigjohet dhe të bëhet në vitin 2009. Gjithashtu, sfidën më të madhe e shoh në zbatimin nga vetë institucionet e Kosovës, në radhë të parë nga Kuvendi, por edhe më shumë nga Qeveria.

Ju ftoj që në të ardhmen më shumë të jetë në agjendë dhe të debatohet më tepër për çështjen e integriteteve evropiane. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Avdiu.

RAMADAN AVDIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

E nderuar ministre dhe ministër!

Unë nuk do të ndalem as për rëndësinë e Rezolutës, as për domosdoshmërinë e ballafaqimit me sfidat të cilat dalin nga Raporti i progresit, por vetëm do të ndalem në disa vërejtje në Rezolutë, në faqen e parë, në pjesën hyrëse, në paragrafin 6, thuhet se “duke marrë parasysh arritjet e deritashme në procesin e mekanizmit përcjellës të stabilizim asocimit të iniciuara në vitin 2004” dua të theksoj se është e pasaktë kjo, sepse mekanizmi përcjellës në stabilizim - asocim është i themeluar në vitin 2003, është iniciuar në vitin 2002, kurse pas Samitit të Selanikut dhe pas Konferencës së Donatorëve në 2003 në Bruksel është themeluar mekanizmi përcjellës. Po ashtu, iu referohet vetëm kriterëve të Kopenhagës të vitit 1993 dhe të Madridit 1995 dhe nuk përmenden fare rekomandimet e Zagrebit në vitin 2000, që kanë të bëjnë ekskluzivisht me regjionin dhe agjendës së Selanikut dhe Samitit të Selanikut, i cili është mbajtur në vitin 2003. Mendoj se këto duhet të përfshihen në pjesën hyrëse të Rezolutës, kurse sa i përket planit të veprimit, vërtet është bukur ambicioz dhe në këtë rast do ta falënderoja, të them, kushtimisht Komisionin për faktin se e ka kursyer Komisionin për Politikë të Jashtme dhe nuk ka parë asnjë obligim gjatë mbikëqyrjes së këtij procesi, do të thotë ballafaqimit me sfidat të cilat dalin nga Raporti i progresit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuari zoti kryesues,

Deputetë, ministër, respekt!

Disa vërejtje parimore. Natyrisht, nuk po flas se ky është synim dhe aspiratë e madhe dhe, fundi i fundit, askush as si shtet nuk do të mund të ekzistonte edhe po të ishte më i madhi, më i forti, më i fuqishmi jashtë proceseve të globalizimit dhe të integritetit. Ky është imperativ që ne duhet të bëjmë çmos për t’u integruar, por për atë duhet punë, tepër punë dhe unë i shoh shumë punë të vështira. Por, disa vërejtje parimore, kështu terminologjike.

Po e zëmë, ne në shqip e kemi familjarizuar termin “Bashkimi Evropian”, a në të vërtetë duhet të thuhet “Unioni Evropian”, sepse ashtu quhet edhe në origjinal, edhe ne i kemi dy terma problematike “bashkimi i shteteve” dhe “bashkësia e shteteve” që kanë dallime të mëdha aty.

Mandej “sundimi i ligjit”. Gabimisht e përdorim në përgjithësi, kurse duhet “sundimi i së drejtës” sepse nuk është fjala për sundimin e ligjit, sepse aty ka edhe rezoluta, ka edhe kushtetutë, e tjera, e tjera. Edhe anglezët i kanë bile tri terma i kanë, e kanë “law” që herë është “e drejtë” herë është “ligj”, por për ligjin e kanë edhe “act”, e kanë edhe “bill”, kështu që nuk është fjala për sundimin e ligjit. Në gjuhë të mëdha të botës përdoret “sundimi i së drejtës”.

Më pastaj “anëtarësim”. Nuk ka “anëtarësim i plotë dhe i paplotë” në dokumentet e Unionit Evropian. “Anëtarësim”, nëse është anëtarësim “anëtar” dhe natyrisht ...

Në këtë dokument që unë personalisht e mbështes mundin, punën dhe qëllimin e mirë, apelohej për disa pika “reforma e gjyqësorit”, “reforma e administratës”. Po mirë, ne mund të bëjmë reforma, por mund të jenë reforma që e çojnë mbrapa. Reforma duhet të definohet asisoj që të ketë koherencë të plotë me rendin juridik të Unionit Evropian. Do të thotë, të jetë në koherencë konsistente. Ndryshe, ne mund ta kemi një sistem gjyqësor edhe për ta reformuar apo për ta degraduar.

Do të isha angazhuar që këtu të stipulohen edhe këto premisa. “Sistemi gjyqësor i pavarur”. Ne nuk e kemi sistemin gjyqësor të ndërtuar sa e si duhet, një, dhe nuk e kemi të pavarur. Ky është një parakusht - *Conditio sine qua non*. Pa këtë nuk mund të flasim për çfarëdo procesi integruar.

Më pastaj, ekzekutivi duhet të jetë i pavarur edhe legjislativi, por këto të tria duhet të jenë reciprokisht të kontrolluara dhe duhet të destipulohet kjo kauzë, se është relevante për këtë çështje. Bile, ky quhet checks and balances.

Na në Republikën tonë nuk e kemi rendin juridik të ndërtuar. Pa rend juridik nuk mund të flitet për asgjë. Ne duhet të bëjmë stipulimin për ndërtimin e rendit juridik bashkëkohor. E kemi një rend juridik tepër problematik, që konsiston nga shumë rende juridike, që janë në kolizion reciprok. Edhe një numër i konsideruar i këtyre postulateve do të duhej të shndërrohej në akte ligjore me sanksione, ndryshe do të kishim folë fjalë të hijshme, atraktive, por asnjëherë të aplikueshme.

Dhe, përfundimisht, ju lutem, ne pa standarde të harmonizuara me ato të Unionit Evropian nuk mund të ëndërrojmë për integritet. Bie fjala, shembull. Një mjek i yni, ta marrim një mjek i yni, mund t’i ketë 500 a 1000, nuk e di pacientë, ndërsa dihet, janë do standarde dhe mjeku mund të jetë eksperti më i mirë, por s’mund të jetë mjek i mirë kur ka numër aq të madh të pacientëve. Ose, të marrim një pedagog, po e zëmë, pedagogut, janë do standarde që, po e zëmë, sot aktualisht në Universitetin publik, që fundi i fundit e kemi për xhan, për shpirt, si të them. Ju lutem, ka rast, që unë di, që një pedagog i ka hiç më pak se 2000 studentë. Mund të imagjinohet efekti apo rezultati. S’ka aty rezultat, prandaj këto janë... Ose e marrim një gjykatës. Ne dimë për ta akuzuar gjyqësorin mjaft, e akuzojmë si thuhet nga dëshirimet që kemi dëshirë për ta parë një gjyqësor efikas, eficient, por nuk mund të jetë gjyqësori efikas përderisa një gjykatës ka një numër enorm... Nuk po them me të dhëna, se enti statistikor s’na jep të dhëna së paku deri më tash, por unë supozoj që ka me qindra e qindra raste që janë shumë të ndërlikuara dhe se ato janë të paimagjinueshme për një gjykatës, po e zëmë, të një shteti të përparuar të Evropës për ta marrë përsipër për t’i menaxhuar ato raste, si të them, gjyqësore. Prandaj, pa këto standarde ne duhet t’i inkludojmë disa standarde të këtilla dhe ato t’i sanksionojmë. Ndryshe, do ta kishim bërë një dokument mjaft të mirë dhe do të mbetej si i tillë në letër të bardhë, germë e zezë në letër të bardhë. Faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit zoti Smaka. Fjalën e ka zoti Gani Buçinca, me kartelën e Sala Berishës.

GANI BUÇINCA: Faleminderit, zoti kryesues!

Ju përshëndes të gjithëve këtu në sallë!

Unë nuk desha të involvohem në diskutim, mirëpo desha të jap edhe unë kontributin tim modest sa i përket pikës të cilën po e shqyrtojmë. Parimisht, të gjithë do ta përkrahim Rezolutën. Desha të ndalem vetëm te Plani i veprimit, i cili është mjaft ambicioz, por ma merr mendja se ka disa mangësi, sidomos në drejtim të atyre të cilët e ushtrojnë pushtetin

në Kosovë. Ne e dimë që e kemi Qeverinë që ushtron pushtet në Kosovë, por e kemi edhe EULEX-in, kemi edhe Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar këtu dhe, padyshim, në fushën e rendit dhe të ligjit, Parlamenti duhet të kryej funksionin e vet, që të kërkojë edhe nga këto dy institucione ndërkombëtare që kanë pushtet në Kosovë që të jenë më të vendosur në zbatimin e rendit dhe të ligjit në Kosovë.

Është shumë iluzore të pritet që ne t'i realizojmë të gjitha standardet evropiane për një periudhë njëvjeçare, për të cilën është bërë raporti i veprimit, mirëpo, sidoqoftë, ky raport do të ketë sigurisht edhe konotacion, si të them, shumë pozitiv në punën dhe veprimin e Qeverisë dhe të institucioneve në Kosovë.

Në Kosovë, një prej sfidave më të mëdha të Kosovës, sipas mendimit tim, është kriteri ekonomik, i cili është bazë edhe për stabilitetin e përgjithshëm në Kosovë, edhe për sigurinë, edhe për luftën ndaj korrupsionit dhe shumë fenomeneve devijante në shoqërinë tonë. Mirëpo, kur jemi te ekonomia, si një standard për integrim në Bashkimin Evropian, ne duhet të orientohejmë dhe të shikojmë ekzekutivin në Kosovë. Nuk po mendoj vetëm në Qeverinë, por edhe në organizmat ndërkombëtarë që janë këtu – sa kanë ata tolerancë ndaj atyre proceseve në Kosovë të cilat e dëmtojnë rënd ekonominë e Kosovës dhe sigurinë e qytetarëve.

Këtu, ma merr mendja se Kuvendi duhet të jetë më aktiv në komunikimin me EULEX-in dhe Zyrën Civile Ndërkombëtare, si dhe më aktiv me komunikimin me Parlamentin Evropian drejtpërdrejt. Sepse, shpesh na ndodhë që Parlamenti Evropian ka disa kritere për një shtet të caktuar, kurse disa kritere të veta nuk i respekton për një shtet tjetër. Për shembull, e kemi Greqinë, një shtet mik i yni që ka mbështet Kosovën në procesin e pavarësisht të saj dhe që ka angazhime në Kosovë, mirëpo nuk ekzistojnë liritë fetare në atë shtet, fare nuk ekzistojnë. As të drejtat e minoriteteve dhe, përkundër këtij fakti, Greqia është anëtare e barabartë e Bashkimit Evropian. Kurse, kur është në pyetje Kosova, për shembull, shpeshherë këtu na jepen vërejtje për shkeljen e të drejtave të minoriteteve, të lirive fetare e ku ta di, që nuk janë aq të justifikueshme dhe nuk janë të qëndrueshme.

Pastaj, lëvizja e lirë dhe e kontrolluar e mallrave në Kosovë. Në këtë sferë, për shembull, ka shumë dobësi, sidomos te ato organizma ndërkombëtarë që veprojnë në Kosovë. Ne jemi për lëvizjen e lirë të qytetarëve dhe të mallrave, por jo për lëvizjen e pakontrolluar as të mallrave, as të qytetarëve, kurse sot jemi dëshmitarë se në Kosovë kemi lëvizje të pakontrolluar të qytetarëve. Në Kosovë mund të hyjë kush të dojë nga veriu i Kosovës dhe mund të veprojë si të dojë. Nuk kemi një regjim kufitar, i cili e përcakton mënyrën se si hyhet dhe si dilet nga Kosova, edhe për mallra, edhe për njerëz. Dhe, në këtë drejtim, ma merr mendja se Parlamenti duhet të jetë shumë më aktivë që të kërkojë nga ata të cilët e zbatojnë ligjin në Kosovë, jo vetëm nga Qeveria e Kosovës, se shpesh për shumë përgjegjësi, për shumë probleme akuzohet Qeveria, e në fakt këtu janë edhe mekanizmat ndërkombëtarë që kanë një shkallë shumë të ulët të standardeve për respektimin e disa të drejtave që janë të vetëkuptueshme për çdo shtet dhe për çdo qeveri. Nuk na lënë t'i ushtrojmë ato të drejta. Dhe, në këtë drejtim ma merr mendja se Parlamenti duhet të jetë shumë më aktiv si institucion.

Vërejtja se në disa segmente Parlamenti dhe Plani i veprimit i merr disa ingerenca edhe të qeverive. Ma merr mendja se ne duhet të orientohejmë si Parlament dhe si Plan veprimi vetë në fushën zbatimit të ligjeve në Kosovë dhe duke e kryer këtë funksion, Parlamenti nëpërmes të Komisionit, i cili e kishte përgatitur një Plan të veprimit mjaft voluminoz

dhe përmbajtjesor, do të kryej edhe funksionin e vet institucional që e ka në Kosovë. Në këtë drejtim, besoj se ka vend për të diskutuar që aktorët të cilët e ushtrojnë pushtetin në Kosovë, duhet të japin llogari edhe para Parlamentit të Kosovës, përfaqësuesve të zgjedhur të popullit dhe nuk mund për çështje politike të anashkalojnë zbatimin e ligjit në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Kelmendi.

NEKIBE KELMENDI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë mendoj se Raporti i progresit për Kosovën i vitit 2008, me vërejtjet e veta të përmbajtura në të u është adresuar të gjitha institucioneve të Kosovës, përkatësisht të tri pushteteve të Kosovës: pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe atij gjyqësor. Aty janë dhënë vërejtje jashtëzakonisht të rëndësishme për të ardhmen e Kosovës dhe integrimin e saj në BE dhe në mekanizmat tjerë ndërkombëtar.

Duke u nisur nga kjo, mendoj se secili nga këto tri pushtetet, përkatësisht secili institucion duhet t'i identifikojë vërejtjet që i adresohen atij dhe të hartojë planin e veprimit për t'i përmbushur ato vërejtje, në mënyrë që të krijojmë një bazë për një raport shumë më të mirë kur do të jepet në fund të këtij viti, e ai është Raporti i fizibilitetit për integrimin në BE.

Mendoj se secili nga ministrat e Qeverisë së Republikës së Kosovës i ka identifikuar vërejtjet e veta dhe është zotuar se do t'i plotësojë apo do t'i mënjanojë ato të meta të identifikuar dhe, përveç kësaj, edhe Qeveria, si tërësi, e ka identifikuar atë që asaj i bie barrë, kështu që me plane përkatëse, të cilat duhet të zbatohen dhe, natyrisht, se janë të mundshme, sepse ka në mesin e tyre edhe disa që për shkak të implikimeve buxhetore nuk mund të realizohen, por së paku deri 90% t'i realizojmë në mënyrë që vërtet të lëmë një përshtypje të mirë se jemi duke vepruar sipas atyre vërejtjeve. Prandaj, për mendimin tim, Rezoluta apo ky dokument që është paraqitur sot për miratim në Parlament, veç sa e sforcon atë përcaktimin tonë për t'i identifikuar ato vërejtjet a të meta që i thashë dhe për t'i eliminuar ato, prandaj unë, që të mos e përsëris rëndësinë që ka kjo rezolutë, i jap mbështetje të plotë Rezolutës.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Tali.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe unë dy herë deri tash e ndërrova mendimin a të flas apo jo, por megjithatë do të flas, sepse shumë sende u thanë, për çka edhe pajtohem me disa parafolës, në esencë.

E lexova këtë plan të veprimit. M'i kujtoi disa plane të veprimit që më kanë ardhur në dorë, kështu t'i lexoj, të shteteve evropiane, të cilat në përfundim të viteve të 70-ta dhe të 80-ta ende nuk ishin inkuadruar në Bashkësinë Evropiane të asaj kohe dhe që synonin. Domethënë, ato shtete që sapo kishin dalë nga diktatura. Dhe, krejt programet të cilat i kam lexuar, i kam lexuar sepse në atë kohë isha duke shkruar një libër për Unionin Evropian, shihej aty, domethënë ka ngjashmëri edhe ky program i ynë këtu, ky plan i veprimit, domethënë me objektiva të mira, por që në esencë ajo substanca ishte jashtë kohës. Nuk po përmend shtetin për shkak se mbase është ndokush përfaqësues i atij shteti, por megjithatë shtet evropian në vitet, po flas 79-80, me synime të inkuadrohet në Bashkësinë Evropiane, i dalë nga diktatura shumë e ashpër, diktaturë e cila veç kishte prodhuar një esnaf politik çfarë prodhon diktatura. Domethënë, asi politikanë që nuk dinë ndryshe të thonë veç "po zotëri". "Po zotëri", iu thonë atyre që janë mbi ta. Dhe, kjo po

lidhet me atë kritikën që na dha Volk, e që tash mediet e kanë publikuar apo i kanë dhënë rëndësi kështu pak më shumë, sepse në Parlament ngelin shumë çështje me rëndësi për publikun për t'i diskutuar për shumë arsye.

T'i kthehem atij shteti se ka shumë ngjashmëri. Edhe pse ishte Bashkësia Ekonomike Evropiane apo Bashkësia Evropiane shumë e interesuar për shkak të luftës së ftohtë që të gjitha shtetet perëndimore t'i fusë në gjirin e vet dhe duke pasur parasysh gjithmonë ato antagonizmat e fuqive të mëdha brenda Bashkësisë Evropiane, çonin ekspertë atje, të shumtë, të cilët me të vërtetë dëshironin që ato shtete t'i inkuadronin në ... Po, problemi ishte te esnafit politik atje. Domethënë, kishin të bëjnë me politikanë, me udhëheqës të dalë nga diktatura. Politikanë pa unë të vetin, pa vizion për Bashkësinë Evropiane, politikanë të cilët ishin shumë të interesuar për karrierën e tyre dhe do ta shërbenin gjithkënd, qoftë diktaturën, qoftë demokracinë. Dhe, kishin hall Bashkësia Evropiane se si t'i reformonin ata. Nuk mundën t'i reformojnë derisa nuk erdhën në shprehje fytyrat e reja, politikanë të ri të cilët nuk kishin krijuar karrierë politike në diktaturë. Dhe, kështu po ma çon mallin edhe Kosova e sotme. Kemi plane veprimi të mira, kemi objektiva të mira, por kush do t'i implementojë, gjithmonë duke pasur parasysh edhe qasjen e Brukselit ndaj Kosovës. Unë them, kurrë ne nuk duhet ta harrojmë UNMIK-un – Shtyllën e katërt të UNMIK-ut, të bëmat dhe jo të bëmat e asaj Shtylle dhe tash i kemi disa udhëheqës të tjerë, të cilët mua ende nuk më kanë bindur se kanë disponim të njëjtë ndaj Kosovës, ashtu siç kanë pasur disponim të njëjtë ndaj atyre shteteve të perëndimit që posa kishin dalë nga diktatura dhe tentonin me mish e me shpirt, siç thonë, t'i fusnin në gjirin evropian. Disi me Kosovën janë kah sillen si me një fëmijë të padëshirueshëm ta kenë, nga vetë fakti se jemi viti i dhjetë dhe hasim anomali të llojeve të ndryshme të ndërhyrjes së zyrave ndërkombëtare në politikëbërje, në ngushtim të hapësirës së krijimit të politikës nga politikanët kosovarë dhe në njëfarë mënyre favorizimi i atyre që janë të dëgjueshëm, a, të politikanëve që u thonë “po”, apo të zotëri “po”-ve. Dhe, tash vjen edhe problemi tjetër, problemi me partitë politike se sa janë, në përgjithësi them, se sa janë demokratike liberale brenda vetit për të nxjerrë kuadrot të cilat mund një plan të tillë ta implementojnë, të paktën nëse jo të tërin, atëherë 75% apo 80%, ngase me një esnaf politik çfarë e kemi krijuar, nuk dua t'i veçoj njerëzit apo të flas konkretisht, por deri më tani jemi treguar jo të aftë që të bëjmë diçka, kështu edhe na thonë edhe diplomatët e huaj, të cilët e kanë njëfarë uni të vetin.

Unë po them se ky plan i veprimit, i shkruar është mirë, ndonëse prioritetet, po ta kisha shkruar unë, do t'i ndërroja. Por, megjithatë, aty janë. Veç problemi është si do ta implementojmë dhe çfarë qëndrimi do të ketë Brukseli apo sa do të ndikojë Brukseli që ky proces të përshpejtohet, që unë jam shumë skeptik. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë po e shoh se një pjesë janë lodhur dhe po më kërkojnë pauzë. Janë edhe disa diskutues, por po japim pauzë deri në orën 15:00 dhe pastaj vazhdojmë me diskutime. Faleminderit!

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,
I zëni vendet, po vazhdojmë me debatin e lënë. Fjalën e ka deputeti Hajdin Abazi.

HAJDIN ABAZI: Faleminderit, zoti kryesues!
Rezoluta që sot është parashtruar në Kuvend lidhur me përgatitjet infrastrukturore në aspektin ligjor dhe të tjera rreth integritimeve në Unionin Evropian, mendoj se është një

hap i kohës, është një veprim shumë i drejtë dhe ne duhet ta shprehim edhe kësisoj përcaktimin tonë për arsye se Kosova nuk ka edhe s'mund të ketë ndonjë të ardhme tjetër, përveç asaj që të jetë në gjirin e kontinentit, të jetë në gjirin e popujve dhe në gjirin e Unionit Evropian. Në këtë aspekt, kjo rezolutë shpreh qartë vullnetin e popullit të Kosovës, shpreh qartë përcaktimin tonë politik dhe...

KRYESUESI: Ju kisha lutur për qetësi, kolegë dhe kolege deputetë, ju kisha lutur për qetësi!

HAJDIN ABAZI:... dhe kësi soji ne edhe de jure e shprehim nga instanca më e lartë e Republikës së Kosovës përcaktimin tonë drejt Unionit Evropian dhe, këtu, përpos atyre sugjerimeve që i bëri zoti Ramadan Avdiu, nuk kam ndonjë vërejtje, pajtohem plotësisht me te. Por, unë do të ndalesha një çik në lidhje me Propozimin e planit të veprimit.

Së pari, është për t'u përsëritur që me kaq seriozitet janë marrë vërejtjet dhe sugjerimet nga Komisioni Evropian, që na ka bërë ne dhe kjo është shprehja më kuptimplote se si t'i eliminojmë ato. Unë shfletova me shumë vëmendje komplet planin dhe vërtet është një program që, nëse do të arrijmë të realizojmë, ne do të dëshmojmë edhe seriozitet, do të dëshmojmë edhe aftësi për të ecur përpara.

Unë do ta veçoja vetëm një pikë, e cila ka të bëjë me kapitullin 2.1 lidhur me demokracinë dhe sundimin e ligjit, që lidhet drejtpërdrejt me Kuvendin. Këtu do ta përmend, për shembull, janë bërë disa sugjerime dhe janë planifikuar të merren disa hapa dhe kjo ka të bëjë drejtpërdrejt me ne si deputetë. Ne i dimë dhe kushtet minimale ende nuk e kemi që të mund ta ushtrojmë detyrën tonë si duhet. Këtu parashihet që të shtohen komunikimet me qytetarët, komunikimet me OJQ-të, komunikimet me shtresat e tjera, por këtu parashihet edhe sigurimi i zyrës dhe i asistentit personal për secilin deputetë. Realizimi i këtij programi ne do të na mundësonte që vërtet të gjitha pikat e tjera t'i realizojmë më me shpejtësi, më me efikasitet. Prandaj, ndoshta, mirë, kjo figuron në tremujorin e parë të këtij viti, do të realizohet, por në këtë tremujor na ka mbetur vetëm edhe një muaj dhe unë jam skeptik se do të arrijmë ta realizojmë.

Përndryshe, ky program, mua më duket këtu u tha, se është ambicioz. Unë do ta quaja pak më shumë dhe do të kisha dalë me një propozim që ta dëshmojmë seriozitetin tonë dhe përkushtimin tonë që ky plan të operacionalizohet dhe të ndahet, se unë kam bindjen që brenda një viti ne nuk do të arrijmë të realizojmë këtë plan dhe pastaj do të ulemi dhe do t'i numërojmë dështimet tona. Që të mos ndodh kjo, ndoshta do të ishte mirë që ne këtë plan ta zgjerorim në një afat dyvjeçar, por të jetë më real dhe të mund ta realizojmë.

Kompetenca të shtuara dhe, në fakt, që kërkohet të bëhen komisione të ndryshme funksionale në mbikëqyrjen dhe përcjelljen e punëve të Qeverisë në segmente të ndryshme, unë besoj se kjo ka për ta fuqizuar edhe vetë punën e Qeverisë, por edhe do t'i jap pushtet më tepër deputetit, nëse mund ta quaj si një hallkë ndërlidhëse midis Qeverisë dhe votuesve ose popullit, që të mund të japë kontributin e vet për të bërë disa përmirësime, për të parandaluar disa gabime ose keqmenaxhime të caktuara. Prandaj, që ne të shkojmë me një mori kaq të madhe ndërmarrjesh, unë konsideroj se Kuvendi duhet të shpall gjendje të jashtëzakonshme dhe ne të punojmë jo 8 orë pune, por edhe 12 orë pune gjatë çdo dite dhe prapë nuk do të mundemi ta realizojmë. Pikërisht për këtë, konsideroj se ndarja ndoshta në dy pjesë, që do të mundemi ta realizojmë, do të dëshmonte se ne e kemi me seriozitet dhe me gjithë mend. Pra, ne të kujtojmë se edhe

komisioni që i ka bërë këto sugjerime, do t'i përcjellë këto vendime nëse ne do ta aprovojmë kësaj dhe do të na përcjellë sa po mundemi ta realizojmë.

Unë dëshiroj nga zemra që jo për një vit, ne të mundemi edhe për tre muaj t'i kryejmë, por e konsideroj se është thuajse e pamundur në tërësi të implementohet brenda një viti.

Mirëpo, unë kisha propozuar që pikënisja të jetë pikërisht nga krijimi i kushteve, për deputetë një zyrë, sikurse që thuhet, një asistent apo asistente që të mundet t'i grumbullojë materialet, ligjet dhe të mundet të punojë në mënyrë më sistematike me qëllim që, vërtet, kontributi ynë të mos jetë duke i bartur letrat poshtë e përjetë, të mos kemi nevojë që të takohemi nëpër kafiteri ose në vende të papërshtatshme me qytetarët që vinë të na drejtohen, po të kemi një vend ku ne mund t'i pranojmë qytetarët, ta dinë qytetarët ku e kemi një adresë individualisht, si deputetë, dhe të mund t'i ngrehin problemet dhe ne pastaj t'i përcjellim ato probleme që janë për t'i ngritur në Kuvend. Konsideroj se me këto kushtet, ne do të kemi mundësi të jemi 100 herë më efikas se sa që kemi qenë deri sot, por njëherësh edhe komisionet do të arrijnë t'i realizojnë të gjitha këto funksione shtesë ose, të them më saktë, në fakt, funksionale që i bëjnë të drejtat që i kanë, që t'i realizojnë duke i ftuar ministrat, duke i ftuar segmente të ndryshme dhe duke bërë, duke ushtruar një lloj ndërmjetësimi të ndërsjellë si për zbatimin e ligjeve, ashtu edhe për defektet ku i vërejnë qytetarët dhe na i përcjellin ne.

Prandaj, edhe njëherë, krejt në fund, po e them se do të ishte mirë që të jemi pak më racional edhe më të arsyeshëm që ta bëjmë më pragmatik dhe të shkojmë me hapa ndoshta pak më të ngadalshëm, por t'i realizojmë dhe të jemi me sukses. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Aliaj.

SANIJE ALIAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar ministër,

Të respektuar deputetë,

Është shumë e qartë se Raporti i progresit 2008 për Kosovën ka obliguar institucionet e Kosovës në të tri shtyllat e shtetit për efikasitet dhe transparencë më të madhe në punë për të realizuar synimin për integrimet evropiane, por edhe globale në përgjithësi.

Rezoluta dhe Plani i veprimit të Kosovës janë dokumente të mira që nuk jemi mësuar t'i kemi në dispozicion deri tani, sepse definojnë objektivat e veprimit, përcaktojnë institucionet dhe mekanizmat që i realizojnë këto objektiva, njëherësh dhe caktojnë afatet kohore për realizimin e obligimeve. Por çka është më me rëndësi për të theksuar, rrit transparencën dhe efikasitetin e punës në institucionet e Kosovës për ngritjen dhe plotësimin e standardeve për t'u integruar në Bashkimin Evropian. Konfirmon gatishmërinë e institucioneve të Republikës së Kosovës për thellimin e bashkëpunimit me BE-në dhe praninë ndërkombëtare në Kosovë. Mirëpo, Plani i veprimit të Kuvendit të Kosovës për të mos mbetur dokument i vullnetit të mirë, sepse për t'u realizuar këto objektiva mendoj paraprakisht duhet të plotësohen disa kushte për të qenë efikas Kuvendi edhe komisionet parlamentare.

Kuvendi duhet të sigurojë hapësirë pune për deputetët, komisionet parlamentare të hartojnë planet e veprimit për realizimin e këtyre objektivave. Në seancat plenare të Kuvendit në vazhdimësi të jetë një pikë e rendit të ditës për të raportuar komisionet parlamentare për çështjet me interes për qytetarët, që puna e tyre të bëhet transparente e

jo të mbesë në sirtarët e Kuvendit. Të bëhet një balancë mes komisioneve parlamentare dhe ministrive të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Të mundësohet koordinimi i punëve ministri – komisione parlamentare. Mekanizmat e ministrive përkatëse të informojnë deputetët për të gjitha çështjet me interes, në mënyrë që deputeti të jetë në rrjedhën e punëve të ministrisë, gjë që deri më tani nuk ka qenë në nivelin e duhur, sepse shumë herë komisionet parlamentare u janë drejtuar mekanizmave përkatës të Qeverisë për informacione dhe gatishmëria nuk ka qenë në nivelin e kërkesës.

Në Kuvend të shtohet numri i debateve për zbatimin e ligjit, pra komisionet përkatëse të informojnë lidhur për zbatimin e ligjit, për çështje të rëndësishme strategjike, por për edhe çështje që ndihmojnë zhvillimin ekonomik. Mendoj se këto kushte do të mundësonin realizimin e këtyre objektivave të Planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës. ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në fillim unë e përgëzoj Komisionin për Integritet Evropian që ka hartuar një deklaratë dhe një plan të veprimit, dhe natyrisht konsideroj që deklarata rikonfirmon vullnetin e institucioneve të Kosovës dhe të qytetarëve që ta afrojnë Kosovën afër familjes së Bashkimit Evropian dhe për këtë s'kemi asnjë dilemë dhe kërkoj ndoshta që kjo Rezolutë duhet të përkrahet dhe të votohet.

Mirëpo, unë i kam disa shqetësime rreth planit të veprimit. Unë e kuptoj që komisioni funksional ka afruar këtu në Kuvend një plan të veprimit, një plan i cili është përshkruar nga Plani i progresit për Kosovën nga Komisioni Evropian, por konsideroj që ka qenë e rrugës që me rastin e hartimit të Planit të veprimit komisioni funksional t'i konsultojë apo së paku t'i thërret në takim të gjithë kryetarët e komisioneve apo edhe anëtarët e tjerë të komisioneve me qëllim të harmonizimit të këtij plani dhe, natyrisht, të harmonizimit të datave kur janë paraparë që të raportohet dhe obligimet që janë vendosur në këtë plan të veprimit. Dhe, këto do t'i specifikoj, meqë Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi në këtë Plan të veprimit iu ka dhënë disa obligime. Nga një komision ka qenë e rrugës që së paku të konsultohemi, së paku ta kenë planin e veprimit që e kemi edhe ne si komision fushëveprimtarinë, e mandej të konsultohemi dhe ta bëjmë një plan të veprimit.

Unë do të ndalem konkretisht, që të mos marrë kohë dhe të mos i lodhi deputetët, por po ndalem, ka shumë pika, nuk do t'i ngreh tash të gjitha pikat, por po i ngreh disa pika që janë, për shembull pika 28, thotë: "Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës duhet të aprovohet". Është shumë në rregull, duhet të aprovohet, sepse aktualisht ekziston vetëm një rregullore dhe një ligj i përkohshëm për përbërjen e Këshillit Gjyqësor. Mirëpo, kur tel të veprimet thotë: "Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi duhet shikoj këtë në agjendën e tij dhe të adaptojë këtë ligj në afat sa ma të shkurtër kohor, dhe e qet tremujorin i tretë, që nuk i përgjigjet planit të veprimit që e kemi, edhe planin legjislativ të Qeverisë, por edhe planin e veprimit të komisionit. Çështje më me interes që duhet ta sqarojmë, do të ishte që Komisioni duhet parashih implementimin e ligjit, duke bërë përgatitjen e akteve nënligjore. Do me thënë, na jepet një detyrë, që as s'e kemi në përgjegjësi, as në fushëveprimtari. Komisioni nuk nxjerr akte nënligjore, prandaj ka qenë e rrugës që të konsultohen me komisionet dhe të japin rekomandime të sakta dhe nesër a

pasnesër do të dilet këtu dhe do të thuhet që komisioni nuk e ka përmbush obligimin. Mirëpo, nëse e lëmë kështu si është, unë asnjëherë nuk do të nxjerr akte nënligjore, sepse aktet nënligjore i nxjerr ministria përkatëse apo që e ka përcaktuar ligji.

Mandej, po shkoj te pika 29, thotë: “Dispozitat kushtetuese me të cilat Kuvendi ngarkohet parashohin caktimin e 8 nga 13 anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës”, do me thënë, këtu është çështja për përbërjen e Këshillit Gjyqësor. Shumë interes është ta kuptojmë se në kuadër të veprimit që ia qet komisionit, thotë: “Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi duhet të iniciojë amendamentimin e legjislacionit për të siguruar që është me harmoni me standardet evropiane, të iniciojë procedurën ndërprerëse të mandateve të dyfishta.

Realisht, Komisioni apo përbërja e Këshillit Gjyqësor është e përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe, edhe me ligjin që do ta nxjerrim, që e kemi në agjendën legjislative, ne nuk do ta kemi mundësinë ta ndryshojmë përbërjen, pavarësisht a është me standardet evropiane apo nuk është, sepse këtu kërkohet 3 mujori i tretë 2009, të fillojmë na një nismë, kjo nënkupton sipas kësaj, ne të fillojmë nismën për ndërrimin e Kushtetutës, sepse kjo është e përcaktuar mirë në nenin 108 të Kushtetutës, ku e përcakton përbërjen e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Prandaj, ka qenë dashur dhe është korrekte që të konsultohemi dhe paraprakisht e kishim njoftuar edhe kryetarin e komisionit, por edhe anëtarët se kjo çështje është e rregulluar me Kushtetutë dhe, natyrisht, që edhe në ligjin që do ta kemi pas pak kohe, Ligjin për Këshillin Gjyqësor, shpresoj në qershor, jo në muajin tetor apo nëntor, por nuk do të kemi mundësi të ndryshojmë këtë përbërje, sepse është kushtetuese.

Ka edhe çështje të tjera, për shembull, te Ligji për deklarime për prejardhjen e pasurisë, komisioni thotë duhet, për shembull, të iniciojë procedurën për të bërë publike listën e zyrtarëve, që nuk është punë e jona kjo çështje. Ligji e përcakton, është punë e Agjencionit Antikorrupsion që ta bëjë zyrtare, të publikojë zyrtarët të cilët nuk e kanë publikuar pasurinë.

Ju thashë edhe në fillim, të mos ju marrë shumë kohë, nuk do t’i preki të gjitha pikat, mirëpo është interes t’i kuptojmë se këtu është kërkuar, për shembull, që ne apo Kuvendi të bëjë edhe harmonizimin apo pikat për të krijuar Ligjin e Gjykatës Kushtetuese, një ligj të cilin tanimë e ka Kosova, e ka Ligjin për Gjykatën Kushtetuese. Prandaj, është e rrugës që ndoshta Plani i veprimit të aprovohet, por të aprovohet me këto vërejtje dhe ta harmonizojmë me komisionet përkatëse çështjen e veprimit dhe së paku për ato të cilat tanimë kanë kaluar në Kuvendin e Kosovës, siç është Ligji për Gjykatën Kushtetuese, ka kaluar, nuk kemi nevojë të ekzistojë. Ne mund ta shkruajmë që është krye kjo punë, për hir të asaj që do të raportohet prapë nga Komisioni Evropian për çështjen e progresit, për raportin e progresit, mirëpo nuk konsideroj që neve duhet të na jepet një detyrë e cila është përfunduar, na jetë vetëm një obligim dhe na jetë një pikë e zezë që s’kemi raportua, se s’kemi nevojë.

Prandaj, ju kisha lutur edhe një herë, që ndoshta komisioni funksional është mirë që të bashkërendojë punët me të gjitha komisionet funksionale dhe me komisionet e përhershme dhe të dalim me një harmonizim dhe me një plan të veprimit, i cili do të jetë edhe i implementueshëm, por do t’ju përmbahet edhe afateve të cilat janë paraparë në këtë plan të veprimit. Faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Ramosaj.

BERIM RAMOSAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për kolegët deputetë,

Vërtet, arsyeshmëria për një rezolutë qëndron, por ende nuk e kam kuptuar se kjo rezolutë a vjen si refleksion i Raportit të progresit, apo është qëndrim i qartë i vetëm pjesës së legjislativit të Kosovës që shprehin vullnetin tonë të bëjmë diçka në planin e integritimeve evropiane.

Kjo për mua është më tepër e diskutueshme kur e shoh se në rendin e ditës janë vu, në fakt, 3 çështje përmes një pike. A duam ne sot ta aprovojmë një rezolutë, me të cilën shprehet në mënyrë deklarative Kuvendi i Kosovës se jemi të gatshëm për bashkëpunim me Bashkësinë Evropiane, respektivisht me Unionin Evropian në shumë fusha, dëshirojmë sot të vejmë prioritetet e integritimit të Kosovës karshi Bashkimit Evropian, apo dëshirojmë të prezantojmë një strategji të Kosovës. Ajo çka e rëndon edhe më tepër këtë rezolutë, është edhe plani i veprimit. Planin e veprimit, në fakt, është çështje jona, që në fakt tregon anën operacionale të veprimit, qoftë të legjislativit, qoftë të ekzekutivit në Kosovë, pa marrë parasysh edhe institucione tjera, që në fakt nuk e dëmton procesin, por ky kishte për të qenë një plan për çështjet tona. Ne sot, si legjislativ, është dashur të reflektojmë se jemi të gatshëm të merremi me sfidat të cilat i kërkon koha në lëmin e ndërtimit të standardeve evropiane. Ajo duhet të jetë krejt esenca e një rezolute, e cila kishte për të pasur arsyeshmërinë e vet. Ndërsa, plani i veprimit më tepër është një projekt i punës së institucioneve të Kosovës në nivel kohe dhe në nivel funksioni, që shihet me këtë projektion të këtij raporti, respektivisht të këtij rekomandimi që bëhet se çka do të bëjmë brenda një viti apo brenda 2 vjetësh.

Refleksioni i cili është dashur të ndodhë, gjegjësisht Qeveria e Kosovës është dashur të reflektojë karshi Raportit të progresit, që një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Përveç disa deklaratave që kemi pasur, duhet të reflektojë, sepse Raporti i progresit tregon shumë mangësi të Kosovës edhe në planin e zhvillimit ekonomik, edhe në planin e integritimit, edhe në planin e zotërimit apo të mbretërimit të shtetit të së drejtës, edhe në planin e korrupsionit, edhe në planin e ekonomisë joformale, të gjitha këto janë elemente të cilat ishte dashur Qeverisë së Kosovës t'i japin rekomandim për refleksion, e refleksioni nuk bëhet vetëm në mënyrë deklarative, por me veprime konkrete.

Duke marrë parasysh vullnetin e mirë të qytetarëve të Kosovës, respektivisht të legjislativit në Kosovë, po e shoh që ne normalisht e kemi realizuar këtë përmes kësaj rezolute, po mundohemi diçka të bëjmë në këtë plan. Mirëpo, Bashkimi Evropian do të hapë hapësirë, do të japë mundësi të integritimit të Kosovës vetëm në rrethana të caktuara kur ne i plotësojmë standardet, që jemi larg tyre, e ato standarde janë të të gjitha fushave, jo vetëm të natyrës ekonomike, sociale, të nivelit të arsimit, të nivelit të shëndetësisë, të nivelit të zhvillimit të institucioneve, të kapaciteteve të institucioneve të Kosovës, të zhvillimit të demokracisë e të tjera. Faktikisht, po të kishte qenë çështje e deklarimit, ne kemi shembuj të shumë shteteve, edhe të regjionit, edhe përreth që në mënyrë deklarative janë shprehur pro integritimeve evropiane miliona herë, por integritimin që e realizojnë sot, apo mundësinë e integritimit shihet që realizojnë vetëm duke u mbështetur në implementimin e standardeve evropiane, e tash në qoftë se e shohim këtë, problemet qëndrojnë te ne.

Ndërtimi i një shteti juridik, ndërtimi i një ekonomie formale, e cila garanton një rritje ekonomike normale dhe ndërtimi i një shteti funksional janë baza të shëndosha për

integrim, nuk ka tjera. A deklarohe mi ne nj her , a deklarohe mi nj  milion  her , nuk  sht  aq shum  e r nd sishme. Vullneti politik i kosovar ve  sht  shprehur miliona her  se jemi p r integritime evropiane. Edhe kjo rezolut  nuk prish  pun , por  sht  e ngarkuar me planin e veprimit,  sht  e ngarkuar me prioritete,  sht  madje e ngarkuar me strategjit  tona, q  asnj her  nuk na lypet neve t  na imponohen.

N  k t  plan, Kosova n  raport me vendet tjera ka oportunitete, ka shansa m  t  mira. Vet  fakti q  n  Kosov  ekziston Bashk sia Nd rkomb tare dhe at  edhe n  institucionet e gjyq sis , edhe n  institucionet e siguris , bile, bile edhe n  institucione t  p rgjithshme, k shtu, duke marr  parasysht ekzistimin edhe t  ICO-s, edhe t  EULEX-it edhe t  tjera. Ekzistimin e shum  zyrave si mb shtet se t  projekteve tona, ne n  raport me vendet e tjera kemi oportunitete, kemi shanse m  t  mira.

Andaj, nj  rezolut  e thjesht , e cila shpreh vullnetin e qytetar ve t  Kosov s, respektivisht t  legjislativit, kishte p r t  qen  e mjaftueshme, nd rsa plani i veprimit le t  jet  objekt shqyrtimi, objekt operacionalizimi edhe p r ne k tu, si legjislativ, por edhe p r institucione t  tjera. Prandaj, kjo  sht  nj  garanci e mir , pa dashur t  n n moj  pun n e nj  komisioni, sepse tek e fundit, na ka sfiduar p r t u ky ur n  k t  proces, por rezoluta ka kuptimin e nj  shprehje ton  deklarative, nd rsa plani i veprimit  sht   shtjje operationale q  duhet t  zbatohet n  nivel kohe dhe n  nivel funksioni.

Duke marr  parasysht t  gjitha k to, un  p rsh ndes komisionin p r pun n q  ka b r , por duke mos ngarkuar rezolut n me elemente t  cilat jan  t  natyr s programore tonat, qoft  si institucione t  Kosov s n  aspektin e ngritjes s  kapaciteteve, qoft  n  kryerjen e detyrave tjera t  sht piss  me q llim t  nd rtimit t  nj  shteti funksional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Fjal n e ka deputeti Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!
Se sa institucionet e vendit, m  konkretisht Qeveria,  sht  e interesuar q  Kosov n ta drejtoj  drejt integritimeve evropiane, po flet edhe mosprania e tyre sot k tu, e jo rrall  her  kur debatohet p r  shtjje t  tilla t  r nd sishme n  k t  Kuvend mungojn  ministrat dhe mungon Qeveria.

Nuk do t  doja t  flas p r rezolut n, sepse pajtohem me t  gjitha ato q  u than . Kam disa sugjerime p r komisionin, i cili disa nga obligime t  nj jta ua ka adresua bart sve t  ndrysh m, q  konsideroj se mund t  shkaktoj  p rplasje, at  q  e tha edhe zoti Hyseni, prandaj ky dokument mund t  begatohet n  t  ardhmen.

K to jan  ato standardet, q  ne i kemi pasur standarde para statusit dhe tash jan  standarde pas statusit p r t i plot suar, me q llim q  t  krijojm  rrug  dhe mund si p r t u inkuadrua n  familjen e gjer  evropiane.

Por, kam nj  frik  se k shtu, si  jemi duke shkua, secil n her  kjo rrug  neve po na zgjatet. Prandaj, duke p rg zuar komisionin p r k t  pun  q  e ka b r , q   sht  nj  prej dokumenteve m  t  kompletuara q  i ofrohet k tij Kuvendi, ju sugjeroj q  t i angazhojn  edhe komisionet e tjera, sepse ka pun  p r t  gjitha komisionet brenda k tij plani t  veprimit, n  m nyr  q  ky t  begatohet edhe t  mund t  realizohet.

Ajo që e kam parë në këtë plan të veprimit është edhe një kontroll i rreptë në zbatimin e ligjit, prandaj nuk do të ishte keq që të mendohet për krijimin e një komisioni të përhershëm, të veçantë, për kontrollin e zbatimit të ligjit në Kosovë, duke pasur parasysh se komisionet edhe ashtu janë të angazhuara me veprime të tjera dhe sidomos i angazhon shumë ky plan i veprimit që tashmë është para nesh. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Myzejene Selamani.

MYZEJENE SELAMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritet për të gjithë deputetët dhe për ministrin që është prezent këtu.

Propozim-Rezoluta për prioritetet dhe strategjinë e Kosovës për integritet në Bashkimin Evropian dhe Planin e veprimit për sfidat e Raportit të progresit të komisionit për vitin 2008, mund të them se nga Komisioni për Integritet është punuar mirë, mirëpo gjatë punës së tyre të veprimit është bërë një përzierje, si e tha edhe zotëri Makolli, të kompetencave të komisioneve. që plani i punës, të gjitha komisioneve, gjë që diku shihet se janë dy komisione raportuese për një çështje. Mirëpo, duke marrë në përgjithësi, i gjithë plani i veprimit mund të përmirësohet ose mund t'i shtohen disa rregulla ku mund të ndryshojë, mirëpo rekomandimet apo, më mirë të themi, rikonfirmimet e zotimit të institucioneve të Republikës së Kosovës për përmbushjen e standardeve të kërkuara për integritet në Bashkimin Evropian, nuk di se sa do të mund të realizohen, kur pikë së pari çdo herë kritikë e tyre është zbatueshmëria e ligjit dhe mbërritja e standardeve Evropiane në të gjitha politika sektoriale. Do të jetë një punë e vështirë dhe në rast se nuk kemi raportim nga Qeveria brenda këtij Kuvendi, nuk mund të thuhet se Kuvendi nuk po punon, as komisionet parlamentare nuk po punojnë, në rast se nuk kemi raportim të Qeverisë brenda këtij Kuvendi si organ më i lartë. Duke e parë se ka humbur interesimi i deputetëve, atëherë po e përfundoj këtu. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Fjalën e ka kërkuar deputeti Gani Koci.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Pa dashur që të flas rreth Rezolutës që do të miratohet sot ose jo, unë do të ndalem pak te Planin e veprimit, por paraprakisht dua të them se që nga momenti i fillimit të përpilimit të Raportit të progresit për Kosovën, deri në momentin kur u ka ra në dorë institucioneve tona, por edhe Komisionit për Integritet, në këtë rast, ka kaluar një kohë shumë e gjatë dhe shumë nga ato sfida ndoshta që dalin nga ai raport, tashmë janë të tejkaluara.

Dhe, unë nuk do të ndalem se cilat janë ato, por do të shtroj një çështje, që ky plan i veprimit sot në këtë Kuvend të mos miratohet, mos të miratohet për shumë arsye. Nga arsyet e para janë ato që i ceku edhe zoti Bahri Hyseni këtu, por unë dua të flas për disa çështje që kanë të bëjnë me Komisionin e Buxhetit këtu, rreth disa ligjeve dhe rreth disa detyrave që Komisioni i Integritetit i jep Komisionit për Buxhet dhe unë mendoj që Komisioni për Integritet Evropian nuk është punëdhënësi, në këtë rast, por është në shërbim të Kuvendit dhe duhet t'i shërbej Kuvendit, jo t'i japë punë Kuvendit.

Në Plan të veprimit thuhet se Komisioni për Buxhet duhet të kërkojë nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave që çdo projektligj duhet të shoqërohet me deklaratën financiare. Në qoftë se ata që e kanë përpiluar Raportin e progresit mbi Kosovën nuk e kanë ditur, së paku njerëzit që janë në Komisionin për Integritet Evropian duhet ta dinë që edhe në Kornizën Kushtetuese, që është tash një dokument veç i tejkaluar, ka qenë se asnjë ligj në Kuvend nuk ka mund të shqyrtohet pa deklaratën financiare dhe, në këtë

rast, dua të them se ky komision fare ose anëtarët e këtij Komisioni nuk e kanë ditur këtë çështje dhe duhet ta mësojnë këtë çështje. Për të mësuar këtë çështje, unë i propozoj Kuvendit që Plani i veprimit të mos miratohet sot dhe rreth këtij Plani të veprimit të ftohen të gjithë subjektet relevantë të Kuvendit, në këtë rast edhe komisionet, po në një farë mënyre ky plan sikur i jep detyra edhe Qeverisë, edhe institucioneve tjera, që të ftohen edhe aktorët jashtë Kuvendit dhe vërtet të bëhet një Plan i veprimit për integritet evropian, duke pasur parasysh edhe realitetin çfarë e kemi në këtu. Po të shikohet ky plan në aspektin e buxhetit, kërkohet një fond tepër i madh dhe tepër i jashtëzakonshëm, andaj a do të ishte i përballueshëm për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës me këto kufizime që i kemi.

Prandaj, edhe në këtë drejtim planifikuesit është dashur ta kenë parasysh dhe të marrin sugjerimet edhe prej Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, edhe prej komisioneve tjera, edhe prej ministrive përkatëse, edhe prej agjencioneve të pavarura ose institucioneve të pavarura, siç është Ombduspersoni, që për të kërkohet një farë lloji autonomie financiare, që e ka atë autonomi financiare edhe mbi bazë të Ligjit për Ombduspersonin, edhe mbi bazë të Ligjit të buxhetit, edhe të Ligjit të menaxhimit të financave publike.

Prandaj, në përmbyllje të fjalës sime, thërras që të mos votohet Plani i veprimit sot këtu.

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Ismet Beqiri, e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Përshëndetje!

Zoti Kryetar, fillimisht edhe unë iu bashkëngjitëm atyre që e kanë përgëzuar komisionin për punën e bërë, tentimin për të bërë një punë të nevojshme dhe të domosdoshme. Megjithatë, më lejoni t'i them 2 – 3 vërejtje të miat, të cilat po thuaj se rezultatin do ta kenë në fund të kërkesës të ngjashme me zotin Koci.

Nëse e shikoni atë se çfarë thuhet në Raportin e progresit dhe çfarë kërkohet pastaj me Planin të veprimit, ka një disharmoni dhe një pamundësi. Në shumë vende shkruan që këto veprime duhet bënë nga iks komisioni në afatin e parë tremujor. Ne veç duhet ta dimë që 2 muaj shkuan dhe këto absolutisht mbesin vetëm letër sa për t'i bërë qejf veti që i kemi bërë.

Shikoni pikën, për shembull, kapitulli 2.2. që ka të bëjë me të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e minoriteteve, monitorimin e ligjeve për të drejtat e njeriut. Unë do të flas posaçërisht për disa pjesë që kanë të bëjë me Komisionin, në të cilën jam unë pjesë e këtij komisioni, të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore e tjera, është pak më gjatë, s'po e zgjati. Shikoni, për shembull, thuhet pika 36, Kuvendi, Qeveria dhe Shoqëria Civile kanë kapacitete të kufizuara për mbikëqyrje sa i përket promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, e në veçanti të drejtës në edukim, shëndetësi dhe punësim. Ndërkaq, shikoni tek veprimet e propozuara çfarë detyrash i jepen komisionit kur Qeveria dhe ne të tjerët ose këto që u përmendën nuk kanë kapacitete, ndërkaq kërkohet nga Komisioni ynë. në këtë rast për të Drejtat e Njeriut. të përgatis raport vjetor për respektimin e të drejtave njeriut. të gjitha ligjeve të miratuara nga Kuvendi. Shikoni, do me thënë, këndej nuk kanë kapacitete këto institucione, a ne i kemi ato kapacitete, që s'i kemi, tash po e them, e para.

E dyta, shikoni 37, pika tjetër menjëherë nën te, flitet për amendamentimet për Ligjin për Ombduspersonin, ndërkaq i jepet detyrë komisionit të bëjë rekomandime për diçka që realisht nuk ka, ligj për ombduspersonin, e ne nuk po mundemi as ta zgjedhim vetë Ombduspersonin.

Të njëjtat vërejtje i kam ose afërisht të ngjashme lidhur me pikën 42, 43, 48, ne mes asaj se çka parashihet ose çka kërkohet dhe mundësitë e veprimit.

Unë e them me përgjithësi që, duke dëshiruar që kjo rezolutë të dalë edhe të ketë efekte, ashtu siç e dëshiron edhe vetë komisioni propozues, megjithatë unë jam skeptik që në këtë formë, nëse nuk bëhet harmonizimi i Planit të veprimit, besa edhe e asaj se çka ka secili komision në mandat, e shoh këtu edhe në disa vende përmendet hartimi i strategjisë, nuk është punë e komisionit të bëjë strategji, po është e tjetërkujt. E Komisionit, në këtë rast për të Drejtat e Njeriut, është të mbikëqyrë punën dhe zbatimin ose respektimin e të drejtave të njeriut. Në shumë vende e keni, thotë të monitorohen po thuaj se të gjitha ligjet, a është ky kapacitet.

Për përfundim, për të mos e zgjatur më tutje, si nevojë ekziston të kemi rezolutë, por megjithatë edhe unë propozoj që kjo rezolutë të shtyhet për seancë tjetër me qëllim të harmonizimit, posaçërisht të harmonizimit të veprimeve praktike ose të planit të veprimit, saktë çka kush duhet të bëjë, mendoj tek secili komision, saktë dhe qartë afati kohor, nevojat dhe mundësitë e komisioneve, kapacitetet e secilit komision e tjera. Takime këto që do të duhej të bëheshin me të gjithë kryetarët e komisioneve me qëllim të harmonizimit dhe të precizimit, po e them edhe një herë, veçmas të Planit të veprimit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Konsideroj që debati është harxhuar. Megjithatë, kemi kërkesën për të mos e miratuar Rezolutën.

(Konsultime)

Ju do të kishit bërë mirë të mos përziheni shumë. Ne ju kemi dëgjuar deri tash, tash unë jam duke drejtuar seancën dhe duhet të mësoheni në këtë aspekt. Pasi janë ndarë deputetët në dy çështje, unë kisha kërkuar që shefat e grupeve parlamentare të prononcohen për këtë çështje. Mirë, atëherë shkojmë në votim.

Lus deputetë dhe regjinë të përgatiten për votim, votojmë tash:

Konstatohet se me 38 vota “për”, 4 “kundër” dhe 12 abstenime, miratohet Rezoluta.

Ju lutem, deputetë, mësohuni të votoni, dhe asnjë fjalë nuk e dua. E keni ditur që është procedura e votimit.

Pika e tetë e rendit të ditës:

Asnjë fjalë, votimi është kryer, e kemi pikën e tetë të rendit të ditës:

- Raporti i Trustit të Kursimeve Pensionale për tremujorin e katërt të vitit 2008

Komisioni Parlamentar për Buxhet e Financa ka shqyrtuar raportin e Trustit të Kursimeve Pensionale për 3 mujorin e katërt të vitit 2008 dhe ka rekomanduar për shqyrtim në seancën plenare.

Raporti i Komisionit së bashku me Raportin e Trustit të Kursimeve Pensionale për tremujorin e katërt të vitit 2008 u është shpërndarë deputetëve.

Ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, zotin Gani Koci, që në emër të Komisionit para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Raportin me rekomandime.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryetar!

Komisionit për Buxhet dhe Financa në fund të muajit janar i ka ardhur raporti tremujor i Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës. Po themi raport, sepse këto janë vetëm 3 – 4 tabela, dhe ne si Komision ndoshta kemi bërë një gabim këtu në rekomandimin e parë që kemi thënë miratohet, ne se kemi miratuar këtë raport, ne e kemi shqyrtuar këtë raport të Trustit pensional dhe i kemi rekomanduar Kuvendi që atë ta radhis në një seancë plenare. Së bashku me këtë raport ne kemi rekomanduar që të jetë edhe guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës që drejtpërdrejt t'i paraqitet Kuvendit lidhur me raportin tremujor.

Nuk di a është kuptuar drejt kjo çështje e thirrjes së guvernatorit që të raportojë lidhur me Trustin pensional, por ne jemi thirr edhe në bazë të Ligjit mbi Trustin e Kursimeve Pensionale, ku guvernatori ka një përgjegjësi në rastin kur në çfarëdo mënyre Trusti pëson ose ka pësuar humbje në shkallën e caktuar. Ne jemi të njohur tashmë me gjendjen e Trustit pensional në mungesë të bordit, dhe mungesa e bordit që nga shtatori i vitit të kaluar e këtij institucioni aq më tepër e detyron guvernatorin që të ishte këtu prezent.

Ne kemi kërkuar nga Trusti që të na bëjnë raport, siç duhet të raportohet, por ata thirren në atë, sepse kjo është një formë, një model i imponuar nga Banka Qendrore dhe nuk kanë format tjetër përpos këtij formati të raportimit. Ne në Komision edhe më herët kemi kërkuar që së paku, përpos pjesëve tabelare, të ketë edhe shpjegime lidhur me tabelat dhe me numrat që janë në këto tabela, por ajo çka është më e rëndësishmja, se në tremujorin e fundit të vitit 2008 vlera e aseteve të Trustit pensional ka rënë shumë dhe po të shndërohet kjo në para, është diku rreth 41.000.000. Ndërsa, për gjithë vitin 2008 vlera e aksioneve të Trustit Pensional të Kosovës është diku 29%, që është shumë shqetësuese dhe deri më tani nuk kemi asnjë veprim as të Trustit pensional lidhur me gjendjen, as të guvernatorit të Bankës Qendrore të Kosovës.

Para pakë ditësh kemi marrë edhe raportin vjetor të këtij Trusti, po kështu është i njëjti format dhe nuk di a mund t'i deshifrojmë këto shifra që na i kanë dhënë këtu, prandaj le të mbetet që Kuvendi të vendos se çka dhe si duhet vepruar lidhur me Trustin. Komisioni ka ardhur në një përfundim se vërtet do të duhej nisur fillimi i ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit mbi kursimet pensionale, në këtë rast lidhur me Trustin Pensional të Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Bordi i Trustit ose Trusti ka për obligim të raportojë njëherë në vit para Kuvendit. Pasi këtu kemi një raport të tremujorit dhe ka ardhur raporti njëvjeçar i Trustit, unë kisha propozuar që kjo pikë e rendit të ditës të shqyrtohet pasi Komisioni për Buxhet dhe Financa ta sjellë raportin me rekomandime, raportin njëvjeçar të Trustit. Le të deklarohen atëherë shefat e grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Safete Hadergjonaj.

SAFETE HADERGJONAJ: Zoti Kryetar,

Faktikisht nuk kemi raport në shqyrtim, e kemi një pasqyrë të mjeteve për tremujorin e katërt. Meqenëse kryetari i Komisionit deklaroi që raporti vjetor ka mbërri dhe neni 6.3 i Ligjit e parasheh që raporti t'i dorëzohet Kuvendit dhe të shqyrtohet në Kuvend, ndoshta sot ne mund të bëjmë lojë fjalësh në këtë debat në lidhje me këtë raport tremujorë, mirëpo nuk i kemi personat kompetent që mund të na japin ndonjë përgjigje, me qenë se nuk është as guvernatori i bankës, kështu që ne mendojmë që brenda një periudhe shumë të shkurtër kohore raporti vjetor do të jetë në Kuvend dhe atëherë ia vlen të bëhet një debat më i gjerë në lidhje me këtë çështje. Kështu që do të shpenzojmë kot fjalë sot, por diçka nuk mund të arrijmë në bazë të këtij debati, andaj mendoj që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës dhe kur të kemi në shqyrtim shumë shpejt raporti vjetor, atëherë të hapet debati në lidhje me Trustin.

KRYETARI: Faleminderit!

Lutfi Haziri, në emër të Lidhjes Demokratike. Haki Shatri.

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike mendon që është me rëndësi të debatohet sot, jo për shkak të natyrës së raportit që është tremujor, siç e thatë edhe ju, po për një arsye krejt të veçantë. Humbjet e Trustit vazhdojnë me dinamikën që ka filluar në vitin 2008 dhe çdo vonesë në shqyrtim iu kushton brenda muajit 10.000.000 euro kursimtarëve pensionistë. Në qoftë se e presim raportin vjetor, zoti Kryetar, raporti duhet të vijë mbas një muaji. Deri të kryhen procedurat në shqyrtim, në Kuvend, në diskutim, do të kemi 2 muaj dhe do t'iu kushtojë 16.000.000 deri 20.000.000 euro kursimtarëve të Kosovës. Prandaj, rekomandimi ynë është që sot ta diskutojmë këtë çështje, të thërrasim në përgjegjësi personat kompetentë, të cilët në bazë të Ligjit për Trustin e Kursimeve kanë pasur nevojë, kanë pasur obligim të marrin vendime, të ndërpresin humbjet në Trust. Humbjet nuk kanë filluar në ditët e fundit të vitit 2008, por në fillim të shtatorit dhe humbjet gjithsej, sipas të dhënave edhe për këtë vit, arrijnë rreth 120.000.000 euro. Në qoftë se ne e bëjmë veshin e shurdhër dhe presim formalitete, do të rritet kjo shumë e humbjeve. Ne kërkojmë që personat kompetentë të vinë në Kuvend, është dashur sot të jenë, siç ka rekomanduar Komisioni për Buxhet, dhe ata të përgjigjen para Kuvendit dhe qytetarëve të Kosovës për humbjet që janë krijuar dhe për mosveprimet e tyre të cilat kanë qenë të obliguar në bazë të ligjit t'i ndërmarrin. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Veç nuk na the, me fjalë tona a ndërpriten humbjet. Mirë, faleminderit! Vazhdojmë. Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Ibrahim Makolli, e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë,

Ne kemi këtu para vetes, prej njerëzve që, seriozisht, po që se i shikojmë këto letra, nuk e meritojnë të jenë në krye të këtij institucioni, ku thuhet që ofrojnë raportin tremujor, për tremujorin e katërt të vitit 2008, ndërsa ne para vetes 2 letra të cilat askush, as ata që i kanë punuar nuk e kuptojnë çka janë, absolutisht, dhe si duket, dikujt po i intereson që kjo gjendje të zvarritet edhe më tutje.

Zoti Kryetar,

Disa herë ne e kemi shtyrë çështjen e debatit për Trustin Pensional të Kosovës. Me të vërtetë, tashmë ky Trust është shndërruar në një trustore të madhe për qytetarët e Kosovës, ajo që për çdo ditë e thonë ata të cilët kanë të kursyera në këtë organ. Ajo që do të duhej të ndodhë, është që të ftohet guvernatori i Bankës së Kosovës këtu, të japë

përgjegjësi për këtë gjendje të krijuar, sikurse që edhe Kuvendi i Kosovës duhet të ndërmarrë masa ndaj të gjitha atyre që abuzojnë, thjeshtë, ky për mua është abuzim, të nderuar kolegë, abuzim të atyre të cilët i kanë dhënë vetes të drejtë që të luajnë me fatinë tonë. Ata që e kanë prurë sot këtë dokument, ku thuhet që është një raport, ata me të vërtetë as vetë nuk e dinë se çka është raporti dhe, sipas të gjitha gjasave, ata po donë ta vënë në lojë edhe këtë Kuvend, sepse kështu duke na ofruar, po na detyrojnë që të zvarrisim debatin dhe pastaj humbjet janë ato që janë. Para disa ditësh, ju e dini që kemi diku rreth 100.000.000 ose më tepër se 100.000.000 humbje të këtij fondi, të cilat po të investoheshin në sektorë të ndryshëm në Kosovë, gjendja do të ishte krejt ndryshe.

Seriozisht e them se institucioni më i lartë i vendit, që është Kuvendi i Kosovës, duhet të debatojë dhe duhet të ndërmarrë masa ndaj të gjithë atyre që japin vetes të drejtë të luajnë me fatin e kursimeve të kursimtarëve tanë.

Ne, si Grup Parlamentarë, natyrisht, nuk jemi për ta debatuar sot në këtë formë kështu, sepse s'kemi për çka të debatojmë, por jemi për atë që në një mbledhje ndoshta, pse jo, edhe të jashtëzakonshme të Kuvendit të Kosovës, të ftohet guvernatori i Bankës dhe të paraqet raport të hollësishëm për gjendjen në këtë Trust, sikurse edhe të japë përgjegjësi para institucioneve të vendit. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të AAK-së deputeti Ardian Gjini, e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Para se të filloj të flas, sa isha duke i dëgjuar deputetët, paraprakisht një pyetje esenciale lind dhe mendoj se shpesh lind në Kuvendin e Kosovës dhe nuk e di sa herë kemi pyetur ne, çka ka ndodhur në mbledhjen e fundit të Komisionit për Buxhet e Financa, kur është mbajtur mbledhja e fundit dhe çka është diskutuar në atë mbledhje? Qysh ka mundur Komisioni për Buxhet dhe Financa para 2 ose 3 dite të na rekomandojë shqyrtimin e këtij raporti, e keni rekomandimin e Komisionit, edhe sot të na thuhet, jo mos të shqyrtohet, se janë vetëm disa tabela. Pse nuk iu ka rënë në mend në mbledhje të Komisionit, të thonë janë vetëm disa tabela dhe nuk po e shqyrtojmë, pse është dashur të silllet në seancë plenare, të vendos Kryesia e Kuvendit bashkë me ju, zoti Kryetar, e me kryetar të grupeve parlamentare, të gjithë bashkë, e sot në mbledhje, në seancë plenare të na thuhet se nuk është mirë të diskutohet. Kjo nuk është hera e parë, kjo është hera e 20 që i ndodh kësaj legjislature.

Tani, shikoni se çka ndodh. Disa shifra të cilat nëpër këto tabela të çuditshme, do me thënë mund të dalin janë këto: humbja e tërësishme është 112.000.000 euro të Trustit. Vetëm në tremujorin e fundit ka pasur 42 milion euro humbje në Trustin pensional, edhe mjetet tona edhe të popullit të Kosovës janë aty. Gjatë vitit 2008 llogaritet diku 29.5% të vlerës totale Trusti ka humbur. E çka ndodh tash. Komisioni për Buxhet dhe Financa e shqyrton, nuk e dinë as çka ka shqyrtuar, e kalon, na rekomandon të diskutojmë dhe vjen këtu edhe e akuzon guvernatorin e Bankës Qendrore. Këqyrni kush është prej Qeverisë mbrapa meje, a është dikush. Kur jemi duke folur për 100.000.000 euro humbje, gati 30% humbje të Trustit pensional, askush nuk është, asnjë njeri. Është ministri i Shëndetësisë që s'ka lidhje me këtë punë.

Tani, çështja është kështu. Pse ka ndodhur kështu? Komisioni nuk na jep asnjë fjalë, ka drejtë të shënojë në raport, pse kemi ardhur deri në këtë situatë, nuk na jep. A ka pasur mundësi të parandalohet kjo humbje, asnjë fjalë, asnjë mendim, as i Komisionit, as i Trustit, as i Qeverisë, as i kujtdo qoftë. Nëse nuk kemi pasur mundësi t'i parandalojmë

humbjet, çka mund të bëjmë tani, a ka ndonjë zgjidhje, apo duhet të rekomandojë Komisioni dhe të hiqet prej rendit të ditës. Pra, çka duhet bërë, a ka institucione që e ndiejnë një pikë të vogël të përgjegjësisë për çka po ndodh, apo s'ka hiq. Në fund të fundit, guvernatorin e Bankës vetë e kemi emëruar, sot nuk vjen, po nuk është as Qeveria, nuk është as ministri i Financave, asnjë zëvendëskryeministër, kryeministri nuk është këtu, krejt në rregull. E, në fund të fundit, ne si përfaqësues të popullit, edhe populli duhet të dijë kush i ka fajet që nuk po ndalet humbja. Po e kuptojmë krizën globale financiare, po kriza globale financiare që një vit po vazhdon edhe që një vit po vazhdojnë humbje. Pse nuk po emërohet Bordi i Trustit, pse dy partitë në pushtet nuk kanë mbërritur që një vit ta emërojnë Bordin e Trustit dhe kanë lejuar t'i kemi 112.000.000 euro humbje të kursimeve të njerëzve për pensionet e veta. Kjo situatë që e kemi sot na bën që Komisioni njëherë të thotë po, njëherë jo dhe të frikohet të dalin deputetët para foltores dhe të thonë, shikoni se është një katastrofë e madhe që po ndodh me ne, se nuk jemi në gjendje as të emërojmë Bordin e Trustit, se nuk jemi në gjendje as ta thërrasim guvernatorin e bankës këtu, ndoshta as nuk ka ftesë për të ardhur, se ai pa ftesë nuk vjen, se sikur të kishte pasur ftesën, nuk kish pas qare pa ardhur. Pse nuk e kemi asnjë njeri të Qeverisë këtu që e di që kemi për të diskutuar për Trustin e Pensioneve dhe nuk e ka parë të rëndësishme të jetë këtu hiq, edhe nuk kanë mbledhje të Qeverisë, e dimë që s'kanë sot mbledhje të Qeverisë, edhe kjo është ajo çka na ndodh neve si Kosovë, edhe ky është serioziteti me të cilin njerëzit që janë të thirrur, që pretendojnë që e kanë marrë shumicën e votave të popullit të Kosovës, kjo është mënyra se si i qasen këtij problemi.

Ne si Grup Parlamentar mendojmë se me vetë propozimin e Kryetarit të Komisionit për Buxhet edhe Financa është degraduar esenca e diskutimit, që ka pasur të ndodh sot. Mendojmë se kjo është çoroditje e punës së Kuvendit, edhe e punës së komisioneve të Kuvendit, të cilët për 2 ditë nuk e dinë as çka kanë bërë, për 48 orë e humbin sensin total të punës së vet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Ardian, ti e di që Kryesia nuk merr vendim të sjellë diçka, ose të heq prej rendit të ditës. Ne e kemi pasur një rekomandim të një komisioni dhe e kemi kryer detyrën tonë dhe e kemi sjellë këtu. Ka qenë mirë vërtet të përgjigjesh në emër të Grupit Parlamentar dhe jo të na mbash ligjëratë.

Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar, deputeti Lulzim Zeneli, Berim Ramosaj e ka fjalën.

BERIM RAMOSAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Sa i përket arsyes së diskutimit për këtë pikë të rendit të ditës, Lidhja Demokratike e Dardanisë është vërtet e zhgënjyer me një raport të tillë që, në fakt, nuk është raport i plotë as për një, tremujorësh, as për një njëmuorësh, por është faktikisht pasqyra e aseteve të blerjes dhe shitjes së Trustit, që mund t'i vëreni në faqen 2 dhe 3. Në fakt, ekspertët më të mirë të fushës së financave nuk mund të krijojnë një pasqyrë të mjaftueshme se çfarë gjendje është e Trustit me këto 3 faqe, e lëre më deputetët, të cilët janë të profesioneve të ndryshme, të veprimeve të ndryshme, të institucioneve që kanë ardhur, të grupit të qytetarëve, që nuk është e mundur të bisedojnë për këto letra. Ajo çka është e rëndësishme të them tani, është se gjendja në Trustin Pensional të Kosovës është e nivelit të tillë emergjentë, që pa marrë parasysh a kemi raport apo nuk kemi raport, ne është dashur të diskutojmë, kurse sa i përket Raportit, unë e mbështes atë çka thotë Komisioni se vërtet nuk paska pasur raport, mirëpo si ka ardhur në përfundim Komisioni derisa nuk ka pasur raport me këto rekomandime? Bile, na sugjeron në pikën e parë,

thotë të miratohet në parim raporti. Kjo bie në kundërshtim me deklarin e kryetarit të Komisionit, tani.

Ne, si Lidhje Demokratike e Dardanisë, jemi për shqyrtimin e gjendjes së Trustit Pensional të Kosovës, qoftë me raport, qoftë pa raport, duke marrë parasysh pozitën e Trustit Pensional të Kosovës në aspektin e rënies së vlerës, respektivisht të humbjes së mjeteve nga investimet apo nga plasimi i kapitalit që e ka bërë në vende të ndryshme. Ndërsa, sa i përket mënyrës së plasimit, që u tha këtu, ajo është e rregulluar me ligj, me dokumente, në fakt me Rregulloren të UNMIK-ut, mirëpo derisa ky Kuvend nuk ka arritur të nxjerrë një bord të Trustit, faktikisht, raportin në si Kuvend duhet ta marrim nga Bordi, sepse menaxhmenti i Trustit i jep raport Bordit e Bordi është i përbërë prej një strukture të tillë që, në fakt, shqyrton menaxhimin e suksesshëm ose të pasuksesshëm të Trustit. Ne është dashur të marrim raport nga Bordi. Hajde, nuk e paskemi Bordin, është e rregulluar me ligj se kush jep përgjegjësi, kush ka të drejtë më shumë që të merret me këtë fushë.

Drejtori menaxhues i BPK-së, është dashur, në qoftë se është thirrur nga ky Kuvend, prapë po them, në qoftë se është thirrur nga ky Kuvend, është dashur bile qytetarëve, respektivisht deputetëve të Parlamentit të Kosovës t'u japë një pasqyrë më të përafërt për gjendjen në Trust.

Unë jam mjaft i vetëdijshëm se diskutimet tona nuk mund t'i ndalin humbjet e Trustit, ajo është e vërtetë, mirëpo nëse nisemi nga kjo qasje, në atëherë nuk duhet të diskutojmë fare për asnjë çështje, duke marrë parasysh fuqinë e këtij Parlamenti. Arsyeja e gjendjes ekzistuese emergjente të Trustit është të diskutohet për Trustin Pensional të Kosovës sot. Andaj, ne jemi të diskutojmë për gjendjen e Trustit Pensional të Kosovës, që nuk do të thotë të mbështetemi në këtë raport kaq të mangët. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit "7+", deputetja Myfera Shinik.

MUFERA SHINIK: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

MUFERA SHINIK: Ju faleminderit, zotëri Kryetar!

7+ Parlamentar Grubu olarak gündemdeki 8. noktanın 8. gündemden çekilmesini, yani emeklilik trustuyla ilgili raporun bir yıllık rapor olarak Bütçe Komisyonundan Meclise gönderildikten sonra görüşülmesini öneriyoruz.

Teşekkür ederim!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, Bojan Stojanović e ka fjalën!

BOJAN STOJANOVIĆ: Gospodine predsjedniče,
Uvažene kolege poslanici,

Mi čemo podržati odlaganje ove teme za neki drugi put. Mi jesmo za raspravu, ne samo o ovome, nego o svim pitanjima koja će doneti dobro građanima, ali nismo samo za raspravu radi rasprave, ne vidim šta bih danas nešto posebno rešili raspravom, mislim da trebamo dati još malo vremena da bi se izvršile konsultacije između Skupštinske komisije, Skupštine, možda Vlade i da se pozovu odgovarajući ljudi, to je direktor Narodne banke, kao što sam čuo, i ljudi iz Trusta, da se napravi možda i dogovor oko

imenovanja Borda, pa nakon toga da uzmemo jednu ozbiljnu debatu kako bi nešto rešili. Hvala!

KRYETARI: Në emër të Grupit parlamentar “Zajedno”, deputeti Branislav Grbiq e ka fjalën.

BRANISLAV GRBIĆ: Uvaženi predsedavajući, Poštovani ministre, Dame i gospodo, narodni poslanici, Poslanička grupa „Zajedno“ sigurno je zainteresovana da se ovaj problem pred ovu Skupštinu, i u tom kontekstu sigurno u rešavanju činjenica koja će dati jedno punovažno obazloženje celog ovog procesa, znači rešavanje problema u Trust, znači mi smo u principu za odlaganje ove teme i da u narednoj, znači sledećoj sednici imamo više tih podataka i mogućnosti da možemo da na jedan konstruktivan način damo svoje mišljenje. Hvala!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Gani Koci.

GANI KOCI: Ju Faleminderit, zoti Kryetar! Për hir që të jemi shumë korrekt, unë kisha kërkuar nga Administrata e Kuvendit që të përgatisë Transkriptin e mbledhjes së Komisionit të datës 2 shkurt të këtij viti dhe t’ua shpërndajë të gjithë deputetëve, në këtë rast edhe Ardian Gjinit dhe të kuptojë në esencë se çka është diskutuar në Komision dhe cila ka qenë arsyeja që Komisioni ka marrë një vendim të tillë, që edhe pse këto dy letra me numra dhe asgjë tjetër të vendosen në Kuvend sot për diskutim. Pra, ishte një kërkesë që të shtyhet për shkak të asaj që ka ardhur raporti vjetor, që është një rast shumë më i mirë që diskutohet dhe meqë mungon ai që do të duhej të ishte përgjegjës në mungesë të Bordit të Trustit, ishte një kërkesë që të jemi pak më racional dhe brenda pak kohe të mos të flasim dy herë për të njëjtën çështje. Por Komisionit dhe as mua personalisht nuk na prish punë që ne të flasim sot këtu, sepse edhe ideja e Komisionit ka qenë që të flitet, ndoshta, për Trustin dhe jo për raportin, sepse nuk kemi raport. Këtë e kemi thënë edhe në Komision, ndërsa sa i përket përgjegjësisë edhe të menaxhmentit aktual, tash të drejtorëve menaxhues të Bordit, këta vërtet i bëjnë vetëm këta formularë dhe Raportin e bën Bordi. Bordi nuk është dhe Bordi duhet ta miratojë atë raport dhe ta adresojë në Kuvend.

Meqë nuk është dhe gjendja është e tillë çfarë është, megjithatë përgjegjësia duhet të adresohet. Unë, që të jem korrekt në atë që u përmend shumë se po apostrofohet guvernatori, neni 24 i Ligjit për Trustin Pensional të Kosovës, i miratuar në qershor të vitit të kaluar, ky nen që ndryshon Rregullën 34.2 të Rregullores të UNMIK-ut për Trustin, thotë se, në qoftë se Banka Qendrore e Kosovës konstaton se ekziston rrezik i madh nga humbja e menjëhershme e një pjese të madhe të mjeteve të Fondit Pensional, që tejkalojnë 10% të shumës së përgjithshme të mjeteve, në mënyrë që të krijojë një gjendje të mundshme emergjente, BQK-ja menjëherë mund të ndërmarrë veprimet e parapara me nenin 34.1, pika a, b, c e tjera për të ndaluar humbjen e mjeteve të Fondit Pensional. Veprimi i tillë duhet kufizuar në 30 ditë, gjatë të cilave BQK-ja duhet të njoftojë Kuvendin dhe Qeverinë me shkrim për mënyrën e emergjencës që ka të bëjë me Trustin Pensional, në këtë rast.

Ky ka qenë fakti që ne kemi ftuar, në mungesë të Bordit, guvernatorin e Bankës Qendrore që të raportojë për këtë çështje.

Ne sot nuk e kemi guvernatorin këtu. Ne mund të flasim për opinionin dhe prapë Komisioni do të kërkojë gjatë shqyrtimit të Raportit njëvjeçar që të jetë prezent guvernatori këtu. Nuk besoj që ndoshta do të vijë edhe atëherë.

KRYETARI: Urdhëro, Ardian Gjini e ka fjalën! Replikë 1 minutë.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Rekomandimin po e lexoj. Pika 1 e rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa: Miratohet në parim Raporti i Trustit të Kursimeve Pensionale. Pika 1, s'po vazhdoj më tej.

Pika 2: Obligohet guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës që të ndërmarrë masa adekuate lidhur me administrimin dhe udhëheqjen e Trustit.

Pika 3: I rekomandohet Qeverisë së Kosovës që të përshpejtojë procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Trustit të Kursimeve, nënshkrimi Gani Koci, kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa, data e mbledhjes 2 shkurt, data kur na e kemi marrë në kutitë tona, 23 shkurt. Ju faleminderit!

KRYETARI: Kemi nga Komisioni kërkesën për t'u shtyrë për shkak të Raportit njëvjeçar. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

(Ndërhyrje)

KRYETARI: Ajo është punë e imja. Konstatoj se më 38 vota "për", 20 "kundër", 5 abstenime, Kuvendi miraton shtyrjen e Raportit të Trustit të Kursimeve Pensionale për tremujorin e katërt të vitit 2008. Ju faleminderit!

Pika e nëntë e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i Projekt-Strategjisë kundër korrupsionit për periudhën 2009-2011

Qeveria e Republikës së Kosovës e ka proceduar për shqyrtim dhe miratim në Kuvend Projekt-Strategjinë kundër korrupsionit për periudhën 2009-2011.

Komisionet parlamentare: Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, e kanë shqyrtuar Projekt-Strategjinë kundër korrupsionit për periudhën 2009-2011 dhe e kanë paraqitur Raportin me rekomandime.

Raportet e komisioneve, së bashku me Projekt-Strategjinë kundër korrupsionit për periudhën 2009-2011, u janë shpërndarë deputetëve.

Regjia, le t'i shtyjë kandidatët e paraqitur për pikën e kaluar, tash jemi në pikën e re të rendit të ditës.

A e do fjalën Kryetari i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, zoti Bahri Hyseni? Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni!

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi e ka shqyrtuar Projekt-Strategjinë kundër korrupsionit për vitin 2009-2011 dhe, duke pasur parasysh rëndësinë që e ka kjo strategji për të luftuar një dukuri negative, për të cilën dukuri flasin edhe raportet e faktorit ndërkombëtar dhe sidomos Raporti i fundit i Komisionit Evropian, që kjo dukuri është e evidente në institucionet e Kosovës, por jo vetëm në institucionet e Kosovës, por edhe në ndërmarrjet publike në Kosovë, e ka shqyrtuar me vëmendje Projekt-Strategjinë për vitin 2009-2011 dhe konsideron se ky dokument që u është ofruar deputetëve të Kuvendit të Kosovës për ta votuar, i plotëson të gjitha kriteret.

Duke pasur parasysh që Kosova nuk e ka, për herë të parë nuk e kanë hartuar institucionet e Kosovës këtë strategji, por strategji kundër korrupsionit kemi pasur edhe në vitin 2004-2007, strategji e cila ka qenë më tepër e përcaktuar për të nxjerrë apo për të kompletuar infrastrukturën ligjore për të luftuar këtë dukuri negative, konsiderojmë se Strategjia e vitit 2009-2011 i ka 5 kapituj dhe kapitujt në përgjithësi përmbajnë: parimet, objektivat, institucionet, marrëveshjen ndërkombëtare dhe, në fund, implementimin në praktikë të kësaj strategjie. Prandaj, konsiderojmë që Agjencioni Kosovar Kundër Korrupsionit e ka hartuar një strategji e cila i plotëson të gjitha kriteret dhe shpresojmë se me gatishmërinë e institucioneve të cilat janë përfshirë në këtë dokument, do ta luftojmë këtë dukuri negative.

Shpresojmë se kjo strategji nuk do të mbetet vetëm në letër, mirëpo me një angazhim të të gjithë mekanizmave dhe sidomos të Agjencionit Antikorrupsion, do ta zbatojmë në praktikë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! A e more fjalën edhe në emër të Grupit Parlamentar? Mirë. Ju faleminderit.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, a e do fjalën? Jo!

Komisioni për Punë të Brendshme, kryetari a e do fjalën? Fjalën e ka deputeti Rrustem Mustafa.

RRUSTEM MUSTAFA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Meqenëse, siç thuhet, Strategjia përbën dokument politikash dhe aprovohet nga Kuvendi, është e udhës që edhe Plan i veprimit të aprovohet nga Kuvendi, me qëllim që këtij plani t'i jepet fuqi ligjore më të madhe dhe të krijojë obligime për të gjitha institucionet, të gjitha nivelet.

Me këtë Kuvendi do të njoftojë edhe për masat që parashihen në Planin e veprimit dhe do të ushtronte ndikim të drejtpërdrejtë në përmbajtjen e Planit të veprimit.

Agjencioni nuk ka mandat të aprovojë një plan të tillë. Këtë duhet ta bëjë Kuvendi si organ më i lartë i përcaktimit të politikave shtetërore, ndërsa Agjencioni duhet të bëjë mbikëqyrjen e zbatimit të tij dhe t'i raportojë Kuvendit për nivelin e këtij zbatimi.

Agjencioni nuk mund të krijojë politika antikorrupsion, por t'i zbatojë politikat antikorrupsion që i përcakton Kuvendi i Kosovës, me aktet konkrete, siç është Strategjia dhe Plan i veprimit antikorrupsion.

Projekt-Strategjia është një dokument shumë përshkrues, nga 16 faqe sa ka, gjithsej gjysma, domethënë 8 faqe përbëjnë parime përshkruese dhe vështirë. Vetëm 8 prej tyre janë objektiva të përgjithshme dhe specifike. Nuk është bërë një studim paraprak për nevojat dhe sektorët prioritarë në të cilët ka nivel të korrupsionit më të lartë ndaj të cilëve kërkohet një fokusim më i madh.

Ky Projekt-Strategji në faqen 4 kritikon strategjinë e mëparshme antikorupsion për qasje të përgjithshme, ndërsa vetë rrezikon të bëjë të njëjtin gabim strategjik, duke mos u fokusuar në sektorët më të ndjeshëm të cilët dyshohet se ka më së shumti korrupsion.

Puna përgatitore e Projekt-Strategjisë ka ecur shumë ngadalë dhe nuk është marrë për bazë fakti se Kosova nuk ka pasur strategji në fuqi, meqë ajo e mëparshmeja ka skaduar së bashku me Planin e veprimit në vitin 2007.

Objektivat e përcaktuara në Projekt-Strategji shpeshherë janë shumë të përgjithësuar dhe të paqarta, nganjëherë nuk janë në sektorin e duhur, ka një ngatërrim në definimin dhe përcaktimin e tyre.

Projekt-Strategjia nuk ka definuar fare rolin e Qeverisë në luftimin e korrupsionit. Qeveria ka mandatin e përgjithshëm politik nga zgjedhjet dhe në këtë kuadër edhe mandatin politik për luftimin e korrupsionit. Për këtë arsye, roli i saj duhet të shprehet qartë në Projekt-Strategji. Duhet të ketë një bashkëveprim mes Agjensionit Antikorupsion dhe Qeverisë së Kosovës në këtë proces kundër përgjegjësive të secilit institucion.

Gjuha e përdorur në këtë dokument nuk është shumë e saktë, shpeshherë konfuze dhe e përgjithësuar. Ne në Komision jemi pajtuar që në parim ta mbështesim, mirëpo duke u përpjekur që ta lusim Kuvendin e Kosovës, që brenda mandatit sa do të jetë ky plan në Komision, të vijë edhe Plani i veprimit që bashkë me të t'ri miratojmë të dyja bashkë dhe komentet specifike do t'i dorëzojmë në komisionin funksional. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Radha është e kryetarëve të grupeve. Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike kush e do fjalën? Jo, Partia Demokratike e kreu, bile ishin dy qëndrime. Tash vjen deputeti i Lidhjes Demokratike, Haki Shatri e ka fjalën.

HAKI SHATRI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike kemi këtë vlerësim lidhur me materialin që po e diskutojmë.

Nevoja për hartimin e një strategjie antikorupsion ekziston për arsye se strategjia për periudhën e kaluar, periudha ka përfunduar në vitin 2007, aktualisht institucionet kosovare nuk e kanë një dokument për strategjinë e luftimit të korrupsionit në institucionet e Kosovës.

E dyta, kërkesa nga strukturat ndërkombëtare që na monitorojnë dhe mbështesin, ekziston për një veprim konkret të luftës kundër korrupsionit dhe ajo që është më me rëndësi, është nevoja praktike për ta luftuar korrupsionin. Konkretisht, do ta them, diçka një digresion nga tema, por që lidhet me temën. Vetë, po në temë do të jem edhe në emër të Grupit jam duke folur, zoti Kryetar, vetë neglizhimi i diskutimit për Trustin e

Pensioneve nënkupton që ka diçka që dëshirojmë t'i ikim një teme e cila rrezikon mjetet e qytetarëve të Kosovës, që lidhet me një lloj korrupsioni për të cilin ne...

KRYETARI: Ju lutem, ju lutem në fjalë, atë temë e votoi Kuvendi dhe shkoi. Fol për temën në të cilën jemi në rend dite!

HAKI SHATRI: ...Jam në temë për çështjen e antikorruptionit, zoti Kryetar. Unë po e përmend një shembull si nevojë për të parë strategjinë, por Grupi Parlamentar i LDK-së, konsideron se ky dokument, pa masat e veprimit, është dokument i shprehjes së dëshirave dhe kërkojmë që t'i kthehet hartuesit dhe t'i bashkëngjiten masat e veprimit, sepse është, prej pasnesër fillon muaji i tretë i këtij viti dhe periudha të cilën e mbulon ky plan strategjik i luftës kundër korrupsionit, kurse masat nuk i kemi. Prandaj, kërkojmë që dokumenti t'i kthehet propozuesit, t'i bashkëngjiten masat e veprimit dhe të vijë në Kuvend që ta miratojmë. Ka nevojë dhe është shumë urgjente, do ta mbështesim, por me masat e veprimit. Dhe, e fundit që vlen të përmendet, hartuesi i këtij dokumenti në veprimtarinë e vet nuk e ka përmendur Këshillin Antikorruption, i cili është organ mbikëqyrës i Agjencionit Antikorruption dhe i cili nuk e respekton Këshillin si organ ligjor dhe në dokument nuk përmendet fare.

Këshilli është organ mbikëqyrës. Ne kemi pasur probleme, iu kemi drejtuar edhe Komisionit për Legjislacion, na ka dhënë këshilla juridike si të veprojmë, sepse janë tre deputetë në Këshill dhe neve na pamundësohet që të mbikëqyrim punën e Agjencionit. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Unë kam vështirësi dhe mendoj se çdokush po të ishte këtu, do të kishte vështirësi ta dijë çka po bëhet këtu. Ju lutem! Në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi tha që shkon edhe lavdëroi këtë strategji antikorruption. Të njëjtën gjë e ka bërë edhe Komisioni për Financa, por nuk ishte këtu Kryetari, por edhe rekomandimet e tij janë pozitive. Edhe Kryetari i Komisionit për Punë të Brendshme në një mënyrë i dha vizë që të shkojë ky Komision dhe të gjitha këto komisione, nuk përbëhen vetëm prej Partisë Demokratike, por përbëhen prej deputetëve të gjitha partive politike.

Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Ibrahim Makolli. Jo, grupet parlamentare duhet të bashkëpunojnë me anëtarët e tyre që i kanë nëpër komisione.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Po pajtohem me juve që është vështirë ta dimë çka po bëhet këtu, përderisa na sjellin këso materiale për të cilat seriozisht as ata që e kanë sjellë, nuk e dinë çka janë këto.

Do të ishte shumë mirë sot po të kishim para vetes një strategji nga ana e Agjencionit Antikorruption, por për fat të keq, ne kemi një raport që më shumë ka përshkrim dhe në një pjesë shumë të vogël ka dëshira, të cilat i shohim për çdo ditë në mjetet e informimit, që vijnë nga ana e organizatave joqeveritare, nga Shoqëria Civile, qoftë e vendit, qoftë nga jashtë.

Unë do të përmend vetëm disa prej çështjeve për të cilat ose të cilat na detyrojnë që ky dokument, që më së paku mund të thuhet strategji, do ta meritonte mbështetjen tonë. Së pari do t'i përmend disa prej defekteve që janë në këtë strategji ose në këtë dokument. Është tërësisht një metodologji e gabuar në hartimin e strategjisë. Objektivat janë shumë të paqarta, për të mos thënë nuk ka objektiva fare, nuk ka afate kohore dhe

bartës për zbatimin e tyre, nuk parasheh veprime konkrete në luftën ndaj korrupsionit, nuk ka të bashkëngjitur një plan të veprimit, është më tepër një dokument, një fontanë dëshirash. Nuk është e hartuar në harmoni të plotë edhe me rekomandimet e faktorëve të tjerë, institucioneve të tjera që merren me luftën ndaj korrupsionit dhe shoqërisë, sikurse edhe të Shoqërisë Civile.

Si Grup Parlamentar, natyrisht, nuk do ta ketë mbështetjen tonë ky dokument. Kërkojmë që ky të kthehet prapa dhe të punohet ashtu siç i ka hije një strategjie që të ketë brenda vetës edhe objektiva të qarta, që të ketë të përcaktuar bartës të gjitha aktivitetëve për zbatim, sikurse që ta ketë edhe planin e veprimit pa të cilin nuk mund të ketë sukses një dokument. Thjeshtë, nëse shikohet mirë ky dokument, mund të nënkuptohet se është një strategji për të mos pasur strategji edhe është një zgjidhje për të mos pasur zgjidhje në luftën kundër korrupsionit, por më tepër është një dokument i cili brenda rreshtave ka rrezik që të fshehë edhe veprimet korruptive që ndodhin në këtë vend. Nga Grupi parlamentar i AKR-së, nuk do ta ketë mbështetjen. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Edhe pse deputetët tuaj kanë qenë në të gjitha komisionet, në tri komisione. Fjalën e ka deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: I nderuar Kryetar, ju faleminderit edhe një herë!
Mendoj se, para se të filloj të flas, do ta falënderoj deputetin Ibrahim Makolli, e tha hyrjen time.

Unë nuk e di qysh mundet dikush t'i thotë strategji këtyre 5 faqeve të çuditshme. Çka do qoftë mund të jetë, mundet të jetë dokument, të quhet dokument, të quhet synim, çka do qoftë tjetër, por strategji, një dokument që nuk e parasheh as edhe një veprim të vetëm që qartë, asnjë, ju lutem, nëse ka mbetur, dyshoj që ka mbetur dikush prej deputetëve pa e lexuar, mirëpo nëse ka mbetur dikush, shikoni a ka ndonjë veprim çfarëdo qoftë më të voglin, më të thjeshtin të mundshëm? Po ju betohem se nuk e ka! A ka ndonjë datë, përpos datave hyrëse 2009-2011, a ka ndonjë datë për ta arritur ndonjë cak? Prapë po ju betohem se nuk e ka asnjë datë! A e ka ndonjë plan legjislativ, a ka diçka që Qeveria do të kishte thënë, duhet të miratohen: një, dy, tre, katër, pesë ligje, në mënyrë që të luftohet korrupsioni më me efekt? Asnjë, asnjë i vetëm. A ka ndonjë plan që të ndryshohet ndonjë legjislacion, i cili mund të kenë elemente të cilat i hapin dyert për korrupsion? Asnjë. Do të thotë, në këtë strategji, e vetmja faqe që vlen të lexohet është faja 5, ku identifikohen problemet me disa bullet point edhe thotë, është mungesa e vullnetit politik. Vullneti politik i kujt? Pra, i Shoqërisë Civile, jo bre, por i Qeverisë, normal.

Mosplanifikimi, mungesa e mjeteve financiare, mungesa e personelit me nevojë, mungesa e kontrollit dhe mbikëqyrjes, mosdashja e institucioneve për ta shmangur korrupsionit, këtu e keni të shkruar në strategji, mungesa e presionit nga ana e Shoqërisë Civile, që është një pjesë e çuditshme. Të gjitha këto që i ka radhitur si probleme, e në një shoqëri tjetër do të ishin quajtur me një emër, thotë një kulturë korruptive e institucioneve të Kosovës. Kështu quhet, nëse ka mungesë të vullnetit, mungesë të vullnetit për të ndarë mjete, mungesë të dëshirës e tjera, e tjera që i radhita, do të thotë ka kulturë korruptive të theksuar.

Kapitulli i parë flet për nocionet, çka do të thotë korrupsion, çka do të thotë diçka tjetër. Kapitulli i dytë për objektivat e strategjitë. Kapitulli i tretë flet, paramendoni ju, për sektorët prioritarë dhe objektivat e sektorëve prioritarë, të strategjisë dhe nuk ka më,

kurrjë tjetër. Për këto që i përmenda unë, flet kjo strategji, do të thotë, nuk është strategji hiq. Aq më tepër, gjuha që e përcjell dokumentin është kjo. Po ua citojë një fjali:” Qeveria duhet t’i kushtojë vëmendje të posaçme shmangies së nepotizmit” Kjo është, do të thotë, gjuha që e përcjell strategjinë. Kjo është gjuha e strategjisë.

Tjetër, ju thashë nuk parashihet asnjë datë, asnjë legjislacion, asnjë rritje konkrete e buxhetit, qoftë për agjencionin, qoftë për institucionet, të cilat për shkak të buxhetit të vogël mund të krijojnë hapësirë për korrupsion, bile-bile, në fund të fundit, në këtë dokument thuhet, që prapë po e citoj: Janë objektivat, përmenden cilat janë objektivat e shoqërisë civile? Ku keni parë ju që Qeveria me një dokument të Qeverisë t’i përcaktojë objektivat e Shoqërisë Civile? Ky është i vetmi dokument që mund ta gjeni ju në shoqërinë serioze, edhe gjysmë serioze, po ju them, ndoshta edhe krejt joserioze, që Qeveria me një dokument të vetin zyrtar, të cilin synon ta votojë në Kuvend të Kosovës, i përcakton objektivat e Shoqërisë Civile. Ky është dokumenti që e keni para veti.

Ne, si Grup Parlamentar, mendojmë se ky dokument paraqet korrupsion të luftës kundër korrupsionit, esencialisht korrupsion të luftës kundër korrupsionit për shkak se e degradon deri në masën përfundimtare, ia mëshon goditjen përfundimtare luftës kundër korrupsionit dhe e bën një luftë qesharake, diçka me të cilën vetëm mund të tallen njerëzit të cilët e shohin. Më mirë do të ishte të mos na sillni hiq këtë dokument, në fund të fundit, definitivisht ne nuk e votojmë. Mendojmë se është joserioz, se është lojë me opinionin, është lojë me institucionet, është lojë me luftën kundër korrupsionit.

Edhe, në fund të fundit, e kam edhe një pikë për ju të gjithë, i kam me vete 1 euro e 12 centë, që kanë dalë mangu prej projektit Hade, prej 22 milionëve, do t’ia lë Qeverisë, janë para të popullit edhe do ta lus Administratën të mos i prek, se para të popullit janë, aty t’i lë! Unë i ktheva të miat, për çka jam akuzuar, tash do të pres që krejt të tjerët t’i kthejnë të vetat edhe do t’i thërras. Ju falënderoj shumë!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Lulzim Zeneli e ka fjalën.

LULZIM ZENELI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Së pari, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë konsideron që ato çka thanë parafolësit se ky dokument mund të jenë gjithçka tjetër vetëm strategji jo apo projekt strategji, ne mund të konsiderojmë se ky dokument mund të plotësonte një kriter që të jetë program politik i Agjencionit Antikorrupsion, që i shpreh qëllimet e veta.

Mirëpo, nëse konsiderojmë për strategji ku përfshihen caqet, objektivat apo afatet kohore, mekanizmat, aktiviteti, atëherë të gjitha këto nuk zënë vend në kuadër të këtij dokumenti dhe lirisht mund ta quajmë se nuk e kanë arritur qëllimin për çka ka pretenduar institucioni në fjalë ta adresojë të adresojë në Kuvendin e Kosovës.

Konsiderojmë se ky dokument është porosia më e keqe që mund t’i adresohet Kuvendit të Kosovës nga ana e Qeverisë së Kosovës dhe nga ana e Agjencionit Antikorrupsion. Kjo porosi do të thotë se nuk kemi vullnet politik, çka e kanë konfirmuar edhe në këtë dokument, kjo porosi neve na jep që nuk jemi të gatshëm të ballafaqohemi me këtë dukuri dhe kjo porosi do të thotë që të gjitha ato alarmime që kanë qenë të mekanizmave ndërkombëtarë përmes dokumenteve zyrtare, tregojnë se institucionet tona ende nuk kanë gjetur kohë të merren seriozisht, të paktën në nivel të debatit apo të diskutimeve konkrete sa i përket këtij fenomeni. Atë çka do të duhej të theksohej sot,

është se në qoftë se Kuvendi i Kosovës është seriozisht i interesuar që të debatojë apo të diskutojë rreth këtij fenomeni, atëherë kjo shihet më së miri se nuk kemi pasur as kurajën politike, as guximin politik që deri tash edhe pas një periudhe të gjatë pothuajse të funksionimit të Agjencionit Antikorrupsion ta kemi një pasqyrë reale mbi bazën e argumenteve vetanake të institucioneve tona se ku qëndron shkalla e korrupsionit në vend.

Asnjëherë nuk kemi diskutuar për një raport, mbi bazën e të cilit do të orientoheshin edhe hapat tonë të ardhshëm. Nëse thuhet se kjo nuk ka ndodhur, atëherë si është e mundur që kjo strategji apo ky dokument të krijohet në bazë të perceptimeve të cilat janë marrë në bazë të anketimeve të ndryshme?

Shikoni, të gjitha këto dhe thirrjet në këtë dokument, bazohen në perceptimet e qytetarëve, ku ekziston shkalla më e lartë e korrupsionit apo ku ekzistojnë dyshimet, çka do të thotë se ne nuk kemi krijuar as mekanizëm, neve na mungon infrastruktura ligjore adekuate, dhe neve deri tash na mungon edhe aktiviteti konkret.

Unë në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, konsideroj se është humbje kohe të bisedohet për këtë dokument, për arsye se është një dokument i cili nuk i bën nder as Agjencionit, por më së paku do ta komprometojë Kuvendin e Kosovës në qoftë se merrmi me te. Prandaj, jo se do të votojmë kundër, mirëpo apelojmë që të merremi seriozisht me këtë çështje për arsye se është momenti i fundit ta demonstrojmë seriozitetin tonë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Unë e kam, po e shfrytëzoj pozitën dhe nuk po dal në foltore, por vërtet grupet politike në Kuvendin e Kosovës të mos i bëjnë dy- tri dhe dhjetë politika. Të gjitha grupet politike, në tri komisionet që e kanë shqyrtuar këtë, kanë marrë pjesë dhe ia kanë dhënë vizën për të ardhur në Kuvend dhe ka ardhur, kurse tash para opinionit po dalin me një fytyrë tjetër dhe nuk është mirë për grupet politike kështu.

Seanca vendos, po vendos mbi bazën e grupeve parlamentare. Për këtë janë të organizuara grupet parlamentare dhe komisionet parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, fjalën e ka deputeti Enis Krvan.

ENIS KRVAN: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Duke pasur parasysh nevojën për të pasur një qasje gjithëpërfshirëse për t'i zhvilluar dhe zbatuar politikat kundër korrupsionit, nevojat për krijimin e kushteve për pjesëmarrjen efektive në bashkëpunim ndërkombëtar kundër korrupsionit, duke përfshirë konventat ndërkombëtare dhe rrethanat e ndryshme, e arsyeton nevojën për miratimin e një strategjie të re e cila do të zbatohet gjatë periudhës kohore 2009-2011.

Pas miratimit të strategjisë së re, Agjencioni Kosovar Kundër Korrupsionit, në bashkëpunim me Zyrën e Kryeministrit, Zyrën e Qeverisjes së mirë dhe me institucionet në koordinim me institucionet e tjera, do të fillojë procesin e përpilimit të planit të veprimit, i cili do të reflektojë dhe përcaktojë masat specifike dhe konkrete për secilin institucion përgjegjës.

Prandaj, Grupi Parlamentar “7+” është i mendimit se ky dokument i plotëson të gjitha kriteret për miratim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit shumë dhe le të marrin vesh këta të tjerët.

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, fjalën e ka Bojan Stojanović.

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala gospodine predsjedniče!

Naravno, Parlamentarna grupa SLS u potpunosti podržava ulazak jedne ovakve strategije u proceduru. Ovo je vrlo bitna stvar, pogotovo u tranzicionim pordurčjima, pogotovo pričamo o području Balkana, čiji smo sastavi deo i jednog perioda iz postkomunističkih režima, tako da korupcija nije počelo ovom Vladom, korupcija nije počela ni pre tri meseaca, korupcija je počela možda još 50-tih ili 60-tih godina i nikada nije bila iskorenjena, niti ćemo mi sada ijednom strategijom to da uradimo. Ja ne znam dali to negde postoji u svetu kompletno, ali verovatno pravimo velike priče za one koji nas slušaju pa sada kao neko bi možda nešto bolje znao i uradio.

Naravno, postoji jedan problem da meni nije 50 evra za korupciju uzeo prevodioc, nego mi je uzeo da mi prevede ovaj dokumenat koji Poslanički klub SLS nije imao na srpskom jeziku i želim da skrenem pažnju još jednom na tu priču da nam dokumenta ne stižu i ne možemo na vreme da razmotrimo sve preporuke koje dobijamo, zakone ili strategije.

Straategija, naravno, može da se dopuni, može i da bude bolja, može da bude kvalitetnija, ali je mnogo veća stvar u implementaciji i želji i volji. Svakako nije odgovornost samo na Vladi, odgovornost je i na civilno društvo, budjenjem svesti, promenom sistema vrednosti, jer nisu odgovorni samo oni koji uzimaju, nego i oni koju daju. Kada budemo jasno prijavili, ja i sada imamo gde da prijavimo i šta da podensemo po tom pitanju, verovatno će i korupcija i sa strategijom i bez strategije biti smanjenja.

Da završim, mi ćemo podržati ovo, još jednom da vam ponovim i da vas zamolim da ubuduće dobijemo prevode i na srpskom jeziku. Hvala vam!

KRYETARI: Ju faleminderit! Nč emër të Grupit Parlamentar “Zajedno” deputeti Branislav Grbić e ka fjalën.

BRANISLAV GRBIĆ: Poslanička grupa “Zajedno”, s obzirom da je jako ozbiljna tema i s obzirom da zaista prevod nije bio na srpskom jeziku, ipak dozvolite da uzmem učešće u ovoj temi i da kažem sledeće, da je proces korupcije jedan proces koji ne može se završiti jednom strategijom, koja će biti odredjenim datumom rešena. To je jedan proces koji jedno moderno društvo, kao što je ovo kosovsko društvo, koje želi da udje u neke tokove evroskih integracija, sigurno mora da se izbori s time da kroz jedan vid, znači ne familjarizma, nepotizma, karijerizma, znači to su sve slabosti koje jedno društvo poznaje i koje sigurno kroz demokratske principe će ova Skupština i zajedno sa Vladom uvideti i smanjiti takav jedan način koji će dati rezultate u budućem nekom razvoju. Hvala, najlepše!

KRYETARI: Shkojmë me radhë, deputetë. Unë ju njoftoj që deri me tani për debat janë lajmëruar 16 deputetë. Po fillojmë nga i pari. Fjalën e ka deputeti Hajdin Abazi, le të përgatitet deputeti Armend Zemaj.

HAJDIN ABAZI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

E kam lexuar me vëmendje këtë Projekt-Strategji të Agjencionit Antikorrupsion dhe unë mendoj që vetë fakti se është projekt-strategji, tregon se këtu janë hedhur kornizat e një strategjie të re për veprim kundër, ose përparime kundër korrupsionit. Pra, sikurse që e tha edhe deputeti Kervan, pasi që të miratohet kjo strategji, atëherë, konform kësaj dhe në pajtueshmëri me këtë strategji, duhet të bëhet edhe plani i veprimit konkret se si të realizohet kjo strategji dhe nuk mundet krahas kësaj të shkojë edhe strategjia edhe plani i veprimit kur ne mund ta ndryshojmë strategjinë ose të mos e aprovojmë, atëherë do të dështonte automatikisht edhe plani i veprimit.

Në këtë kuptim, unë kështu e kuptoj pse kjo strategji ose projekt-strategji është e përgjithshme, do të thotë këtu shtrohen vijat e përgjithshme si mendohet të veprojnë institucionet dhe segmentet e shoqërisë që mendohet të angazhohen me qëllim që të arrihen efektet e dëshiruara. Ne jemi dëshmitarë, për fat të keq, se në shumë dimensione kemi trashëguar dhe po vazhdon ende mostransparenca ose mungesa e transparencës në disa segmente dhe, për këtë arsye, një pjesë e kësaj strategjie e parasheh edhe angazhimin e Shoqërisë Civile dhe personalisht unë e përkrah këtë për arsye se, nëse ne shkojmë si shoqëri drejt demokratizimit, duhet të jemi transparent dhe duhet t'i japim hapësirë edhe Shoqërisë Civile që edhe ajo të ndihmojë, ta jap kontributin e vet dhe të jetë në ingranazhet e përbashkëta që e lufton korrupsionin. Natyrisht, që janë instancat të cilat, në fund të fundit, e marrin vendimin se a janë ato propozime, ato fakte, ato të dhëna të sakta apo jo, mirëpo nuk do duhej të eskludohen nga ky proces, por përkundrazi dhe, unë mund të them, duke u nisur nga Ligji për lirinë e asocimit në OJQ, kontributi i Shoqërisë Civile, përkatësisht i OJQ-ve ka qenë jashtëzakonisht i madh dhe ka provuar se vërtet mund të jenë aktive dhe mund të japin kontribut dhe ne duhet të angazhohemi që sa më tepër ata t'i angazhojmë dhe të gjithë të bëheni krah për ta luftuar këtë të keqe që po e dëmton shoqërinë tonë.

Sa i përket Planit të veprimit, sikurse që thashë edhe në fillim, kjo duhet të bëhet mbi bazat e strategjisë, prandaj, kësaj strategjie, unë me sa e pashë, në parim, absolutisht asgjë nuk i mungon që ne ta aprovojmë edhe mbi këtë bazë pastaj të angazhohemi. Nëse ne do të angazhohemi për ta shtyrë këtë plan strategjik, atëherë faktikisht në njëfarë mënyre vetë po i lëmë edhe pak hapësirë korrupsionit të veprojnë. Dhe, një çështje tjetër që personalisht do ta ngritja këtu, është çështja, e di se është e rregulluar me ligje dhe me rregullore të ndryshme, mirëpo do të ishte mirë që Agjencioni Antikorrupsion vërtet të jetë i lirë që të bëjë veprimtarinë e vet dhe mos të ushtrohen presione të ndryshme, qoftë nga institucionet, qoftë nga deputetët e sidomos nga deputetët që mund të jenë anëtarë edhe të Këshillit Antikorrupsion.

Prandaj, ndoshta do të dilja si me propozim që ose të hiqen fare deputetët nga aty dhe kemi mekanizma të tjerë, me të cilët mund të ushtrojmë mbikëqyrjen tonë mbi bazat e ligjit jo të tjera, ndërsa nga brenda mund të frenohen proceset dhe të pengohet arritja e rezultateve. Për ta dhënë kontributin tim në këtë aspekt, unë them se hapi i parë dhe vendosmëria jonë a jemi saktësisht për ta luftuar korrupsionin apo jo, është pikërisht aprovimi i këtij plani strategjik dhe, pasi që ta aprovojmë këtë plan strategjik, atëherë këtu kolegët dhe koleget, të gjithë të mblidhemi nëpër komisione të ndryshme, në institucionet ku bëjnë pjesë, bashkë edhe me Shoqërinë Civile, ta japim kontributin tonë që ta bëjmë një plan të veprimit transparent me qëllim që t'ia ndalim hovim dhe ta ndalim këtë kancer të shoqërisë sonë, sepse një prej kushteve që ne të ecim me hapa më të përshpejtuar drejt Unionit Evropian, është pikërisht edhe lufta shumë e vendosur dhe pa zvarritje, por me plan veprimi konkret kundër korrupsionit. Unë, prej diskutimeve që janë bërë shpeshherë këtu, e di se vullneti ekziston për ta luftuar korrupsionin. Sot e

kemi rastin që ta bëjmë hapin e parë konkret në këtë drejtim dhe unë do ta votoj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj. E ke tërhequr, më duket, fjalën.

ARMEND ZEMAJ: ...Nuk ia vlen të bisedohet për një temë të tillë. Deri më sot asnjë njeri nga institucionet e qeverisë së kaluar, të tashme të Republikës së Kosovës nuk ka dhënë përgjegjësi për korrupsion. Çka kemi të debatojmë ne sot për antikorrupsion apo për një strategji në të ardhmen? Vetëm po përflitet. Dalin lloj- lloj tema për folje, kurrëgjë nuk po ka konkrete, kështu që është shtjerrë mendoj për mua ky debat. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Donika Kadaj- Bujupi dhe le të përgatitet deputetja Kaqusha Jashari.

(Ndërhyrje e deputetëve)

KRYETARI: Unë, jam duke shkuar me radhë. Regjia, emrat e deputetëve i jepni në ekran. Fjalën e ka deputetja Donika Kadaj - Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Ju faleminderit!

Si zakonisht, kur situata në këtë vend ekzagjeron edhe Qeveria zakonisht tenton të sjellë një dokument për ta tërhequr vëmendjen e opinionit në një drejtim tjetër, e kjo ka ndodhur edhe kësaj radhe kur na kanë ardhur një copë letra apo 4-5 faqe edhe thonë është një strategji.

Sidoqoftë, po tentojmë për ta trajtuar ashtu si e kanë sjellë, do të thotë, pikë për pikë. Në pikën e parë qysh në fillim, në hyrje Qeveria thotë se prioritet e ka sektorin e korrupsionit. S' ka pasur nevojë ta thotë se ne e dimë të gjithë. Kemi tërhequr vëmendjen prej fillimit prej ditës një kur Qeveria e Kosovës ka keqpërdorë 1.000.000 euro, nëse ju kujtohet deputetë, me një kontratë njëburimore edhe kemi kërkuar të jepen sqarime, por nuk janë dhënë. Aty është parë që prioritet, top-prioritet për këtë Qeveri është pikërisht sektori i korrupsionit.

Ndryshe, qysh do të shpjegohen praktikat korruptive që janë ngritur në nivel institucional: nepotizmi, ndërhyrjet politike në sektorin e shërbyesve civil, tjera, e tjera. Qysh ndryshe të shpjegohet faktin se janë prekur të gjithë sekretarët permanentë, duke u zëvendësuar në shumtën e rasteve me këshilltarë politikë.

Kriter që të jesh në një post publik është të jesh një vëlla ose një kunat i njërit prej zëvendëskryeministrave. Nëse do ta marrësh një tender, duhesh të paguash 30% haraç, edhe këtë nuk po e them ne si Aleancë, por këtë e thonë të gjitha raportet, e raporti i fundit i Odës Ekonomike që është bazuar në një hulumtim me biznesmenët e Kosovës.

Sipas kësaj strategjie, instrumentet kryesore në fushën e parandalimit të korrupsionit janë aprovuar. Ndër të tjera, përmendet edhe Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit, por sa është përfillur ky ligj, flet fakti se pikërisht kjo Qeveri që sjell këtë fletushkë si strategji për antikorrupsion, njërit nga shefat e opozitës ia jep një tender që u kushton taksapaguesve të Kosovës 15 milionë euro. Atëherë, çka na duhet një strategji kundër

korupsion, ose të flasim për konfliktin e interesit, kur është Qeveria e Kosovës ajo që vetë e stimulon realisht korupsionin dhe konfliktin e interesit.

Në kapitullin 5, bëhet në përkufizim se ky dokument i referohet sektorit publik dhe partive politike. Ndërkohë, Partia Demokratike e Kosovës vazhdon të mos i deklarojë shpenzimet e fushatës zgjedhore, që le hapësirë për të dyshuar se burimet financiare janë të dyshimta ose, thënë më mirë, paratë e fushatës kanë ardhur nga bizneset e pista dhe ekonomia joformale, për arsye të tjera do të ishin publikuar këto të dhëna dhe do të kishim shumë më shumë transparencë nga kjo parti.

Edhe më tutje, një numër shumë i madh zyrtarësh nuk deklarojnë pasurinë e tyre, janë mbi 200 të tillë. Qeveria e neglizhon Ligjin për deklarimin e pasurisë që t'u ikë obligimeve që dalin nga miratimi i këtij ligji.

Në një kapitull tjetër, të kësaj të ashtuquajture strategji, i referohet, do të thotë Qeveria i referohet pjesëmarrjes së publikut në procesin e vendimmarrjes.

Në të njëjtën kohë, pa asnjë debat publik, Qeveria e Republikës së Kosovës vendos për t' i shitur asetet e qytetarëve të Kosovës, ndërmarrjet publike, sovran i të cilave është populli. Derisa edhe këtu nuk debaton, domethënë, jo me opinionin publik, me qytetarët e Kosovës, por as me punëtorët që realisht janë aksionarë të këtyre ndërmarrjeve.

Derisa strategjia parasheh agjencitë monitoruese, vazhdon me presionin publik ndaj trupave të pavarur. Ju kujtohet, kur shefi i Agjensionit Kundër Korupsionit ftohet në një bisedë informative, pasi që del me një raport ku thuhet që Qeveria është e korruptuar. Dhe, kjo është larg asaj se çfarë parashihet në këtë shkresë që na është dhënë.

Mandej, të gjitha organet e prokurimit publik i janë nënshtruar spastrimeve politike. E fundit, do të thotë, është APP-ja. Mund ta verifikoni se të cilët janë njerëzit të cilët janë emëruar si ushtrues detyre, të afërmit e kujt janë dhe cilat kanë qenë kriteret që këta njerëz të jenë në këtë agjencion, i cili parashihet edhe me këtë copë letër apo strategji të ashtuquajtur, të jetë i pavarur?

Të gjitha këto veprime tregojnë që Qeveria Thaçi, jo vetëm që nuk tregon vullnet politik për ta luftuar korupsionin, por përkundrazi, me veprimet e bëra po vazhdon ta stimulojë atë. Dhe, kjo mungesë e theksuar e vullnetit politik nga Qeveria aktuale, rrjedhimisht do të ketë pasoja shumë të mëdha në implementimin e çfarëdo strategjie apo çfarëdo lufte kundër korupsionit.

Në fund, e gjithë kjo letër që sot është paraqitur para neve, të nderuar, ma kujton një barsoletë të vjetër, kur një fshatar kërkon një roje për kopshtin e tij, kërkon një roje që t'i ruajtu mollët dhe i lajmërohet fqinji i parë, i thotë: -qe, unë po vi, më merr në punë. Ky i thotë: - po të mos ishe ti, unë nuk e kisha marrë rojën fare! Po të mos ishte Qeveria e Kosovës, në këtë masë, në të cilën është, në këtë shkallë e korruptuar, ne sot nuk do duhej të debatonim për këtë copë letër, e cila nuk parasheh asnjë objektiv, asnjë afat kohor, asnjë zgjidhje konkrete, por në një formë është një tërheqje e vëmendjes e radhës nga ajo se çfarë po ndodh në Republikën e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Veç kisha kërkuar prej deputetëve të jenë me këtë zjarr, ta luftojnë korupsionin edhe atëherë kur keqpërdoret në buxhetet dhe si krijohen buxhetet

e partive politike. Do të ishim shumë mirë me opinionin, po t'i shikojmë edhe financimet e partive politike edhe të opozitës.

Fjalën e ka deputetja Kaqusha Jashari, le të përgatitet Myrvete Pantina.

KAQUSHA JASHARI: Ju faleminderit, Kryetar!

Të nderuar kolegë,

Unë e kam pasur një tjetër koncept të diskutimit, por pas diskutimeve që dëgjova këtu, pak mendoj ndryshe. Pra, a mund ta vazhdoj? Thashë, mos po do të ma marrësh fjalën.

Këtë projekt që e morëm për Strategjinë kundër korrupsionit 2009-2011, nuk mendoj që nuk vlen edhe që është një strategji sa për të thënë, se po e çojmë tjetërkah se Agjencioni Kundër Korrupsionit, domethënë nuk e ka bërë strategjinë e mirë, mos po na del se ai na ka faj për korrupsion. Prandaj, të shikojmë pak më seriozisht këtë strategji, sikur që kemi shqyrtuar këtë strategjinë tjetër, që e patëm para dy orëve një diskutim për veprimin në bazë të planit nga raporti i Komisionit Evropian, se janë disa pika të ngjashme si obligim.

Në fillim të këtij projekti është dhënë vlerësimi për situatën aktuale në Kosovë, por krejt nga aspekti i vlerësimit nga Komisioni Evropian, nga disa institucione të tjera ndërkombëtare, e pak i kemi, unë po pajtohem se janë këto vlerësime, me siguri edhe të rëndësishme, edhe më reale, por ka munguar pak nga këndi ynë i Agjencionit se si është momentalisht situata, po, po e lëmë me këtë se nuk ka qenë raport, por ka qenë Projekt i Strategjisë dhe me siguri nuk kanë dashur të hyjnë më shumë në këto vlerësime.

E kemi krijuar bazën ligjore, po edhe për fushën e parandalimit të korrupsionit, por edhe ligjet tjera. Pra, ajo çka mua më ka rënë në sy shumë dhe që është krejt në këtë strategji, është mungesa e masave konkrete dhe për strategjinë e vitit 2004-2007 thuhet se nuk ka mundur, nuk ka pasur zbatimi efekte dhe po theksohet mungesa e vullnetit politik. Me siguri, kjo kur po them mungon, edhe unë po pajtohem, vullneti politik, unë nuk po mendoj për një vit ose dy vjet, por ky vullnet politik ka munguar me krijimin e shtetit tonë të ri, domethënë shumë vjet, prandaj zërat këtu që po duan t'i gjuajnë krejt në lidhje me korrupsionin kohëve të fundit, le të mendojnë edhe në atë kohë kur kanë qenë të tjerët në pushtet çka kanë bërë.

Unë mendoj se për vullnetin politik, janë dy arsye, kështu, të rëndësishme, ose është papërgjegjësia e punës në të gjitha nivelet, ose përfshirja e tyre në veprime korruptive. Nuk dua të hyj në vlerësim, por këto dy shkaqe janë. Prandaj, edhe kjo strategji në qoftë se e aprovojmë kështu sa për ta aprovuar edhe t'ia lëmë Agjencionit që ata të merren me këtë strategji, mund të ndodhë që nuk do të kemi sukses. Prandaj, kjo strategji e propozuar i ka 5 kapituj, ku janë përfshirë objektivat edhe të përgjithshme, por edhe objektivat konkrete. Unë isha ndalur në kapitullin numër 3, ku është një ndër sektorët prioritar të shënuar si sektor politik, prapë po kthehem në atë vlerësimin e vullnetit politik, dhe mendoj se duhet të kemi një përgjegjësi se në këtë kapitull po shkruan: "masat antikorrupsion të sektorit politik, do t'i adresohen: a) partive politike, deputetëve të Kuvendit dhe, nën tre - anëtarëve të Qeverisë dhe anëtarëve të kabinetëve politike." Nuk kemi çka të themi se kush ka ma shumë obligim edhe përgjegjësi, por unë mendoj segmentet tjera, nuk po dua t' i përmend, që kjo është shumë me rëndësi. Nuk është rastësisht - partive politike dhe unë po pajtohem me ju, Kryetar, kur përmendët se të gjitha partitë le të shikojnë veten brenda çka janë duke

bërë, prandaj edhe këtu janë masat edhe gjendja mund të ndodhë korruptive, por kur janë deputetët e Kuvendit, unë këtë e kuptoj se na i kemi përgjegjësitë për ligjshmërinë, për aprovimin e ligjeve, për ndryshimin e ligjeve në qoftë se është aty pengesa për luftën kundër korrupsionit. Dhe, çka po propozoj, po e përfundoj këtu. Kjo strategji mendoj se duhet të aprovohet, por duhet të kërkohet të bashkëngjitet plani konkret me dinamikën e caktuar dhe të harmonizohet me këtë që aprovuam Planin e veprimit për sfidat e Raportit të Komisionit Evropian për progresin në Kosovë, se shumë pika janë të ndërlidhura me luftën kundër korrupsionit. Nuk është rastësisht që edhe në atë dokument, edhe në këtë dokument po përmendën shërbyesit civilë dhe lufta kundër nepotizmit, kundër korrupsionit dhe këto institucione, duke filluar edhe nga ne këtu në Kuvend, edhe në Qeveri, janë stërmbushur me pranimin e njerëzve në baza të përkatësisë partiake, por jo vetëm tash, por edhe më herët. Me nepotizmin, vetëm e kam një dilemë, qysh t'ia nisim, aty është problemi edhe kush duhet t'ia fillojë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Myrvete Pantina, le të përgatitet deputeti Gani Geci.

MYRVETE PANTINA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Transparenca, përgjegjësia dhe sundimi i ligjit, duke përfshirë edhe antikorrupsionin, janë faktorë kryesor për ngritjen e atraktivitetit të vendit tonë për investime të jashtme dhe të brendshme.

Qeveria aktuale ka demonstruar gatishmëri për të luftuar korrupsionin, por rezultatet konkrete ende nuk shihen. Për rezultate duhet të flitet në mënyrë konkrete, duhet folur me shifra, duhet folur me emra dhe mbiemra. Unë pajtohem që është vështirë të zhduket korrupsioni apo edhe, siç u dëgjua këtu, nuk do të zhduket fare, asnjëherë, por kjo nuk do të thotë që korrupsionin nuk duhet ta luftojmë apo ta ulim në shkallë më të ulët.

Korrupsioni është një problem i madh që ndikon në aktivitetet ekonomike në Kosovë, lidhur me këtë do ta përmendi një fakt. Do të bazohem në Raportin, situata socio-ekonomike në Kosovë për vitin 2008, i cili ka bërë një hulumtim dhe nga ky hulumtim që është bërë me pronarët e firmave në vitin 2006, del konstatimi se korrupsioni është pengesë madhore apo ndër faktorët kryesorë që pengon afarizmin e ndërmarrjeve. Mirëpo, hulumtimi i bërë dy vjet më vonë, konkretisht në vitin 2008, ka treguar që pronarët e firmave korrupsionin tanimë e konsiderojnë si pjesë të lojës dhe jo më si barrierë për zhvillimin e afarizmit të tyre. Kjo tregon se korrupsioni në Kosovë është shndërruar në dukuri normale, prandaj edhe duhet të na brengos, sepse korrupsioni ka ndikim negativ afatgjatë, jo vetëm në sektorin privat të vendit, por edhe në klimën investuese dhe si i tillë duhet të jetë shqetësim kryesor për hartuesit e politikave.

Ne kemi nevojë për strategji kundër korrupsionit, mirëpo për mendimin tim, Projekt-strategjia kundër korrupsionit për periudhën 2009-2011 është shumë e përgjithësuar. Për të dhënë rezultate, duhet që plani i veprimit të hartohet sa më parë, të jetë sa më konkret, me detyra konkrete, me bartës konkret si dhe afate konkrete për kryerjen e tyre, do të thotë, t'ia bashkëngjitet planit të strategjisë, në mënyrë të kompletuar, pastaj të shkojë në miratim.

Ne sot nuk dimë se në çfarë niveli e kemi korrupsionin. Flitet se ka korrupsion, por me shifra konkrete, do të thotë, nuk e dimë. Për këtë arsye, duhet siguruar informata përmes hulumtimit për shkallën e korrupsionit që ka të bëjë konkretisht me pasurinë e personave dhe burimeve të financimit të tyre, për mënyrat e punësimit, për ndërmarrësit, se si ata e

zhvillojnë afarizmin e tyre, a kërkohet që të japin mito për kryerjen e aktivitetit të tyre e kështu me radhë.

Dhe, në fund, ne duhet të dimë se për t'u anëtarësuar në organizatat ndërkombëtare, lufta kundër korrupsionit për ne paraqet një obligim të domosdoshëm, të cilit duhet t'i përvishemi sa më parë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Gani Geci, le të përgatitet deputeti Naser Rugova.

GANI GECI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Në fillim dua të cek se ne, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, jemi mjaft unik dhe shqetësimet tona i kemi dhënë edhe në Komision. Unë kam qenë referues në Komisionin për Punë të Brendshme dhe Siguri dhe kam përgatitur edhe një raport, por nuk është marrë parasysh. Është bërë rekomandimi me vërejtje dhe unë vërejtjet edhe në bazë të referimit që kemi bërë, do t'i paraqes këtu.

Agjencioni Antikorrupsion ka punuar një projekt për luftimin e korrupsionit për vitin 2009-2011 dhe unë posaçërisht e kam lexuar me vëmendje këtë projekt, i cili ka mjaft mangësi.

Në bazë të raporteve që ka bërë Agjencioni Antikorrupsion më herët, del se korrupsioni në shoqërinë kosovare është mjaft shqetësues dhe më së shumti të korruptuar janë gjyqi, mandej ministritë, kuptohet ministritë që kanë para, sepse ata që s'kanë para s'munden edhe të bëjnë korrupsion. Ai, është KEK-u, janë Agjencioni Kosovar i Privatizimit ose AKM-ja më herët, shëndetësia dhe doganat. Këta janë dikasteret që kanë mjete financiare dhe këta janë dikasteret që korruptohen ose e korruptojnë dikë.

Dhe, problem kryesor për zbatimin e Ligjit antikorrupsion në Kosovë është fenomeni dhe krijimi i lidhjeve të krimit të organizuar dhe mafies në Kosovë. Kjo po shkakton një frikë, sepse po mungojnë shembuj pozitivë për t'i arrestuar njerëzit kyç që prodhojnë dhe inkurajojnë korrupsionin. Dhe, nëse nuk arrestohet askush për korrupsion dhe flitet shumë, atëherë të tjerët frikohen dhe kjo lidhje e krimit të organizuar - e mafies, kohën e fundit ka filluar të lulëzojë edhe jashtë territorit të Kosovës në bazë të asaj që dëgjuam sot në Kuvendin tonë.

Në rend të parë, në rekomandimet që unë kam bërë, kam shkruar se mungon liria e informimit e cila siguron qasje të qytetarëve në informatat e Qeverisë si në vendimmarrje dhe informata tjera, kuptohet përpos informatave konfidenciale që Qeveria nuk duhet t'i bëjë publike. Nuk shpërndahet asnjë informatë për qytetarët se kush e për çka është përgjegjës brenda Qeverisë së Kosovës dhe kush ku duhet të marrë informata. Nuk botohen, nuk publikohen buxhetet komunale, qofshin të hyrat vetanake dhe nëpër komuna ka korrupsion, aty ku ka buxhet të madh komunal. Krijimi i komisioneve jashtë kuvendeve komunale duhet të bëhet gjithsesi, sepse ata që punojnë në kuvendet komunale nuk mund të jenë në komisione antikorrupsion, sepse mund të jenë të ndikuar nga vetë komuna.

Ju e dini se ne kemi kërkuar disa herë që ne si deputetë, por edhe qeveritarët t'i shpalosin financat e tyre dhe ne nuk kemi një ligj për shpalosjen e financave, sepse të punësuarit në sektorët e Qeverisë kanë bërë mjete marramendëse brenda këtij vjetori që ju keni

qeverisur vendin. Unë i kam disa shembuj, por do t'i marr një herë tjetër me emër e me mbiemër.

Mandej, korrupsioni bëhet në tender. Askush nuk ka thënë prej qytetarëve të Kosovës se iu kanë marrë para për ta nxjerrë një certifikatë të lindjes, sepse certifikata e lindjes kushton 1 euro e gjysmë, paguhet dhe shkon. As Shërbimin Policor të Kosovës nuk e kemi të korruptuar dhe këtë e dimë të gjithë, por të korruptuar i kemi institucionet me mjete të mëdha financiare dhe konkretisht në tenderë.

Të nderuar, ne kemi pasur rastin kur një person e ka ofruar çmimin 15 milionë euro dhe një tjetër 12 milionë euro dhe i jepet tenderi atij që e ka 15. Merreni me mend, 3 milionë euro sa do të janë për Qeverinë dhe për taksapaguesit e Kosovës?

Ne nuk ua hapim dyert nëpër Qeveri të Kosovës organizatave joqeveritare dhe Shoqërisë Civile që të monitorojnë hapjen dhe dhënien e tenderëve. Mandej, korrupsioni bëhet me lëshimin e licencave apo moslëshimin e licencave, sepse një herë refuzohet dhe mandej kërkohet korrupsion prej tij që t'i jepet. Ne nuk kemi krijuar asnjë departament kundër korrupsionit dhe kjo duhet të bëhet brenda secilës ministri, sepse thashë më herët, korrupsioni nuk është duke u bërë në kafene, por në ministri.

Ne duhet të luftojmë korrupsionin edhe në sektorin ekonomik privat, sepse dikush kur dëshiron të blejë diçka në AKP, po bëhen marrëveshje të fshehta për çmimin, edhe aty është një korrupsion. Mandej, korrupsioni është mjaft i theksuar edhe në fushatat elektorale. Ju lutem, ka këtu parti politike që nuk i ka bërë publike ende shpenzimet e tyre për fushata elektorale. Dhe, ne duhet gjithsesi që firmave që marrin tenderë një vit para fushatave elektorale t'u kontrollohen kontot dhe t'u kontrollohet buxheti i tyre, qoftë nëpërmjet kontove, qoftë kesh, një vit para dhe një vit prapa. Pse? Sepse po e dimë që buxhetet e firmave të mëdha që marrin tenderë nga qeveritë, qofshin ato të kaluara, qofshin këto, po korruptohen dhe po derdhin mjete marramendëse për partitë politike dhe më në fund partitë politike që s'kanë mjete dalin më të dobëta. Dalin më të dobëta, sepse nuk kanë ku vjedhin, janë jashtë institucioneve, ndërsa ato që janë brenda kanë ku marrin mjete, sepse iu dhënë tenderë dhe ua mbulojnë fushatat elektorale, qoftë në kesh, qoftë nëpërmjet kontove të ndryshme.

Mandej, të kontrollohen tenderët brenda organizatave shtetërore, siç është KEK-u, sepse ju e dini që KEK-u ka një buxhet marramendës dhe edhe ne ia kemi dhënë nja 80 milionë euro, por edhe ata marrin para dhe ata aty kanë disa tenderë. Edhe aty është një korrupsion mjaft i theksuar. Gjithashtu, edhe në telekomunikacion, në Postë Telekomunikacion dhënia e tenderëve të Postës, është për t'u kontrolluar, sepse aty ka mjaft korrupsion. Posta ka mjete që i ka deponuar në llogari të veta dhe tani i ka ardhur mundësia Post Telekomit të Kosovës që të tenderojë ose të kërkojë tenderë edhe jashtë Kosovës, në bashkëpunim me disa firma që shesin patëllxhanë.

Mandej, kemi problem edhe te shëndetësia e Kosovës, sepse njeriu kur është i sëmurë nuk i llogarit mjetet që i harxhon për shërimin e vet dhe kjo është mjaft e theksuar në shëndetësinë, qoftë private, qoftë në atë shtetërore.

Të kontrollohet çdo pore që ka mundësi të bëhet korrupsion në nivelin qendror, por edhe në nivelin lokal.

Andaj, unë këto vërejtjet e mia që i kam dhënë si referues që kam qenë në Komisionin për Punë të Brendshme, nuk janë marrë parasysh edhe pse janë në formën e shkruar dhe në formën e shkruar ia kam dërguar Komisionit për shqyrtim, por në ditën e djeshme që kemi shqyrtuar i kanë lexuar vetëm tërthorazi. Këto ishin ato që unë pata ndërmend t'i them, sepse nëse ne vazhdojmë kështu të flasim dhe të mos krijojmë strategji, se ajo strategjia që e ka bërë Agjencioni Antikorrupsion është mjaft e mangët dhe them, sinjerisht, është sa për sy e faqe. Faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti Geci! Fjalën e merr deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Po diskutojmë për një çështje të rëndësishme, për një çështje që pothuaj se në të gjitha fushat e politikave sektoriale dhe mekanizmeve shtetëror dhe institucional janë bërë vërejtje serioze në Raportin e fundit të progresit të Komisionit Evropian, por janë dhënë vërejtje serioze edhe nga organizata serioze relevante vendore dhe ndërkombëtare. Në këtë kuptim, kur ne si organi më i lartë i shtetit të Kosovës, si legjislativ i vendit diskutojmë dhe asnjë nga anëtarët e Kabinetit qeveritar nuk është këtu prezent, kjo tregon se çfarë qasje ka Qeveria e dy partnerëve të mëdhenj të koalicionit ndaj masave që duhet të merren për luftën kundër korrupsionit. Unë po ua citoj dy slogane në fushatë që i keni pasur: “Krenohuni me Kosovën” dhe “Jeni në rrugë të drejtë” që ta fundosni këtë vend.

Unë dua të ndalem në temën për të cilën po diskutojmë, për Projekt- strategjinë kundër korrupsionit 2009-2011. Së pari, mungon një analizë gjithëpërfshirëse e gjendjes ekzistuese. Pyetja parashtrohet, pse? Sepse, atyre që duhet ta bëjnë analizën dhe t'i marrin masat nuk u konvenon kjo analizë dhe janë të korruptuar vetë. Dhe kemi emra, mbiemra, shifra. Madje, unë për disa edhe kam folur këtu në këtë Parlament të nderuar, kur kemi pasur tema të caktuara. Mirëpo, duhet të thirrem edhe në legjislacionin në fuqi. Ligji kundër korrupsionit e ngarkon Agjencinë Kundërkorrupsionit të Kosovës që pas një viti të funksionalizimit si institucion duhet të fillojë procesin e përpilimit të strategjisë kundër korrupsionit dhe që nënkupton se duhet të jetë vetë bartës i këtij procesi si agjencion i pavarur i zgjedhur nga ky Kuvend dhe kurrësi të mos ketë ndikime politike, qoftë nga ekzekutivi apo edhe mekanizmat tjerë. Pra, në hartimin e kësaj strategjie do të duhej të kishte një transparencë, një debat serioz, një analizë institucionale, me statistika, me fakte dhe do të duhej të kishte gjithë përfshirje të gjitha fokus-grupeve të shoqërisë kosovare. Së dyti, duhet të rishikohet dhe të plotësohet Ligji antikorrupsion, i cili do të funksionalizonte të gjitha përpjekjet e institucioneve për luftë më efikase kundër korrupsionit. Pastaj, nuk e di pse po zvarritet Ligji për deklarimin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik, duke filluar prej njëshit të vendit dhe tutje.

Kur e lexojmë me vëmendje këtë projekt-strategji, shohim se përpos mungesës së objektivave të qarta, mjeteve dhe masave të zbatimit të saj praktik dhe efikas, kemi edhe disa vërejtje substanciale. Nuk janë bërë hulumtime dhe analiza nga ana e institucioneve për nivelin e korrupsionit, shtrirjen në mekanizmat shtetërorë dhe institucional si dhe formën e shfaqjes së tij. Pastaj, nuk janë evidentuar keqpërdorimet për të gjithë sektorët, të publikohen ato dhe të merren masa adekuate konform legjislacionit në fuqi. Dhe, tek e fundit, është folur shumë për korrupsion, për raste, na kanë ardhur informata edhe në këtë Parlament, duhet të hapen dosjet e korrupsionit dhe të bëhen transparente si një nga masat efektive për luftimin e korrupsionit. Kur thuhet se filan zyrtari, bartës i filan përgjegjësie dhe institucioni ka vjedhur, duhet të flasim shqip dhe ka keqpërdorur, atëherë kolegët e tij dhe homologët e tij në institucionet tjera dhe mekanizmat

institucional apo edhe jo institucional, do të kishin shumë kujdes se si do të vepronin në të ardhmen. Pastaj, të formohen mekanizma mbikëqyrës permanentë që përfshinë të gjitha fokus-grupet e shoqërisë, pse jo edhe subjektet ekonomike pa diskutim, që të ketë përfaqësues nga të gjitha partitë politike. Ky Këshill Antikorrupsion që i përfshinë edhe disa deputetë këtu, është konflikt interesi. Pse? Sepse janë deputetë të partive opozitare dhe kush na garanton neve dhe qytetarët pjesëtarët e Shoqërisë Civile që nuk do të ketë marrëveshje eventuale në mbulimin e aferave të ndryshme. Thjeshtë, janë përfaqësues të koalicionit qeverisës. Mungojnë objektivat e qarta, masat konkrete dhe dinamika e zbatimit të masave kundër korrupsionit, kush janë bartësit dhe si do të trajtohen ato? Pastaj, të përfshihet në këtë strategji dhe në planin e veprimit kundër korrupsionit monitorimi i gjithë procesit të privatizimit, që është një pikë e zezë e shoqërisë kosovare të viteve të fundit, shitjes së aksioneve apo dhënieve me koncesion të ndërmarrjeve publike, si dhe procesi i ndërtimit të Termocentralit “Kosova e Re” që, thuaja se është kah bëhet një zbulim epokal, kurrkush nga mekanizmat relevantë që do të duhej të dinin, nuk e di kohen se kah po shkon ky proces shumë i rëndësishëm për vendin? Dhe, jo vetëm ky! Çka po ndodh me PTK-në? Kah po orientohen mjetet e PTK-së dhe tani çështja e privatizimit të Aeroportit? Thjeshtë, është një jo transparencë dhe domosdo duhet të dyshojmë për afera korruptive, e dihet kush janë bartësit e këtyre përgjegjësi.

Dhe, krejt në fund, të përfshihen në këto dokumente të rëndësishme edhe masat ndëshkimore për aktorët e korrupsionit dhe ata që e favorizojnë ekonominë informale. Në këtë kuptim, kjo strategji duhet t’iu kthehet hartuesve, t’i marrin parasysh rekomandimet e organit më të lartë legjislativ të vendit se, po të vazhdojmë kështu, atëherë frikohem se edhe nja 30 vjet Evropa nuk do të na shikojë me sy. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Po, duhet shikuar pak veten, lëre Evropën. Faleminderit, zoti Rugova. E ka fjalën deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar, zoti kryesues!

Kolegë të nderuar deputetë,

Ky dokument që ne e trajtojmë sot, ju lutem, është hartuar aq me përgjegjësi sa që, ja një shembull, ndër shumë shembuj.

Në pikën 5, në kaptinën 5, jepet një definicion diskutabil për nocionin, për konceptin e definicionit. Në pikën 5, që natyrisht, hartimet shkollore në fillim në pikën e parë, në kaptinën e parë, si të them, jepet kuptimi i temës. Këtu, ja shembull, pika 5, domethënë, përgjegjësi totale sa i përket disiplinës dhe, si të them, ndjenjës për publikun, e tjera.

Ka shumë shprehje publicistike, proklamata, voluntariste, futuriste që, edhe sikundër ta miratonim këtë akt, asgjë prej gjëje nuk do të kishin pasur efekt, si të them, të dëshiruar në praktikë.

Do të përmend, jo rastësisht, para 100 vjetëve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës është miratuar një dokument që është quajtur Anti corruption law (Ligji kundër korrupsionit). Atë praktikë e kanë imituar shumë shtete perëndimore të zhvilluara. Dua të them se ne nuk mund të bëhemi SHBA, bie fjala, porse praktikat e mira ne duhet t’i kopjojmë kreativisht dhe duhet nëpërmjet akteve ligjore. Ne e kemi një dokument që quhet Ligj antikorrupsion, por ka shumë defekte dhe ka shumë vakuume juridike. Ai ndodhet në njëfarë amendimi, mirëpo duhet të bëhet sa më parë e sa më mirë që është e mundur, si parakusht për të bërë punë.

Nuk ka kurrfarë shprese për realizim të synimit tonë që unë besoj që secili prej nesh është për ta luftuar korrupsionin, po qe se nuk do të kemi institucione, konkretisht të angazhuara dhe sanksione, ju lutem. Se këtu, pa sanksione, ato mbeten norma morale. “Nuk duhet, nuk është mirë, keq është”, e tjera e tjera. Pa sanksione juridike nuk ka norma juridike dhe nuk ka efikasitet, as efikasitet, përpos normave me sanksione juridike, medoemos duhen edhe normat me sanksione politike dhe morale.

Do të tregoj një rast. Një punim studimor që e ka bërë një student, kur kam qenë unë mentor, ka pasur për detyrë për të numëruar format e mundshme të korrupsionit në Universitetin e Prishtinës. 100 forma të mundshme i ka përcaktuar. 100 forma të mundshme! Kur them të mundshme, është fjala kushtimore, sepse dihet fare mirë që pa u konfirmuar në procedurë gjyqësore, nuk mund të thuhet është. Po, vetëm në Universitetin e Prishtinës.

Unë propozoj, ju lutem, me qëllimin për t’i respektuar parafolësit që apostrofuan thekse të qëlluara që përpos Ligjit antikorrupsion të amenduar mirë ne duhet të bëjmë edhe Ligjin për origjinën e pasurisë. Ju lutem, Ligjin për origjinën, për prejardhjen e pasurisë, regjistrimi dhe konfirmimi. Kush e ka fituar ligjërisht, aferim i qoftë, i tilli është i dobishëm për Kosovën, edhe për vetveten edhe për familjen.

Gjasat janë që na imponohet për ta themeluar një gjykatë speciale për antikorrupsion. Gjykatë speciale! Gjykatat speciale formohen në praktikat e këtilla, se bëjnë punë. Ju lutem!

Edhe, përfundimisht, zoti kryesues, angazhohem që propozimet, kishte shumë propozime dhe ide të hedhura që ishin të logjikshme dhe me plotë racionalitet, që të evidentohen dhe ato të votohen, se ndryshe ne vetëm mund të flasim dhe kurrëgjë askujt. Fol sa për të folur – “parler pour parler”. Prandaj, për të mos ndodhur ajo, se ne qëllimin e kemi për të bërë punë e jo për të folur, do të thotë, propozimet që i miraton Kuvendi të shndërrohen në dokumente juridike apo edhe politike, në funksion të luftimit, në këtë rast, të korrupsionit. Ju falënderohem!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Smaka. Fjalën e ka deputetja Suzan Novobrdaliu.

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Nga Qeveria s’mund ta përshëndes askënd se askush nuk është këtu.

Një shpjegim të shkurtër në fillim... Kryetari na e tërhoqi vërejtjen disa herë se anëtarët e opozitës janë edhe anëtarë të komisioneve, mirëpo më duhet të theksoj se shumë herë mbivotohen nga koalicioni, kështu që është plotësisht e arsyeshme t’i japin mendimet e veta këtu në seancë.

Tash do t’i them disa fjalë për strategjinë kundër korrupsionit për vitin 2009-2011. Pozicioni im në këtë rast është më i vështirë, meqë edhe unë në cilësi të kryesueses së Këshillit të Agjencionit Kundër Korrupsionit kam qenë pjesë e punës dyditore për finalizimin e Projekt-strategjisë kundër korrupsionit. Sigurisht se kontributi dhe angazhimi im është bërë në baza serioze, duke besuar se më në fund do të arrijmë ta hartojmë një strategji të shoqëruar me një plan veprimi, me të cilin do të arrijmë ta parandalojmë dhe ta luftojmë korrupsionin.

Të nderuar kolegë,

Prej shkurtit të vitit 2007 e kemi funksional një agjencion i cili merret specifikisht me fenomenin e korrupsionit në Kosovë. Po ashtu, kishte edhe një strategji kundër korrupsionit në Kosovë në periudhën 2004-2007. E sot, ne nuk kemi asnjë rast konkret që dikush është dënuar në Kosovë për korrupsion. Andaj, rrjedhimisht, shtrohet pyetja: ka apo nuk ka korrupsion në Kosovë? Dhe, nëse ka, cili është niveli i tij? Kjo, sepse në fund të realizimit të këtij projekti dhe veprimeve konkrete të ndërmarra, duhet të dihet se sa është luftuar ky fenomen, konkretisht sa ishte në fund të vitit 2008, gjë të cilën nuk e dimë. U tha edhe më herët, por edhe unë do ta përsëris, në këtë Projekt-strategji kundër korrupsionit identifikimi i sektorëve të cilët qenkan të prekur nga korrupsioni është bazuar në perceptimet e publikut. Strategjia kundër korrupsionit nuk hartohet mbi bazën e perceptimit të publikut, se në këta sektorë ka korrupsion e në këta jo. Por, një gjë e tillë bëhet pas një analize të mirëfilltë dhe një hulumtimi në bazë të një metodologjie të caktuar, gjë e cila, fatkeqësisht, nuk është bërë. Këtë vërejtje e kam dhënë edhe në Grupin punues të punëtorisë për finalizim të kësaj projekt strategjie.

Të nderuar kolegë,

Mendoj se strategjia kundër korrupsionit do të ishte më e kompletuar dhe më e qartë sikur sot të jetë e shoqëruar me një plan veprimi në të cilin do të ishin të përcaktuara qartë veprimet që do të ndërmerren për realizimin e këtyre objektivave që i kemi në këtë projekt-strategji.

Dhe, për fund, duke u bazuar në të gjitha këto që i thashë më lart dhe në dyshimin se kalimi i kësaj strategjie në Kuvend do të përdoret nga Qeveria vetëm si dokument sa për të thënë se ne e luftojmë korrupsionin, e në realitet të mos bëhet asgjë, sugjeroj që ky dokument t'i kthehet hartuesve dhe pasi të finalizohet edhe plani i veprimit, t'i drejtohet Kuvendit për miratim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zonja Novobrdaliu! Fjalën e ka deputetja Edita Tahiri.

EDITA TAHIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Kolegë të nderuar, Dua së pari të konstatoj që lufta kundër korrupsionit në Kosovë e ka humbur luftën ndaj korrupsionit, sepse korrupsioni ka triumfuar këtu pas luftës, përkundër faktit që vazhdimisht ka pasur deklarime të qeverive për zero tolerancë kundër korrupsionit. Në fakt, unë mendoj se ka pasur politika, por nuk ka pasur vullnet politik dhe, ndoshta, mund të jetë rast i kësaj Qeverie që me një vullnet politik me të vërtetë të marrë përsipër këtë sfidë të madhe dhe të japë rezultate në këtë drejtim.

Është fakt se korrupsioni në botë është një fenomen i përhapur, por kjo nuk do të thotë që të pajtohemi me faktin. Është po ashtu fakt se shtetet e korrupsionit në listën e shteteve radhitën në taborin e shteteve të dështuara, prandaj korrupsioni është një rrezik që shtetin e ri të Kosovës ta nxjerrë prej binarëve të një procesi të përparimit dhe ta vërë në binarë aty ku nuk duhet.

Në lidhje me strategjinë, unë kisha disa ide dhe mendoj se një prej çështjeve kryesore ku në fakt korrupsioni buron, është çështja e prokurimeve dhe mendoj se lidhshmëria në boshtin udhëheqës politik i institucionit, këtu e kam fjalën për të gjitha institucionet, prej Presidentit, Kryeministrit, ministrive, Parlamentit dhe të gjitha organizatat tjera publike, është fjala si lidhet udhëheqësi i njësisë së prokurimit me liderin politik. Nëse duam të luftojmë korrupsionin, atëherë duhet të synojmë të shikojmë çfarë është lidhja midis këtyre dy instancave, sepse aty është burimi i parë i kësaj çështjeje.

Në të kaluarën, për shembull, ka pasur raste që ministri dhe shefi i një njësie të prokurimit kanë pasur lidhje familjare, shoqërore e të tjera, prandaj, kjo strategji, nën një, duhet të synojë, pra, që në këtë fushë, në këtë segment, të shikojë kush janë njerëzit dhe si ndërlidhen me interesat njëri me tjetrin?

E dyta, meqenëse është ndërtuar Agjencia Antikorrupsion dhe ne vazhdimisht po dëgjojmë deklaratat e udhëheqësit të këtij mekanizmi, i cili thotë se nuk ka përkrahje, ai vazhdimisht po del me deklaratat me shkrime, po nuk ka përkrahje. Unë mendoj se Parlamenti i Kosovës mund të marrë një rol më të madh në këtë drejtim dhe, ndoshta, të mendojmë në formimin e një komisioni antikorrupsion, i cili bëhet pjesë e luftës kundër korrupsionit. Po ashtu, mendoj se duhet të ecim përpara me kompletimin e legjislacionit antikorrupsion dhe këtu u përmend një ligj, me të drejtë, nga kolegu im dhe tjetra është Ligji për shpëlarjen e parave, duhet më shpejt të procedohet. Mendoj që në fushën e sundimit të ligjit duhet të punojmë më shumë që së paku gjyqësia të fillojë vetë të lirohet nga korrupsioni dhe më pastaj edhe të jetë në gjendje të gjykojë fenomenet nëpër të cilat po kalon Kosova.

Si do që të jetë, çdo herë kur diskutohet korrupsioni, nuk është shumë temë e popullarizuar, sepse adreson shtresën e atyre që kanë qenë në Qeveri dhe janë në Qeveri dhe mospjesëmarrja e Qeverisë mund edhe të jetë indikator që nuk e duan diskutimin për këtë dukuri, por porosia ime është kjo. Një Kosovë me korrupsion nuk do t'i përmbushë synimet për të cilat ne u angazhuam të gjithë, veçmas qytetarët e Kosovës, prandaj, serioziteti në këtë përkushtim është i domosdoshëm për punën tonë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete Tahiri! Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Më vjen keq që nuk është Kryetari i Kuvendit këtu, sepse ai nuk ma ka dhënë fjalën, ma ka marrë të drejtën dhe unë detyrohem që tani t'i drejtohem Kuvendit. Së paku, dy shkelje i ka bërë sot kryetari. Në fillim të seancës kur nuk ka lejuar që ne, deputetët e opozitës, të shtrojmë çështje sipas Rregullës 6.4 të Rregullores së Punës. Edhe Kryesia e Kuvendit duhet të kujdeset që, së paku një orë gjatë seancës, të mund të shtrojmë çështje. Shkelja tjetër është që kryetari i Kuvendit lejoi kryetarin e Komisionit që të kërkojë tërheqjen e një pike nga rendi i ditës. Sipas rregullës, rendi i ditës miratohet në fillim të seancës dhe atëherë kërkohet edhe tërheqja e ndonjë pike të rendit të ditës dhe jo më vonë. Prandaj, më vjen keq që nuk është këtu ai i cili duhet të jetë shembulli më i mirë i zbatimit të Rregullores së Kuvendit, kryetari.

Shprehë pakënaqësinë që po detyrohem të flasë kështu, sepse nuk më është dhënë fjala, që është një menaxhim shumë i keq i seancës. Tani po kaloj në temë.

KRYESUESI: Shiko, mua më duhet edhe një herë, zonjë, të reagoj. Lëreni këtë punë, po kaloni në temë. Mos thoni ju, ata, ju. Ka emra këtu...

GJYLNAZE SYLA: Unë e thashë qartë, Kryetari i Kuvendit. Kurse ju jeni anëtar i Kryesisë. Si anëtar i Kryesisë mund të kujdeseni për zbatimin e pikës 6.4.

KRYESUESI: Kaloni në temë! Kalo në temë, përndryshe, nëse s'flet për temën, ta marr fjalën!

GJYLNAZE SYLA: Merre! Merre fjalën! Strategjia kundër korrupsionit 2009-2011. Sot po flasim për një çështje shumë të rëndësishme dhe serioze për Kosovën. Po filloj të citoj nga Raporti i progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008, ku thotë se “korrupsioni është i shtrirë gjerësisht në Kosovë dhe ngel problem kryesor për Kosovën”. Pajtohem plotësisht me kolegen time Edita Tahiri, që thotë se kjo do të afektojë Kosovën si brenda, ashtu edhe jashtë. Brenda do të ketë implikimin, sepse kërcënon qeverisjen, zhvillimin e qëndrueshëm, procesin demokratik. Nga aspekti ndërkombëtar, nuk do të na pranojnë shtetet dhe familjet të cilat i synojmë: BE-në dhe NATO-n.

Tash, sa i përket kësaj strategjie, aty thuhet se më tepër është e orientuar në masat e parandalimit se sa të ndëshkimit dhe objektivat të cilat i propozon janë të lidhura më tepër si një objektivë e përgjithshme, që ka të bëjë me luftimin e korrupsionit në sektorin privat e publik dhe pastaj objektivat sektoriale që përfshijnë: sektorin publik, sektorin privat, financat publike, shoqërinë civile dhe disa agjenci monitoruese, pastaj administratën publike qendrore dhe administratën lokale.

Sipas mendimit tim, duke parë se cila është situata në Kosovë duhet krijuar së pari parakushtet, si krijimi i kornizës ligjore e cila duhet të përfshijë: Ligjin për partitë politike, deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, nxjerrjen e Ligjit për konfiskimin e pasurisë, si dhe duhet bërë ndryshimin e vetë Ligjit kundër korrupsionit, siç është, përbërja e këshillit e që duhet të ndryshojë për shkak të konfliktit të interesit, por edhe formularët e pasurisë duhet të jenë transparentë. Kjo është bazë para se të fillojë vetë zbatimi i këtyre objektivave.

Nga ana tjetër, pos kornizës, këto objektiva të cilat për mua janë më tepër një koncept se sa strategji, nuk përmbajnë një plan mirë të detajuar me veprime dhe afate kohore si dhe mekanizmat për zbatimin e kësaj strategjie përfshirë stafin dhe buxhetin. Prandaj, si i tillë nuk siguron se do të kemi një sukses në luftimin e korrupsionit dhe unë propozoj që kjo të kthehet pas dhe pastaj, pas hartimit të një plani të mirëfilltë me të gjithë mekanizmat e veprimit, t’i sillt Kuvendit për shqyrtim dhe aprovim.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete, Gjylnaze Sylja! E ka fjalën deputetja Qamile Morina. Urdhëroni!

QAMILE MORINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Deputetë të nderuar,

Duke pasur parasysh si vend në tranzicion që jemi, problemi i korrupsionit është shumë i përhapur dhe serioz, i cili po minon vazhdimisht funksionimin e institucioneve tona, gjegjësisht të shtetësisë tonë, po krijon imazh të keq të Kosovës dhe rrjedhimisht po e rëndon jetën e qytetarëve të Kosovës, andaj, përpilimi dhe miratimi i një strategjie të mirëfilltë antikorruption është më se i nevojshëm për Kosovën. Unë do t’i adresoj disa të meta, që i kemi sot, lidhur me Projekt- strategjinë kundër veprimit të korrupsionit.

Së pari, mungesa e planit të veprimit, nuk është bashkëngjitur në strategjinë kundër korrupsionit. Mungesa e këtij plani qartazi shpreh mungesën e vullnetit politik të Qeverisë për të mbështetur grupin punues për përpilimin e planit të veprimit kundër korrupsionit.

Së dyti, mungesa e një hulumtimi të gjendjes ekzistuese, i cili do të ofronte të dhëna për nivelin e korrupsionit, shtrirjen e tij në sektorë të ndryshëm. Mungesa e këtyre studimeve është parë edhe në strategjinë e veprimit kundër korrupsionit të viteve 2004-2007, që ka

rezultuar me moszbatimin e kësaj strategjie dhe ka qenë e vlerësuar, gjithashtu, edhe nga Këshilli i Evropës. Mangësia, më e rëndësishmja, konsideroj, është mungesa e përfshirjes në këtë strategji kundër korrupsionit- monitorimi i gjithë procesit të privatizimit, të shitjes së aksioneve apo dhënies me koncesion të ndërmarrjeve publike, ndërtimi i termocentralit “Kosova e Re” që parashihi të ndodhin në vitin 2009.

Këto mangësi që po e përcjellin përpilimin e strategjisë pa plan të veprimit kundër korrupsionit, nuk paraqesin asgjë të re apo të avancuar që do të garantonin efikasitetin në luftë kundër korrupsionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Fjalën e ka deputeti, zoti Gani Koci.

GANI KOCI: Unë bëra përpjekje për ta korrptuar kryesuesin e Kuvendit që të ma ndërrojë radhën e fjalës, por nuk munda. Nuk i ofrova kurrgjë dhe, sigurisht kam gabuar që s’të ofrova diçka në këtë... Faleminderit për fjalën!

Të nderuar deputetë,

Diskutimet e sotme në Kuvend rreth një dokumenti që e ka përpiluar për Qeverinë Agjencioni Antikorrupsion dhe kjo nënkupton se nuk është dokument i Qeverisë, por është dokument i Agjencionit Antikorrupsion dhe si të tillë ne duhet ta pranojmë sot ose mos ta pranojmë, ose ta plotësojmë për shkak të mangësive që i ka ky dokument.

Mua më shqetëson fakti i konstatimeve se ky dokument është bërë mbi bazë të perceptimeve ose pa ndonjë analizë, pa një faktografi, pa një studim të gjithanshëm, ndërsa harrojmë se që nga themelimi i Agjencionit Antikorrupsion ky Kuvend ka shqyrtuar disa raporte të këtij agjencioni dhe mbi bazë të këtyre raporteve, qofshin edhe si numra, janë adresuar pikat në të cilat ky si fenomen ka qenë më se i shprehur, madje edhe në përqindje kemi pasur raporte dhe këto pika mund të jenë prej Qeverisë në nivel qendror, qeverive lokale, ndërmarrjeve publike. Pastaj, gjyqësia që ka një shkallë shumë, jo të perceptcionit, por të fakteve dhe këto fakte janë mbi bazë të hetimeve administrative që i ka bërë vetë agjencioni, ndërsa me çka kanë rezultuar këto hetime nuk varet prej Agjencionit, por prej mekanizmave tjerë që janë pjesë e drejtpërdrejtë e luftës kundër korrupsionit, siç janë: prokuroritë, gjykatat, policia dhe mekanizma të tjerë. Prandaj, nëse duhet të flasim ose të kërkojmë se ku janë të metat dhe ku janë defektet, unë mendoj se në këtë dokument strategji janë të paraqitura mjaft mirë dhe si të tilla vetëm kërkojnë një operacionalizim më të madh e këtë operacionalizim e ka për detyrë ta bëjë Agjencioni Antikorrupsion dhe të gjithë mekanizmat tjerë, duke filluar prej qeverisë të nivelit qendror dhe niveleve lokale, pastaj policisë, tash së fundi edhe Agjencionit të Inteligjencës, prokurorive dhe gjykatave.

Unë do të isha pajtuar plotësisht me atë që vërtet është thënë edhe këtu në këtë propozim dokument se vërtet duhet krijimi i një baze të mirëfilltë ligjore, të një kuadri ligjor që nuk është i mjaftueshëm. Ne kemi këto ligje çfarë i kemi dhe këto kanë mjaft zbrazësi dhe mjaft mangësi të cilat zbrazësi janë të identifikuara dhe duhet punuar që të plotësohen. Pastaj, një nga objektivat tjera që vetë parashihi këtu, është rritja, po them, ndërgjegjësimi i institucioneve në të gjitha nivelet dhe krijimi i një transparence të veprimit të tyre, e cila ka munguar dhe mungon deri sot dhe për të cilën synojmë që ne ta kemi më mirë.

Nuk pajtohem me atë logjikën e Shoqërisë Civile ta fusim në debat këtu në Kuvend, por flasim për faktet që ne i kemi para veti dhe që na i sjellin institucionet tona. Nuk

pajtohem me atë se ky dokument është një copë letër, kur në përgatitjen e këtij dokumenti kanë marrë pjesë të gjithë mekanizmat dhe të gjithë të interesuarit, prej Agjencionit Antikorrupsion që ka qenë bartës i veprimit, prokurorisë, gjykatave, Qeverisë dhe Shoqërisë Civile që është sot shumë e zhurmshme rreth këtij fenomeni. Dhe, unë habitem këtu që ne sot po flasim për këtë projekt strategji dhe na dalin njerëz këtu dhe na qesin para atje, thuaja se Kuvendi është lypës, është duke lypur këtu, por unë do të thosha se hajni është hajni edhe nëse i vjedh një euro e gjysmë edhe nëse i vjedh një milion e gjysmë, ndërsa Kodi Penal këtë e cilëson në hajni të vogël ose hajni të madh ose diferenca është vetëm në masën e sanksionit. Do të ishte mirë, pikërisht ai që na i la paratë, se unë e di, bilanci në fund mund të ketë qenë edhe zero-zero, por po kërkoj prej tij- sa mjete i janë dhënë një pronari të pompës në Hade në emër të shpronësimit, që ka pasur vetëm një boks, do të thotë vetëm një gyp dhe ka pasur një rezervuar jo më të madh se 20.000 litra dhe ajo pompë është djegur gjatë luftës dhe është paguar si pompë e re shumë e madhe gjatë procesit të shpronësimit? Dhe, në anën tjetër, do të kërkoja që të na tregohet këtu se si janë krijuar fonde të caktuara. (Ndërhyrje...)

Unë e kam thënë edhe në një rast se fondet e tilla janë krijuar mbi bazë të dy metodave: të metodës së zonjës Meri, asaj falltares në televizion që qitke fall...

KRYESUESI: A ke emra ti, çka po flet tash për dikë, deputet Koci?

GANI KOCI: ... dhe, ju lutem, të metodës së Al Kapones. Do të thotë, duhet të na tregojnë si janë bërë dhe këto fakte janë relevante, gjyqësia fatmirësisht është duke u marrë me këto çështje.

Një çështje tjetër që dua të ngre këtu, vërtet presioni që u bëhet mekanizmave që janë të thirrur ligjërisht të veprojnë kundër këtij fenomeni po ngulfaten këta mekanizmat nga zhurmat e atyre që i ngjajnë vërtet atij proverbit kur thotë se, kur hajni thërret “kapne hajnin”. Dhe, kjo luftë që bëhet, gjoja kundër korrupsionit, është luftë për ta fshehur korrupsionin dhe për ta fshehur, sepse korrupsioni nuk ka lindur sot, nuk ka lindur as para një viti, nuk ka lindur as para pesë vjetëve. Korrupsionin e kemi, është shumë i moçëm si fenomen, te ne në Kosovë, ndoshta, është në masën e shprehur – i kemi dhjetë vjet e tutje.

Unë konsideroj se ky dokument do të mund të ishte plotësuar sot këtu me propozime, por nuk pati asnjë propozim që mund ta plotësonte dhe si të tillë ne duhet ta pranojmë dhe pastaj të kërkojmë nga subjektet që janë të thirrura të luftojnë korrupsionin, që janë të identifikuar mirë këtu, të shohim për rezultatet e tyre në periudhat që do të vijnë pas miratimit të këtij dokumenti.

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë ka kërkuar zoti Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues! Po dua t’ju them dy-tri çështje. Unë e tregova timen, e kanë treguar komisionet që i kanë krijuar shokët e këtij vetë, se s’po ia përmendi emrin edhe një herë, dhe ky dhe shokët e këtij- unë i kam kthye 1,12 centë, aq kanë dalë mangu edhe Ministria e Financave i ka gabuar, jo unë, po këta kanë për t’ i kthyer banesat dhe tokat që i kanë marrë prej ndërmarrjeve publike dhe që i kanë ndërtuar shtëpitë në prona të popullit, në prona publike. Ky ka për t’ i kthyer vetë, edhe shumë shokët e këtij. Unë të miat i kam kthyer, tash e ke rendin ti për t’ i kthyer e të mos shesësh mjegull këtu pa lidhje. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e kërkon dhe e merr deputetja Rita Hajzeraj.

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë, për hir të transparencës, me bindje të plotë them se ky dokument nuk është strategji, është një dokument i cili është vetëm një raport i përshkruar. Dhe, nuk pajtohem me mendimin e zotit Koci, i cili tha se asnjëri nuk dha argumente këtu deri tani për strategjinë antikorruption. Megjithatë, unë do të jap disa alternativa, do të mundohem dhe do të flas në lidhje me antikorruptionin, i cili vazhdon të jetë prezent në vendin tonë.

Forcimi i luftës kundër korrupsionit me qëllim të parandalimit dhe eliminimit të tij po bëhet gjithmonë e më tepër një çështje e ndjeshme, e shtruar për zgjidhje. Kjo duket qartë, jo vetëm në nivelin e brendshëm, por edhe në atë ndërkombëtar, gjë që reflektohet në konventat ndërkombëtare të ratifikuara kohëve të fundit. Është e vërtetë se ndarja e pushteteve dhe ndërtimi i një gjyqësori të pavarur kanë qenë një nga shërbimet më të mëdha që kushtetutat demokratike i kanë bërë luftë kundër korrupsionit. Megjithatë, kjo luftë është mjaft komplekse dhe e lidhur me shkaqe e faktorë të ndryshëm, prandaj meriton më shumë vëmendje, si në nivelin ligjor të zakonshëm, ashtu edhe në nivelin kushtetues. Sidoqoftë, një nga mjetet më të rëndësishme antikorruption mbetet parandalimi dhe goditja që organet e drejtësisë u bëjnë veprave korruptive. Përmes zbatimit me efektivitet të ligjit, në kundërshtim është e domosdoshme të kemi një gjyqësor të fortë, të pa korruptuar, të përgatitur profesionalisht, që të punojë me përgjegjësi e transparencë, me gjyqtarë etikisht të pastër e të papërfshirë në konflikte interesi. Vetëm në këtë mënyrë do të rritet besimi qytetar i cili shpesh i stigmatizon dhe i paragjykon organet e drejtësisë, duke i konsideruar edhe ato vetë të prekura nga korrupsioni. Krahas reformave për t'i luftuar shkaqet e korrupsionit në organet e drejtësisë dhe për të forcuar sistemin e drejtësisë në tërësi, është e nevojshme të punohet edhe për rritjen e besimit të qytetarët dhe ndërgjegjësimin e tyre për të denoncuar korrupsionin. Njohja e procedurave që ndjekin këto organe dhe transparenca e tyre ndaj publikut, si dhe evidentimi i modeleve pozitive të goditjes që ato i bëjnë korrupsionit, janë mjetet kryesore për të arritur sa më sipër.

Dhe, për fund, për të arritur sukses ky agjencion duhet që të bëhet: përmirësimi i Ligjit për Agjencionin për Antikorruption me më shumë frymë transparente, hartimi i Ligjit për prejardhjen dhe deklarimin e pasurisë; hartimi i Ligjit për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme. Pastaj, rritja e kapaciteteve të institucioneve që e luftojnë korrupsionin, rritja e numrit të prokurorëve dhe gjyqtarëve, rritja e bazës materiale për prokurorët, gjyqtarët, policët dhe stafin e Agjencionit për Antikorruption; specializimi i njësive që merren me luftimin e krimit ekonomik dhe, në fund, rritja e transparencës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit deputete! Para se t'ia jap fjalën deputetit Shkumbin Demaliaj, unë i thërras deputetët të vijnë në sallë, sepse jemi në fazat kur duhet të votojmë. E ka fjalën zoti Demaliaj!

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar ministër, faleminderit që u kthyet! Tjerët, s'e panë të arsyeshme të jenë me ne, sepse kur bisedohet për korrupsion më së shumti aludojmë te Qeveria, po s'kanë pasur qejf të na dëgjojnë sot duke folur. Unë, meqenëse jam i fundit po e shfrytëzoj pak për relaks, sepse kanë nevojë deputetët. Si Grup Parlamentar dhe si parti politike jemi për

herë të parë në Kuvend. Patëm fatin e keq, të them, që nuk mund të depërtojmë të hyjmë në Qeverinë e Kosovës për ta mësuar popullin e Kosovës se si duhet të ndërtohet vendi, sepse e shoh shumë shpesh aludohet te një kompani që është kompani ndërkombëtare e që ka fituar një tender në Kosovë. Kohëve të fundit edhe përmendet një 15 milionësh, nuk përmendet emri i cilës kompani, por besoj se i ka ardhur fundi i kohës që kush e ka një traktor të fitojë tenderë milionëshe në Kosovë. Me një traktor, me një buldozer, me diçka, i ka pajisjet, por duhet të mësojmë se një kompani e cila ka fituar tenderë miliardësh në mbarë botën, po besoj se edhe sikur të mos e kishte fituar atë tender, ka pasur ndoshta edhe Gjykata Ndërkombëtare të merret me cilësimin, sepse me të vërtetë duhet të verifikohen kompanitë që marrin tenderët dhe e cila ofron ofertën më të mirë për ta marrë një tender.

Kështu që, të kthehemi në të kaluarën. Institucionet e Kosovës, them kushtimisht, pas luftës, dihet çfarë cilësish qeverisëse kanë pasur. Dihet se janë prishur mushkëritë e Prishtinës, me qendra protokollare të ndryshme e tjera dhe sot nuk realizohen dhe të gjitha janë bërë prej buxhetit të Kosovës. Dihet se një qeveri ia ka dhënë një tender një kompanie, por një qeveri tjetër menjëherë ia ka marrë të drejtën për ta ndërtuar atë. Dihet shumë mirë rruga në të cilën po ecim, dihet nepotizmi kah kemi kaluar. Dhe, ju kisha lutur të gjithëve që më mirë të merremi me historikun tonë të vonshëm, që këto duhet të përfundojnë. Askush nga deputetët sot nuk e tha se jemi kundër një plani, një strategjie antikorrupsion, por e tha se duhet të ketë plan veprimi dhe pa një plan veprimi i gjithë debati ynë është i kotë, sepse duhet të qartësohet rruga në të cilën do të kalojmë për të ardhur deri te një kusht, te një standard që duhet të përkufizohet, sepse të gjithë e kemi mbushur gojën me Union Evropian, me integritet në struktura tjera euroatlantike. Kështu që kushtet duhet t'i plotësojmë, por duhet të ofrohet edhe plani i veprimit që të mund të kalojë sa më pastër, sa më qetë. Sepse, edhe njëherë po e theksoj, kur përmenden shifrat, duhet të dimë se ne si Kuvend e kemi votuar njëherë për Pallatin e Shtypit, kur përmendet sot këtu, që ai të mos rindërtohet, të mos riparohet, mirëpo e dimë se të gjithë bashkë e kemi votuar edhe një ligj që pronat publike i menaxhon Qeveria dhe Qeveria e ka shfrytëzuar këtë drejtë. Ju them edhe një herë, se për firmën "Mabetex" e mbaj përgjegjësinë vetë tash në këtë rast kur flas, sepse as nuk jam pjesë e firmës apo diçka tjetër, por për arsye të qytetarëve dhe të deputetëve them se është një kotec shumë i vogël i pulave që mund të ndërtojë për atë firmë dhe besoj se në të ardhmen do ta shohin të gjithë se si ndërtohet vendi. Pra, shpresojmë se në të ardhmen populli do ta kuptojë dhe do t'ia japë mundësinë atyre që me të vërtetë do të rindërtojnë dhe do ta luftojnë korrupsionin, por besoj se brenda asaj qeverie s'do të ketë korrupsion. Mirëpo, kushtimisht, ne edhe kur u fol për procesin zgjedhor, e thamë edhe një gjë tjetër, se i shtymë zgjedhjet, ne kërkuam që të mbahen në vitin 2010, që qeveritë e korruptuara të mos e kenë vendin në Kosovë, por t'i lëmë ta mbushin kupën, sepse populli ka për ta parë dhe është duke parë shumë, shpresojmë se e ardhmja do të jetë më ndryshe. Faleminderit, zoti kryesues, ndoshta e shfrytëzova shumë jashtë rendit të ditës për të folur, por gjithmonë po dalin diskutime të panevojshme me një arsye të vetme, sepse në qoftë se dikush mendon se pastrohet duke folur në foltore, ka gabuar, sepse ka njerëz që mbajnë shifra, janë duke regjistruar dhe rregullohen që më në fund duhet të kuptojmë se ne këtu nuk kemi ardhur për pushtet, por për të ndërtuar shtet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kolegë, të nderuar, unë nuk kam asnjë paraqitje tjetër. Ju lutem shumë, unë vetë kam qenë paraqitur të flas atëherë kur e mora drejtimin e kësaj seance dhe më lejoni t'i them tri fjalë nga ky vend, sepse mundësi tjetër s'kam.

Unë, si zakonisht, u përpoqa të dëgjoj mirë këtë që u fol. Pse po them kështu? Po them kështu se gjithë kur flet më vonë, pak a shumë, të injektohen mënyrat e të menduarit. Sido që të jetë, unë do të përpiqem të ik nga ato dhe të kthehem në fillimet e konceptimit tim.

Ky dokument është hartuar, siç e shihni ju, nga një agjenci që quhet Agjencia Antikorrupsion. Po ky, që më datën 24 dhjetor, nuk është më dokument i Agjencisë, por është dokument i Qeverisë së Republikës së Kosovës, sepse është miratuar në mbledhje të Qeverisë dhe tash te ne vjen si dokument i Qeverisë së Republikës së Kosovës. Këtë status e ka sot këtu, te ne.

I kam dy-tri mendime për të. Unë mendoj se është dokument më shumë i hartuar si një tekst doktrinar, e jo shumë praktik, nën një. Nën dy, mendoj që argumentimet rreth korrupsionit në Kosovë kanë referime kryesisht deri në vitin 2007. Kjo është një mungesë e madhe, sepse këtu kemi perceptimin e 2007-shit për institucionet e Kosovës dhe shihni mirë çka thotë këtu, thotë: “më të korruptuarit janë partitë politike dhe Kuvendi – deputetët”. Ju e keni në tekst këtë, ndërsa në dokumentin më të besueshëm dhe më të arsyetuar që ekziston i Evropës, Raporti i përparimit të Kosovës, thotë, një rend krejt tjetër të institucioneve, që unë më nuk po e ndërtoj atë rend, sepse ju besoj e keni lexuar, e keni. Çka po dua të them? Kolegë të nderuar, kur do njeriu t’i ikë reales, ose flet me hiperbola, zmadhime, qysh po ndodhë këtu, gati me të gjithë, ose me zvogëlime. Atëherë, dy herësh i ikë reales dhe mua më vjen keq që në diskutimet tona sot shumë po i ikim reales dhe konkretes, sekush po lyp konkrete, por në biseda jemi shumë abstrakt, se ose përgjithësojmë totalisht ose kapemi në segmente të vogla, kështu që më mirë do të ishte, meqë po themi njëri pas tjetrit që e kemi lexuar këtë dokument, po më duket ose lexojmë gabim ose s’i lexojmë hiq. Sepse, po të lexohej drejt, do të shihej që argumentimet dhe perceptimet e tij janë të hershme, nuk kanë të bëjnë me kohën afër nesh.

Pse dokumenti nuk është studiuar mirë nga Qeveria, unë, meqë e kam përpara, unë po ju lexoj tash veç paragrafin e parë të kapitullit V, ku thotë: “miratimi, monitorimi dhe zbatimi i strategjisë” dhe ju do të shihni që ky është kapitull procedural, inicial, i cili thuhet për një dokument që ka lindur diku dhe po i dërgohet diku në procedurë tutje. Dëgjoni: “Strategjia e re kundër korrupsionit përbën dokumentin themelor të politikave antikorrupsion dhe do të zbatohet gjatë periudhës kohore 2009-2011, pasi projekt strategjia të kalojë në procesin e përpilimit dhe të finalizimit, Agjencioni Kosovar Kundër Korrupsionit ia dorëzon këtë dokument për aprovim Qeverisë së Republikës së Kosovës, e cila, pas shqyrtimit ia kalon Kuvendit të Kosovës për miratim” e tjera. Domethënë, teksti është krejt inicial. Ky tekst ka kuptim të shkruhet inicialisht nga një agjencion ose një fabrikë e prodhimit të një dokumenti, nuk është me rëndësi e kujt, po tregon që dokumenti as që është studiuar në Qeveri, por është aprovuar. Po më vjen keq që, po më duket, s’është studiuar as prej ne sot bash mirë. Si do që të jetë, nuk mundet një agjencion, sepse i referohet, edhe të hartojë dokument strategjie, edhe ta aplikojë atë strategji, veçse ta marrë kalimthi nëpër Qeveri dhe nëpër Kuvend miratimin e një dokumenti, që unë po e quaj doktrinar, më shumë se sa praktik, ndonëse e harton dhe ia jep prapë detyrën themelore vetvetes. Një dokument i tillë i strategjisë antikorrupsion, qoftë edhe i pranuar në një mbledhje Qeverie, duhet ta mbajë vulën prej germës së parë deri në të fundit që është dokument i tërësishëm i Qeverisë, kështu që unë, për vete, diskutimin tim e mbarova këtu.

Tash jam kryesues i seancës. Thashë edhe një herë, në mënyrë procedurale ne diskutuam këtë dokument që është i hartuar nga një agjencion, por si do që të jetë, te ne vjen

proceduralisht si një dokument i Qeverisë së Kosovës. Unë e thërras regjinë të bëhet gati, deputetët të bëhen gati dhe të...

(Ndërhyrje)

KRYESUESI: Zotëri, nuk ka kurrfarë shënimi që e ke kërkuar fjalën.

(Ndërhyrje)

KRYESUESI: Është problemi se... diskutimi ka marrë fund. Bëhuni gati për votim. Votojmë tash.

Domethënë, 29 vota elektronike dhe 1 me dorë domethënë me 30 vota “kundër”, 2 abstenime dhe 28 “për”, nuk kalon.

(Ndërhyrje)

KRYESUESI: 30 me 29, nuk kalon. Kjo është. Faleminderit!

Kalojmë në pikën e dhjetë të rendit të ditës. Fjalën e ka kërkuar zoti Eqrem Kryeziu.

EQREM KRYEZIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Duke qenë se shkëlqesia e saj, ministrja Kelmendi nuk është e pranishme dhe nuk e ka rastin për t’i dhënë komentet e saj lidhur me raportin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, që ka të bëjë me zbatimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale, e kam autorizimin edhe të ministres, por edhe të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës që t’i propozoj këtij Kuvendi dhe lus për mirëkuptim që kjo pikë të jetë pika e parë pararendëse e seancës së ardhshme. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Në bazë të Rregullores së Kuvendit, ky është propozim që nuk diskutohet.

Ju lutem, kush është për propozimin e zotit Kryeziu që kjo pikë të shtyhet për seancën e ardhshme...

Faleminderit! Shumica.

Kush është “kundër”? Nuk ka “kundër”.

Abstenim? 1 abstenim, Maloku abstenon.

Kjo seancë u krye. Mirë u pafshim në seanca tjera.

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve

